



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 19 TETOR 2021**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 19. OKTOBRA 2021. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR  
2021**

## **Rendi i ditës**

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale,
8. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit nr. 08/L-032 të procedurës penale,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-125 për shëndetësi,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale,
20. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-78 për shëndetësi publike,
21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-049 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor,
22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor,
24. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020,
25. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2020.

## Dnevni red

1. Izjave van dnevnog reda,
2. Parlamentarna pitanja
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-036 o slanju Kosovske Snage Bezbednosti van zemlje,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-020 o međunarodnoj pravnoj saradnji o građanskim pitanjima,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-023 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-26 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-213 o međunarodnoj pravnoj saradnji o krivičnim pitanjima,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakonika br. 08/L-032 o krivičnom postupku,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-037 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-76 o reproduktivnom zdravlju,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-038 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-192 o transplantaciji tkiva i ćelija,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-039 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-024 o Emergentnoj medicinskoj službi,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-040 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-156 o kontroli duvana,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-041 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-023 o dojenju,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-042 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-249 o zdravstvenom osiguranju,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-043 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-125 o zdravstvu,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-044 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-110 o prekidu trudnoće,
17. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-045 o izmenama i dopunama Zakona br. 06/L-042 o krvi i krvnim sastojcima,
18. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-046 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-109 o sprečavanju i suzbijanju zaraznih bolesti,
19. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-047 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-190 o medicinskim proizvodima i opremi,
20. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-048 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-78 o javnom zdravstvu,
21. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-049 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-38 o inspektoratu zdravstva,
22. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-050 o izmenama i dopunama Zakona br. 2003/22 o sanitarnom inspektoratu Kosova,
23. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-051 o izmenama i dopunama Zakona br. 2004/38 o pravima i odgovornostima stanovnika Kosova u zdravstvenom sistemu,
24. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Institucije Narodnog Advokata za 2020. godinu
25. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kosovskog Saveta za kulturno nasleđe za 2020. godinu.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.**

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,  
Po e fillojmë seancën, ju lutem, t'i zini vendet tuaja.

Të nderuar deputetë,  
Të nderuar zëvendëskryeministra,  
Ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2021.

Ju përkujtoj lidhur me rëndësinë e respektimit të masave për mbrojtjen nga pandemia COVID-19, duke u bazuar në manualin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe rekomandimet e IKSHP-së, përgjatë seancës është i obliguar përdorimi i maskave dhe mbajtja e distancës nga secili.

### **1. Deklarime jashtë rendit të ditës**

Siç e dini, koha për deklaram jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetëve deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarojnë se në çfarë cilësie kërkojnë fjalën.

Fillojmë nga Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: E nderuar nënkryetare e Kuvendit,  
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,  
Zëvendëskryeministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Ju qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,  
Më 17 tetor qytetarët e Republikës për të satën herë me radhë dëshmuan sjellje shembullore në pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e radhës, kësaj radhe zgjedhje lokale.

Janë disa procese zgjedhore me radhë, të cilat dëshmojnë kulturë të lartë demokratike dhe organizim të mbarë nga institucionet përgjegjëse. Të gjitha këto institucione në të shumtën e rasteve ishin në krye të detyrës dhe kontribuan në mbarësinë e procesit.

Dalja e votuesve kësaj radhe ishte më e vogël për 6% nga ajo e zgjedhjeve nacionale, por mjaftueshëm për të pasur një proces kredibil për zyrtarë të zgjedhur komunalë. Andaj nga këtu i falënderojmë të gjithë votuesit e Republikës së Kosovës, të cilët morën pjesë në zgjedhje, respektuan masat anti-COVID gjatë fushatës dhe gjatë procesit zgjedhor si dhe, natyrisht, i inkurajojmë të jenë pjesëmarrës më 14 nëntor.

Tani kur një numër i konsiderueshëm i komunave do të kenë rund të dytë të votimeve, para vetes i kemi edhe katër javë të plotë të angazhimit politik për vazhdimësi të procesit zgjedhor.

Në ndërkohë kemi pasur një përmirësim të ndjeshëm të situatës me pandeminë, duke pasur numrat më të ulët në rajon me infektive, ndërsa me rritjen më të lartë të normës së vaksinimit krahasuar me vendet e rajonit.

Aktualisht në Kosovë të vaksinuar janë 35,6% të qytetarëve të Republikës me dy doza të administruara, ndërsa në total janë administruar 1 milion e 489 mijë e 688 doza të vaksinës.

Këto statistika nuk duhet ende të na japin përshtypjen se e kemi kaluar krizën, përkundrazi duhet mirëmbajtur masat në fuqi përderisa ato të vlerësohen të domosdoshme.

Gjithashtu ky proces nuk do të thotë se veprimtaritë dhe angazhimet e tjera të Qeverisë dhe tonat në Kuvend duhet të ndalen apo të ngadalësohen.

Zgjedhjet të cilat mandatuan Qeverinë dhe Kuvendin mbaruan në shkurt, andaj është me rëndësi sikur gjatë fushatës për rundin e parë, të vazhdohet me punë dhe angazhime. Thënë këtë, edhe punët, sukseset dhe aktivitetet e Qeverisë duhet të vlerësohen me peshën dhe efektin pozitiv që e kanë.

I tillë ishte aksioni kundër rrjetit të kontrabandës, për të cilin hetimet ishin zhvilluar prej dhjetorit të vitit 2020 dhe në mars të vitit 2021. Janë zhvilluar nga Drejtoria për hetimin e krimit të organizuar, në koordinim me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Gjatë këtij aksioni në total janë kontrolluar 26 lokacione, në komunat Prishtinë, Pejë, Mitrovicë Jugore, Veriore dhe në Zveçan.

Siç e dini, tetë persona janë arrestuar dhe 10 janë në arrati. Janë sekuestruar mbi 100 mijë euro mallra të kontrabanduara. Përderisa në shumicën e lokacioneve nuk ka pasur probleme, probleme pamë në Mitrovicën Veriore nga grupet kriminale, të cilat në mënyrë të organizuar krijuan bllokime të rrugëve me mjete të ndryshme dhe sulmuan zyrtarë policorë e doganorë.

E tërë kjo situatë solli reagime dhe diskutime mbi tendencën, arsyen dhe kohën e zhvillimit të operacionit dhe propozime se mund të pritej të bëhet ky aksion pas zgjedhjeve lokale.

Punët e Qeverisë dhe Kuvendit nuk presin, ato duhet të vazhdojnë dhe do të vazhdojnë pa marrë parasysh procesin zgjedhor lokal. Andaj, në vend se të kritikohen e të gjykohen me nguti, është mirë të analizohen dhe vlerësohen pozitivisht për punën dhe angazhimin e tyre.

Ky Kabinet qeveritar gjatë këtij procesi zgjedhor dha edhe një shembull dhe një standard të ri për pjesëmarrje në zgjedhje lokale. Prej mosshfrytëzimit të resurseve qeveritare, deri te mesazhet dhe korrektësia politike, gjë e paparë deri më tani në Kosovë.

Disa prej punëve dhe sukseseve të Qeverisë që i kemi parë gjatë ditëve të fundit janë gjithashtu ato në miratimin e koncept-dokumentit për hartimin e vetingut në drejtësi, fazën e parë e cila do të mbulojë vlerësimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor Prokurorial, Zyrën e Prokurorit të Shtetit, Gjykatën Supreme dhe rrjedhimisht pozitat e larta drejtuese. Është rikthyer vendimi i masës mbrojtëse anti-damping për bllokat standardë, të cilët importohen nga Serbia, i cili ishte shfuqizuar në muajin gusht për arsye të skadimit të afatit të tij 5-vjeçar.

Shfuqizimi asokohe ishte obligim ligjor, njëjtë sikurse është edhe më tutje mbrojtja e prodhimeve vendore nga veprimet e dëmshme, gjë të cilën e bëri Qeveria.

Gjithashtu Qeveria mori edhe një vendim si rezultat i performansës së mirë financiare dhe hapësirës fiskale edhe për zgjerimin e skemës së shtesave të fëmijëve për fëmijët e lindur nga viti 2015 e tutje.

Të dashur kolegë,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Kemi arritur një performansë ku mund të jemi shembull për të tjerët me angazhimin tonë qytetarë dhe institucional si në procesin zgjedhor, ashtu edhe në vendimet e Qeverisë.

Andaj, ta vlerësojmë dhe ta mirënjohim kontributin e secilit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Ferat Shala.

**FERAT SHALA:** E nderuar kryesuese,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike t'ju përshëndes dhe falënderoj përzemërsisht për kulturën e lartë të treguar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Një kulturë, e cila na bënë të dinjitetshëm të gjithë, si shtet dhe si komb, një kulturë të cilën sinqerisht do t'ua dëshiroja shumë edhe institucioneve të Qeverisë, veçanërisht ekzekutivit të këtij vendi.

Pra, konsideroj që kemi dhënë një provim të përbashkët të madh para opinionit të gjerë vendor dhe ndërkombëtar, e të cilën e kemi obligim ta ruajmë dhe kultivojmë në shkallën më të lartë të mundshme.

Por sot jam këtu të ngre edhe një shqetësim të mungesës së një pjese të kulturës ekzekutive, të cilën Qeveria e Kosovës ditëve dhe muajve të fundit sikur ka harruar apo qëllimisht ka mbetur pa këtë kulturë.

Më lejoni të them që para pakë ditësh, saktësisht në kohën e fushatës zgjedhore një metalurgjik mbi 1 mijë punëtorë në Ferronikel të Drenasit falimentoi, apo u mbyll përkohësisht. Ku është Qeveria në këtë relacion, 1 mijë punëtorë, të cilët sot në kohë pandemie, në kohë krize, e për koincidençë dhe në kohë fushate janë në shtëpitë e tyre. Një problem i madh social, para së cilit Qeveria jo vetëm që hesht, por nuk do të dëgjojë. Mësoni a ka ndodhur diku që 1 mijë punëtorë të shkojnë në shtëpitë e tyre dhe Qeveria nuk ekziston, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e Tregtisë hesht para një gjiganti të tillë industrial që ka qenë krenari regjionale, ndoshta edhe evropiane.

Si ka mundësi që qeveria t'i ndajë, t'i klasifikojë ndërmarrjet private dhe publike në kohë pandemie, si ka mundësi që Qeveria, përkundër miratimit të paketës ekonomike, të subvencionojë dhe mbështet ndërmarrjet dhe ekonominë e vendit, të jetë kaq indiferente para një rajoni të tërë. Ta dini që 1 mijë punëtorë vijnë kryesisht nga Drenasi, Skenderaj, Mitrovica dhe një pjesë e tyre nga Prishtina. Pra, a do të duhej t'i shihte në këtë kohë pandemia Qeveria këta punëtorë, këto familje?

Si ka mundësi që gjiganti i Ferronikelit së paku dy herë zyrtarisht ka kërkuar takim me institucione e shtetit për të bashkërenduar, për të gjetur zgjidhje alternative, për të dalë nga kjo krizë, kur është e goditur edhe nga kriza e energjisë. Asnjë përgjigje as pozitive, as negative, nga institucionet e shtetit para një zhvillimi të tillë ekonomik në qendër të Kosovës.

Pra, heshtje totale, dënim apo çka tjetër t'i them nga institucionet që i bëjmë ekonomisë, e veçanërisht rajonit të Drenasit. Një rajon, i cili ka dhënë shumë shtetit, Qeverisë, Kosovës, një rajon, i cili ka qenë bartës i të gjitha zhvillimeve edhe sociale, edhe ekonomike, edhe historike. Është e rëndë të mendosh që qeveria i trajton ndërmarrjet mbi bazat e zonave elektorale, gabim i madh, sinqerisht gabim i madh nëse mendohet që Drenasi, drenicasit, punëtorët e Ferronikelit mund të shantazhohen në prag të zgjedhjeve me indiferencë dhe çështje të tilla. Jo, nuk shantazhohen, nuk ndryshojnë qëndrim politik Drenasi as Drenica, pa marrë parasysh veprimet indiferente dhe shantazhuese të Qeverisë, me theks të veçantë të ekonomisë e zhvillimit ekonomik, duke e keqpërdorur edhe krizën energjetike në këtë rast dhe duke mos u gjendur afër të gjithë atyre njerëzve, punëtorëve dhe metalurgëve.

Është momenti i fundit, sepse kjo valë e goditjeve ekonomike do të pasojë edhe me gjigante të tjera, siç është Sharcemi, Trepça, e kështu me radhë. Mos, sepse kriza energjetike nuk është politike, kriza energjetike është për Kosovën dëm i madh ekonomik dhe ka mundësi që Qeveria të jetë më afër industrisë, më afër atyre që kanë hapur dhe mbajnë shumë vende pune, më afër gjendjes ekonomike të vendit.

Sinqerisht presim urgjentisht që Qeveria të reflektojë me gjithë këto ndërmarrje dhe ju bëjë ftesë edhe një herë që të reflektoni, ta ktheni kulturën institucionale, gjenduni më afër industrialistëve dhe ndërmarrësve, sepse edhe ashtu po proklamoni rritje të punësimit.

Si ka mundësi që në të njëjtën kohë 1 mijë punëtorë shkojnë në shtëpi, e Qeveri del thotë i kemi punësuar 20 mijë vetë në kohë pandemie. E keni obligim, sepse ne kemi miratuar edhe një paketë ekonomike këtu, ku janë ato mjete ekonomike, si i shfrytëzuan, në cilat ndërmarrje shkuan, sa u përdorën ato për të mirën vërtet ekonomike dhe industriale. Sinqerisht më vjen mirë që erdh kryeministri.

Kryeministër, po ta përsëris zonat elektorale nuk duhet të trajtohen mbi bazën e asaj se si i ndani mjetet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Tani, radhën e ka Driton Selmanaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit!

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeverisës,

Në seancat e kaluara nuk e kemi dhënë trajtimin meritator kësaj teme, me arsyen e vetme që gjithçka thjerrëzohej se po bëhej në funksion të zgjedhjeve lokale.

Por tani askush nga ne nuk duhet të pranojmë faktin që kjo çështje të mbyllet vetëm me dy ditë prezantime mediatike dhe me arsyetime sa absurde, po aq edhe të dëmshme për vendin nga dy përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht zëvendëskryeministri Bislimi dhe ministri Rizvanolli.

Të nderuar kolegë deputetë,

E kam fjalën për vendimin e Qeverisë së Kosovës, e cila shprehet se për momentin nuk është interesuar për vazhdimin e projektit për ndërtimin e rrjetit të gazit që do të lidhte Kosovën me Maqedoninë e Veriut.



Kemi bindjen e plotë që një vendim i tillë dëmton rëndë interesat tona shtetërore dhe interesat gjeostrategjike të miqve tanë ndërkombëtarë, e në veçantë SHBA-së.

Të nderuar deputetë,

Një nga shtyllat kryesore me të cilat matet dhe vlerësohet serioziteti i një shteti është edhe aftësia e tij për të respektuar marrëveshjet, ku janë të përfshirë qeveritë paraprake me palët e jashtme. Për të pasur një pasqyrë më të qartë, domosdoshmërisht më duhet ta përshkruaj në mënyrë kronologjike procesin e projektit për zhvillimin e sektorit të gazit në Kosovës.

Nisma e këtij procesi ka filluar në vitin 2016, duke u konkretizuar në dhjetor të vitit 2017, ku Bordi i drejtorëve të MCC zgjodhi Kosovën për të vazhduar zhvillimin e programit Kompakt.

Në tetor të vitit 2018 nënshkruhet marrëveshja mes Republikës së Kosovës dhe fondit të Zhvillimit Kompakt. Marrëveshja përfshinte mbështetjen e MCC-së për të kryer studimet e parafizibilitetit dhe fizibilitetit për tri projekte të propozuara:

1. Zhvillimin e sektorit të gazit në Kosovë,
2. Rezervat për balancimin e sistemit të energjisë dhe
3. Projektin e përmirësimit të rrjetit të shpërndarjes së Kosovës.

Projekti për ndërtimin e infrastrukturës së gazit me Maqedoninë e Veriut parashihej të bëhej me mbështetje të Agjencisë Amerikane, korporatës së sfidave të njëvjeçarit MCC, me kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe nga korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Në tetor të vitit 2018 fillon zhvillimi i studimit të parafizibilitetit dhe në korrik 2020 rezultatet e studimit të parafizibilitetit përfundojnë.

Më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë në Uashington nënshkruhet marrëveshja e zotimeve, ku përfshihet edhe pika, ku të dyja palët do të shumëfishojnë burimet e tyre të energjisë.

Më 24 shtator 2020 kryeministri Hoti në emër të Qeverisë së Kosovës i dërgon letër MCC në Uashington, ku shpreh zotimin dhe jep mbështetjen e fuqishme për realizimin e projekteve në kuadër të programit Kompakt.

Në janar të vitit 2021 fillon studimi i fizibilitetit, i fokusuar në projektet e mëposhtme: zhvillimi i sektorit të gazit, rezervat për balancimin e sistemit të energjisë.

Në maj 2021, Shtëpia e Bardhë, përkatësisht presidenti Bajden i paraqet një kërkesë Kongresit Amerikan për buxhet në vlerë prej 200 milionë dollarë për programin Kompakt të MCC për Kosovën.

Të nderuar deputetë,

Në kohën kur pritej që në shtator të 2021 të hyjmë në fazën finale të aktiviteteve dhe ku më pas kjo marrëveshje do të sillej për t'u ratifikuar në Kuvendin e Kosovës, Qeveria e Kosovës merr vendimin tejet të pamatur për të ndërprerë realizimin e këtij projekti vital për shtetin e Kosovës.

Një veprim i tillë nuk mund të kuptohet ndryshe, pos një veprim i ngutshëm, i dëmshëm dhe me pasoja të mëdha për vendin.

Duhet përmendur faktin se një prej sfidave të shumë shteteve evropiane në vitet e ardhshme parashihet të jetë siguria energjetike si dhe qasja në sa më shumë burime të energjisë. Për këtë arsye, në vitin 2003 kishte marrë mbështetje ndërtimi i projektit të rrjetit të gazit natyror, i njohur si gazsjellësi TAP.

Institucionet evropiane mbështesin gazsjellësin TAP, pasi e shohin atë si një mundësi për të përmirësuar sigurinë energjetike dhe për të diversifikuar me gaz tregjet evropiane që kryesisht dominohen nga gazi rus. Aktualisht Rusia mbulon 43% të tregut evropian të gazit, për të mos qenë krejtësisht të varur nga gazi rus, së fundmi Bullgaria nis ndërtimin e infrastrukturës së gazit në distancë prej 182 kilometrash.

Serbia është krejtësisht e varur nga gazi rus dhe së fundi ky shtet zyrtarisht përuroi një linjë të gazit rus që kalon përmes Turqisë dhe Bullgarisë dhe për këtë qëllim, për të sjellë ndikimin rus sa më të madh në Ballkan.

Po cilat do të ishin përfitimet e Republikës sonë në rastin e ndërtimit të këtij rrjeti, për të cilin Qeveria e Kosovës ka kundërshtuar.

Në rend të parë, prodhimi i energjisë elektrike, në rend të dytë industria dhe në rend të tretë amvisëritë. Mbi të gjitha këto përfitime, Kosova këtë projekt duhet ta shohë në kontekstin e sigurisë dhe pozicionimit dhe rreshtimit për kah interesave tona shtetërore, gjeopolitike dhe gjeostrategjike të aleatëve tonë kryesorë.

Të nderuar deputetë,

Nëse Qeveria e Kosovës nuk e rishqyrton urgjentisht vendimin e saj të gabuar, Kosova mund të përfundojë si shteti i vetëm në rajon pa qasje në gaz dhe me pozitë tejet të vështirë në rrugën e saj për fuqizimin e subjektivitetit të saj ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fjalën e ka Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të vendit,

Gjatë periudhës që shkoi kemi parë dy operacione policore në veriun e vendit.

Pas të dyja këtyre operacioneve ka ndodhur përkeqësim i gjendjes së rendit dhe të ligjit për siguri dhe dobësim i shtetit ligjor. Të gjithë ata që janë të fushës, mund ta japin këtë vlerësim, pra pas dy herëve që ka operuar Kosova në Veri me policinë e vet, të dyja herët kemi dalë më të dobët. Herën e parë na është mbajtur policia peng në pikat doganore dhe një i sëmurë polic s'ka mundur të bartet të vijë deri në spital, e këtë e dinë mirë të gjithë dhe njëkohësisht herën e dytë, policia jonë ka mbërritur mjaftueshëm të jetë në konflikt me grupe kriminale dhe operacion blic të ndodhë në shpejtësi e të kthehet dhe të lërë terrenin në dorën e kriminelëve. Pra, dy herë operimi në veri është i ngjashëm me qasjen e Shakaswillit, e kam thënë disa herë, pra po bëhet qëllimshëm, të dorëzohet veriu, qëllimshëm është duke ndodhur, është projekt diku, nuk e di pse ndodh kështu. Për ata që merren me rendin dhe ligjin, e dinë se Kosova sot është më e dobët në veri në rend dhe ligj, pas këtyre dy operacioneve.

Kërkoj sqarime të detajshme, kërkoj të di pse po dobësohet rendi e ligji, siguria, autoriteti i shtetit ligjor në veri. Pse duhet të dobësohet shteti ligjor në veri pas gjithë këtyre proceseve që kem kaluar pas pavarësishtit energjetik, pasi që u paguhet rryma në veri dy herë nga 11 milionë, pse policia jonë duhet të mbahet peng prej grupeve kriminale, pse duhet marrë vesh me ta për t'u tërhequr dhe pse kur shkojnë në operim përballen me ta, çka ka ndodhur? Kur vetëm dy vjet më herët policisë tonë s'ka guxuar askush t'i dalë në rrugë në veri. Kjo është një pyetje që meriton trajtim të kujdesshëm, nuk ka të bëjë me zgjedhjet, jemi dy ditë pas, nuk ka të bëjë me zgjedhjet, ka të bëjë me tërësinë territoriale, me sovranitetin dhe me shtetin ligjor.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Multietnik, a e do dikush fjalën? Jo.

Atëherë vazhdojmë me deklarinimin e deputetëve. Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka kërkuar Gramos Agusholli.

GRAMOS AGUSHOLLI: Faleminderit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Fenomeni i fajdeve po vazhdon të jetë i pranishëm në shoqërinë tonë. Duket se muajve të fundit është bërë gjithnjë më i pranishëm, janë të rënda, të trishta dhe brengosëse lajmet në të cilat paraqitet fati i rënduar i qytetarëve, viktima të drejtpërdrejta nga fenomeni i fajdeve.

Megjithëse në fillim duket shpeshherë i veshur dhe nuk na shpërfaqet hapur, përmasat e saj janë shkatërruese për individin, familjen dhe shoqërinë në tërësi. Rrëfimet që i dëgjojnë nga qytetarët, nga familjarët e tyre, nga komuniteti, por edhe nga organet kompetente na bëjnë të vetëdijshëm për rreziqet shkatërruese që sjell ky fenomen, shpeshherë edhe me një përfundim fataliteti për individin.

Janë bërë shpesh raste të tilla, në të cilat të rinj e të moshuar pa asnjë dallim janë viktimë e fajdeve.

Vetëm në fillim të këtij muaji, gjithnjë sipas dyshimeve fillestare, dy të rinj nga qyteti i Pejës, bashkëqytetarë të mi, i dhanë fund jetës së tyre për shkak se kishin rënë viktimë e skemave të ndryshme të fajdeve dhe fatkeqësisht ka raste e raste të tilla, në të cilat qytetarët dhe familjarët e tyre janë viktima dhe që ne si komunitet e si shoqëri nuk jemi të vetëdijshëm.

Të nderuar deputetë dhe të dashur qytetarë,  
Organet tona kompetente kanë përgjegjësi ligjore që t'i qasen në mënyrë më serioze kësaj veprimtarie kriminale.

Duke ndjekur dhe ndëshkuar ligjërisht personat përgjegjës dhe, në anën tjetër, t'u ofrojmë ndihmë qytetarëve dhe familjarëve të tyre që janë të drejtpërdrejt të rrezikuar nga ky fenomen i fajdeve.

Përveç kësaj, ne deputetët e Kuvendit të Kosovës ofrojmë përkrahje për institucionet e zbatimit të ligjit dhe zbatuesit e rendit publik. Përmes shtimit të kapaciteteve të tyre operationale, zgjerimit të fushëveprimit ligjor e institucional, si dhe shtimit të përkrahjes financiare për to në luftimin e kësaj veprimtarie kriminale.

Dhe jo vetëm kaq, por të sensibilizohemi të gjithë, në bashkëpunim të ngushtë me mediat dhe institucionet relevante, në realizimin e një fushate vetëdijesuese në nivel vendi për rreziqet që sjell kjo veprimtari kriminale.

Janë për t'u përshëndetur veprimet operationale në javët e fundit që kanë ndërmarrë organet e rendit në arrestimin e personave përgjegjës. Megjithatë, edhe më shumë duhet të angazhohemi dhe sidomos organet e rendit dhe të zbatimit të ligjit të jenë më vigjilent.

Të nderuar deputetë,  
Le t'i inkurajojmë të gjithë ata që janë viktimë e këtyre skemave që t'u drejtohen organeve të ndjekjes, sepse kjo është mënyra e vetme dhe më e sigurt për identifikimin dhe luftimin e këtij fenomeni.

Ndërsa, në anën tjetër, le t'u bëjmë të qartë të gjithë atyre personave që ushtrojnë një veprimtari të tillë kundërligjore, se organet e rendit do t'i ndjekin, do t'i identifikojnë dhe do të dënohen sipas ligjit.

Lutem që këto tragjedi të jenë kujtim i hedhur i së kaluarës, e leksion i dobishëm për një të ardhme të sigurt e të mirëqenë për gjeneratat e reja. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: E nderuar kryesuese,

Kryeministër,

Ministra,

Prani ndërkombëtare,

Media,

Të nderuar përfaqësues të popullit,

Si deputet për herë të parë në foltoren e Kuvendit dua të dedikoj një falënderim Zotit dhe dëshmorëve të lirisë, partnerëve tanë strategjikë dhe të gjithë atyre që sakrifikuan që sot të kemi liri, shtet dhe institucione demokratike.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, ju që e votuar Partinë Demokratike dhe Hisen Berishën, edhe ju që votuat partitë e tjera, por edhe ju që nga pavetëdija fytet etikën e familjeve tona me gjuhë jotradicionale, ju falënderoj të gjithëve, në veçanti ju që davaritët rrugën time më të panjohur dhe dyshimet, atë të politikës për luftimin e neokomunizmit, të sponsorizuar nga armiqtë e pavarësisë së Kosovës. Fushatat dhe zgjedhjet nga tetori i vitit 2019 na bënë të kalojmë qeverisje, periudha dhe sfida të errëta jo vetëm për faktin se u akuzuan Presidenti, kryekuvendari dhe tërë UÇK-ja, por ndodhi ajo që askush s'e kishte parashikuar, edhe distancimi nga partneri strategjik i shqiptarëve, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe distancimi i politikës së jashtme, SHBA-së, nga Republika e Kosovës.

Një situatë vetëshkatërrimi shtetëror, disa kuadro nga vetë PDK-ja u rreshtuan përkrah ish-kryeministrit Hoti, i cili e hoqi shtetin e Kosovës nga paramesjeta sllave për ta rikthyer në Shtëpinë e Bardhë, aty ku dinjitetshëm e prezantoi, aty ku shtetësia e Kosovës u njoh nga Izraeli, duke u rilidhur pandashëm rrugëtimi institucional modern, duke bërë kombin shqiptar në përgjithësi të falënderuar për mbrojtjen e hebrenjve gjatë gjenocidit fashist, për çka e falënderoj zotin Hoti. E bëra këtë rezymë, ngase pres që ju, qytetarë shqiptarë nacionalë demokracinë e keni trashëgimi familjare apo kulturë edukative, të rigrupoheni edhe një herë rreth Partisë Demokratike dhe së bashku përfundimisht ta shpëtojme Kosovën shtet i pavarur edhe sovran, ta integrojmë në NATO, ta afirmojmë Ushtrinë e Kosovës, duke kontribuar në luftërat moderne që zhvillojnë njerëzimi për mbrojtjen e të drejtave të shtetit dhe kombeve, veçanërisht këtu në Evropë.

Kombi shqiptar nuk guxon më ta rifitojë lirinë në emër të humanizmit dhe shpëtimit nga gjenocidi, por detyrë e parë e nacionaldemokracisë shqiptare është që ta zhvillojmë shtetin dhe Ushtrinë e Kosovës për mbi kërcënimet e vjetra apo të reja. Ta ngremë nivelin e edukimit nëpër shkolla dhe në familjet shqiptare, ashtu që kurrë më fëmijët tonë të mos bien pre e mashtrimeve komuniste, mbështjellë me ambalazhim kombëtar mashtrues. I bindur se do t'ia dalim, i bashkëngjitëm Grupit të Partisë Demokratike dhe të gjithë juve në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës. Zoti e bekoftë rrugën tonë përpara.

Krejt në fund, meqenëse është fjala ime e parë dhe është shumë afër takimit të Brioneve dhe meqenëse...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Regjia, ia vazhdoni fjalën!

**HISEN BERISHA:** Faleminderit!

Pra, kjo është Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Serbia krejt këto toka ilire, të ndara që nga Kongresi i Berlinit, kur njohën mbretërimin serbë mbi to. Edhe tani po ajo Evropë, nga albanofobia po na mban të izoluar, diçka e tejkaluar, siç janë edhe shumë dokumente mekanizma që sot në procesin zhvillimor politik të Kosovës janë kthyer në pengesë të avancimit të saj si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Prandaj, për ta hapur këtë dry të ndryshkur, në cilësinë e deputetit i propozoj grupit parlamentar për politikë të jashtme të krijojë një komision të Kuvendit të Kosovës që do të marrë ofensivën diplomatike gjithandej Evropës për të kërkuar ndaljen e persekutimit evropian ndaj kombit më të lashtë. Zoti na ndihmoftë në rrugën tonë! Faleminderit! Dalshim faqebardhë!

**KRYESUESJA:** Atëherë, kanë mbetur minutat e fundit për deklaram jashtë rendit të ditës dhe fjalën e ka kërkuar Blerta Deliu nga Partia Demokratike e Kosovës.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, zonja nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Fjalimi im sot do të lidhet me muajin e ndërgjegjësimit në luftën ndaj kancerit të gjirit, meqë muaji tetor është muaji i ndërgjegjësimit dhe, natyrisht edhe për shkak të pandemisë, por edhe për shkak të zhvillimeve të fundit në vend, e kemi pasur të pamundur të diskutojmë në seancë.

Atëherë, do të flas për një vizitë që e kisha në Klinikën e Onkologjisë, për të parë punën dhe angazhimin e stafit shëndetësor atje në përballje me sëmundjen e shekullit. Natyrisht, që rritja e numrit të pacientëve ka qenë evidente edhe gjatë këtij viti, vetëm gjatë nëntë muajve të këtij viti

kemi 300 femra, të cilat janë prekur me kancer të gjirit, kurse gjatë gjithë vitit Klinikën e Onkologjisë e kanë vizituar 2 500 deri në 3 000 femra. Meqë edhe ky muaj është muaji i ndërjegjësisimit, natyrisht se raste të tilla ne duhet ta shtrojmë nevojën e përkrahjes së institucioneve shëndetësore, e veçanërisht të Klinikës së Onkologjisë, e cila po bën një punë të jashtëzakonshme, por që tre muajt e fundit është përballur me mungesë të buxhetimit për barna. Keni parasysh, po flas për një sëmundje tejet të rëndë dhe për raste të rritura dhe është nevojë e Ministrisë së Shëndetësisë që t'i përkrahë mjekët, pacientët, por mbi të gjitha, edhe personelin që po bëjnë punë të mirë atje për të ruajtur shëndetin e rënduar të këtyre femrave që po përballen çdo ditë me raste si kjo.

Po ashtu, në takimin që e kam pasur me drejtorin e Onkologjisë, zotin Ilir Kurtishi, është shtruar edhe nevoja e një aparati të ri për rrezatim, por të nderuar kolegë deputetë, ju e dini që ne tash funksionojmë me U.D. të Ministrisë së Shëndetësisë dhe unë nuk di kujt t'i drejtohem sot, meqë nuk kemi asnjë përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, por, e kemi ministren? Kërkoj falje!

Atëherë, zonja ministre, është më se e nevojshme që buxhetimi për tre muajt e fundit për barna të kryhet sa më parë, sepse janë raste të reja dhe është fatmirësi që kemi pasur stade të hershme të diagnostikimit gjatë këtij viti, por është më se e nevojshme që ky buxhetim të kryhet sa më parë dhe që aparatura e nevojshme për rrezatim të përkrahët nga Ministria e Shëndetësisë. Diagnostikimi i hershëm natyrisht që shpëton jetë dhe është nevojë e institucioneve që t'i përkrahim ato gra, ato vajza, të cilat edhe në moshë të hershme përballen me kancerin e gjirit, e nuk e kanë aspak të lehtë terapinë, trajtimin, por edhe përballjen me këtë sëmundje të rëndë.

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë, ka përfunduar koha për deklaram jashtë rendit të ditës. Kemi të paraqitur për fjalë nga Qeveria ministrin Murati, kështu që do të ketë edhe 30 minuta shtesë të deklaram jashtë rendit të ditës, në bazë të kërkesës së Qeverisë.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Desha ta marr fjalën për t'i adresuar disa çështje që u ngritën, fillimisht nga deputeti Shala, në lidhje me çështjen e Ferronikelit. Më duhet ta rikujtoj, pra që problemi aty qëndron në dy çështje. Dhe, që të dyja po besoj zoti Shala, bashkë me subjektin e vetë politik janë fajtorët kryesorë.

E para, ka të bëjë me energjinë elektrike, se arsyeja pse e ka ndërprerë punën Ferronikeli ka të bëjë me importin e shtrenjtuar të energjisë elektrike, për shkak se si konsumator i madh detyrohet të importojë nga jashtë. Sa i përket energjisë elektrike, po të mos kishin qenë korrupsionet e hajnitë e PDK-së në të kaluarën sa i përket fushës energjetike, nuk do ta kishim këtë gjendje. Pra, po të ishte bërë termocentrali i ri me kohë, po të mos ishin përzërë investitorët e huaj, siç është kompania RVE gjermane, dhe po t'i kishim kapacitetet e reja, sot nuk do të kishte problem as Ferronikeli, as ndonjë konsumator tjetër i madh për sa i përket energjisë elektrike. Por, fokusi

kryesor i PDK-së ka qenë si ta shesin KEDS-in për 26 milionë euro dhe si t'i sigurojnë kontrata me tarifa nxitëse Devollit.

Kjo ka qenë fokusi kryesor sa i përket fushës së energjisë i PDK-së. S'di pse LDK-ja ka siklet kur po flas për PDK-në, por mund të jetë çështje e tyre.

E dyta, ka të bëjë me procesin e privatizimit që po ashtu ka qenë proces korruptiv dhe ku PDK-ja ka rolin kryesor aty. Ferronikeli, zoti Shala, është privatizuar, është shitur. Ne kemi qenë kundër si Lëvizje Vetëvendosje, ju atëherë na patët thënë që po i privatizojmë këto ndërmarrje, po i privatizojmë këto asete që të mos bëhen barrë e shtetit, sepse nëse privatizohen, këto do të performojnë mirë, kanë për të zhvilluar ekonominë. Edhe, tash pasi u privatizua kompania, e ka mjel fitimin pronari i ri, vijnë edhe na thonë: "E po, po kemi humbje, po bëhemi barrë e shtetit". Tash, le të na ndihmojë shteti. Domethënë, është shitur me arsye të mos bëhej barrë e shtetit, tash po thua pse shteti nuk po e merr barrën përsipër? Ka një mungesë logjike këtu, zoti Shala, apo ndoshta edhe interesa të tjera.

Pra, fajin kryesor për mospunën e Ferronikelit sot e ka PDK-ja. Fillimisht, duke e penguar zhvillimin e kapaciteteve të reja në energjetikë dhe, së dyti, duke e privatizuar një aset, siç është Ferronikeli, me pretekstin se bëhet barrë e shtetit dhe duhet ta heqim qafe. Tash, prapë po vjen këtu dhe po thua duhet ta bëjmë barrë të shtetit. Po të kishte qenë Ferronikeli shtetëror, ne si shtet patjetër që do të duhej të ndërhyjmë, mirëpo tash ajo është një kompani private. Kur paska humbje, po u dashka të ndërhyjë shteti, e fitimin nesër? Kur ka fitim, a merr shteti diçka? Jo, more s'merr, fitimin e merr pronari. Kështu që nëse doni t'ia ktheni Ferronikelin shtetit, ne do të jemi më se të lumtur që të marrim përsipër obligimet, por përderisa është kompani private, s'kemi punë aty.

Çështja tjetër që u ngrit ishte e gazit. Tash, nuk e kuptoj se si një subjekt politik me gjithë ata ekonomistë, asnjëri prej tyre nuk del të flasë për gazin, por e nxjerrin dikë si Driton Selmanaj që nuk është fare i fushës. Domethënë, kjo është dilema kryesore, qysh u bë puna Driton Selmanaj të dalë e të na kallëzojë se çka është gazi, si ndikon në ekonomi dhe si po na ndikuaka në subjektivitetin e vendit.

Tërë ata ekonomistë i kanë aty, asnjëri s'del të flasë për gazin, e kanë gjetur Dritonin. Domethënë, këtu është problemi, se as nuk po duan të debatojnë këta. Nëse duan të debatojnë, urdhëroni, shtroni argumentet në rrafshin ekonomik, flasim. Por, paraprakisht, para se të diskutosh, pa e shikuar në internet, a e di sa është çmimi i gazit? Pa e këqyr në internet? Veç atë tregoma tani, mund të flasim edhe për gaz. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Ka kërkuar replikë zoti Shala.



FERAT SHALA: Të nderuar qytetarë,

Që në fjalën e parë e thashë kulturën e treguar në zgjedhje ia dëshiroj kësaj qeverie, por fatkeqësisht unë nuk mund të bëj më shumë, kur kjo nuk ka pikë kulture. Nuk ka gjë më mjerim se të dëgjosh një ministër të Financave të thotë çka fiton shteti nga një ndërmarrje private industriale sot.

Pra, një ministër i Financave që nuk e di që shteti fiton rente, me ligj të rregulluara, një ministër i Financave që nuk e di që 1 000 punëtorë, janë punëtorë, qytetarë të Kosovës dhe sot janë në shtëpi dhe sot 1 000 familje i ka lënë në skamje pa bukë, pa të ardhura personale. Një ministër i Financës që kthehet 20 vjet pas dhe kthehet te privatizimi në kohën e UNMIK-ut, kur njeriu që e ka privatizuar sot është anëtar i Vetëvendosjes, shikoi pak, ish-ministër dhe një ministër i cili në mungesë të argumenteve shkencore, njerëzore, intelektuale del dhe fyen opozitën, sinqerisht nuk ka mjerim më të madh qeveritar dhe politik.

Po ta tregoj saktë, ministër, që çmimet e energjisë në treg janë çmime globale të ndikuara jo nga qeveria, nuk thashë, por e ke obligim zyrtar, shtetëror, kushtetues ta menaxhosh krizën. Ka bërë kompania e Ferronikelit kërkesë dy herë t'ju takoj juve, të kthehet në tregun e rregulluar energjetik të Kosovës, kompania është kosovare, është në Drenicë, të mos keni paranojë për këtë. Ka kërkuar ligjërisht të kthehet në tregun e rregulluar energjetik, ka dalë më herët, është kompani private dhe e kërkon tregun e lirë. Çfarë të keqe ka t'ia krijojë qeveria mundësinë një kompanie vendore me 1 mijë punëtorë sot të kthehet në tregun e brendshëm të rregulluar energjetik për shkak të krizës. Ne kemi ndarë buxhet për të subvencionuar kompanitë industriale, ju po i shkatërroni. Pra, nuk ia keni krijuar mundësinë të jetë i barabartë në tregun e brendshëm...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Driton Selmanaj e ka kërkuar fjalën për replikë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesuese!

Këtij farë djalit të ri, prej tash, prej seancave të tjera, ne si grup parlamentar do t'i dërgojmë në zyrën tënde propozimet tona dhe ti na jep leje kush të flasë, në emër të kujt të flasë. Domethënë, në rregull jemi, besoj që tash e tutje, sepse tash e kuptova që ti paske edhe aftësi të tjera.

E dyta, nuk mundem sot të të mbaj leksion se cila është rëndësia e fuqizimit të subjektivitetit tonë ndërkombëtar, nëse rreshtohemi, dëgjomë, se s'po më dëgjon, po e dëgjon patronin tënd, sa e rëndësishme është rreshtimi ynë drejt për të fuqizuar subjektivitetin tonë ndërkombëtar. Adresë tjetër Kosova nuk ka, Serbia e disa vende të tjera kanë adresa të tjera për gaz, ne s'kemi tjetër. Kudo që është Amerika, jemi ne, dhe ku jemi ne, është edhe Amerika, fuqizohet subjektiviteti ynë ndërkombëtar dhe kanë për të ardhur edhe njohje të reja e shumë procese të reja. Nëse rrëshqisni kështu, qysh keni rrëshqitur, normalisht që do të na pengoni, por kjo punë s'ka

shpëtim, kjo veç vonim ka, sepse nesër-pasnesër rrëzoheni ju dhe vjen një qeveri tjetër e përgjegjshme. Por, këto leksione mund t'i mbaj edhe diku tjetër, nëse ke nevojë, por sot besoj që nuk është rasti ndoshta.

**KRYESUESJA:** Vetëm për sqarim, ka kërkuar fjalën zoti Haradinaj dhe zoti Abazi, nuk është referuar tek ju ministri, kështu që po procedojmë me pjesën e kundërreplikës nga ministri dhe vazhdojmë tutje.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Unë edhe një herë thashë, fitimin a e ndan kompania? Sa i përket rentës minerare, ju deputet i nderuar, vitin e kaluar keni votuar t'ia hiqni pagesën, asnjë cent s'e ka marrë Republika e Kosovës pesë muajt e parë të vitit, se ju keni votuar t'ia hiqet pagesa e rentës minerare asaj kompanie. Kemi pasur seancë për këtë çështje, ju ia keni paguar, asnjë cent s'e ka marrë shteti. Kështu që mos manipuloni, Ferronikeli sot është në këtë gjendje për shkak tuajin, për shkak të qeverisjes suaj, po thoni mos u ktheni 20 vjet. Po, normalisht që duhet kthyer. Të gjitha vendimet kanë konsekuenca, konsekuenca sot është Ferronikeli i mbyllur për shkak të vendimeve tuaja, për shkak se keni trajtuar sektorin e energjisë me korrupsion dhe për shkak se keni privatizuar Ferronikelin kur është dashur ta mbajë shteti.

Kurse, sa i përket çështjes së Amerikës, të përmendet për të marrë votat, ka ec ajo punë më, domethënë s'mund të fitoni vota duke e përmendur Amerikën. Për këtë çështje është deklaruar edhe vetë MCC-ja, të gjitha palët e ndërlidhura, ne jemi në bashkëpunim të plotë me ta, po, e kuptoj. Domethënë, sikleti për të fituar vota mund edhe t'ju çojë rrugëve të tilla. Unë fola për logjikë, kështu që faleminderit.

**KRYESUESJA:** Fjalën tani e ka kryeministri Albin Kurti.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Në veri të Ibrit ka më shumë rend dhe ligj tani e sot se sa kurdoherë tjetër që nga shpallja e pavarësisë. Asnjë barrikadë nuk ka në veri të Kosovës. A ka shumë punë e sfida? Po! Sepse, ato janë të trashëguara, por një nga një dhe krejt do t'i zgjidhim.

Veriu ka qenë i rrezikuar atëherë deputeti Haradinaj e priste në zyrë kriminelin Milan Radojçiq, atëherë ka qenë veriu i rrezikuar. Rreziku ka qenë nga marrëveshjet gjentelmene me kriminelë, nuk e rrezikon veriu policia, veriu e rrezikojnë kriminelët dhe bashkëpunimi i tyre me politikanët e të gjitha ngjyrave dhe përkatësive dhe kjo ka ndodhur publikisht në korrik të vitit 2018. Atëherë është rrezikuar veriu, jo tash. Fjala e deputetit Haradinaj është sulm në moralin e policit të Kosovës që ai kur të shkojë në veri, të ketë dilema. Po kot e keni, deputeti Haradinaj. Morali i policit të Kosovës është shumë i lartë, kot e keni që po e sulmoni. Edhe atëherë kur

shkon me Njësinë Speciale për ta mbrojtur policin tonë kufitar, për të vendosur reciprocitet, edhe atëherë kur e lufton krimin, korrupsionin e kontrabandën në Veri. Morali i policit tonë është i paprekshëm. Unë i kam takuar udhëheqësit e Njësisë Speciale, kam takuar policinë tonë, kurrë morali i tyre s'ka qenë më i fuqishëm, e ju po përpiqeni ta sulmoni moralin e policisë tonë atëherë kur do të shkojë veri.

**KRYESUESJA:** Ka kërkuar replikë Ramush Haradinaj.

**RAMUSH HARADINAJ:** Dëgjoni, është interesant, ne jemi këtu deputetë dhe politikanë, edhe po duam ta kthejmë diskutimin te morali i trupave në terren. Unë nuk e kam qëllimin te morali i trupave, se i besoj Policisë së Kosovës, i besoj ushtarit të Kosovës. Unë frikën e kam te ti, kryeministër, që ti qëllimshëm i ke ndërmarrë dy veprime ta dorëzosh veriun. Këtë jam duke e thënë, pra unë besoj që skenar yti t'i ndërmarrësh dy veprime, e ta lësh pastaj zbrazët që të forcohen kriminelët, i ke bërë qëllimshëm. Kaq!

**KRYESUESJA:** Kryeministri Kurti e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Kriminelët në veri, strukturat ilegale kurrë nuk kanë qenë më të frikësuar se tash. Prandaj, nuk kemi nevojë të më frikësoheni mua, nuk dorëzohet veriu, por mos ngjallni dilema te polici kur të shkojë herën e ardhshme në veri, se kush e di pse të ka çuar Albini atje? Kjo është e dëmshme dhe këtë s'ta ka borxh askush.

**KRYESUESJA:** Të nderuar deputetë, më vjen keq, por është kryer kjo pjesë, nuk ka, është vetëm replikë dhe kundër-replikë.

Atëherë, nuk ka të tjerë të paraqitur nga Qeveria për fjalë. E mbyllim këtë pjesë të deklarimeve jashtë rendit të ditës.

## **2. Pyetjet parlamentare**

Atëherë, të nderuar deputetë ju njoftoj se në bazë të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit koha për pyetje parlamentare zgjat deri në 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar pesë pyetje parlamentare. Fillojmë me deputeten Blerta Deliu-Kodra, ka pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, zonja nënkryetare! Në fakt, po kam pak frikë ta bëj pyetjen, sepse është çështja e njëjtë, të cilën e diskutoi edhe deputeti Selmanaj, sidoqoftë, pyetja lidhet me çështjen e energjisë. Natyrisht që çështja e energjisë është çështje edhe e sigurisë, përveçse ekonomisë, njëkohësisht është edhe çështje e orientimit tonë properëndimor.

Dua të them se në vitin 2019 Kroacia, Bullgaria, Greqia, Serbia, sipas Gazpromit janë së bashku, kanë blerë rreth 10 miliardë metër kub gaz rus. Shtrirja e ndikimit energjetik ekonomik patjetër që shndërrohet edhe në ndikim politik, kjo u tha edhe më herët, ndërkohë që Partia Demokratike e Kosovës ka kërkuar edhe një interpelancë lidhur me këtë çështje dhe, po ashtu, është shtruar disa herë në seancë parlamentare.

I nderuari kryeministër, pse ka aq shumë paqartësi kur bëhet fjalë për projekte, të cilat lidhen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Pse çdoherë vihet në pikëpyetje diskutimi dhe relacioni jonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? A do të duhej që t'i informoni më saktë qytetarët për qëndrimin e Kosovës rreth projektit TAP? Ju keni thënë disa herë, edhe në seancën tonë plenare, por konsideroj që duhet dhënë përgjigje, që do të duhej ta marrin qytetarët dhe ne si deputetë.

**KRYESUESJA:** Fjalën e ka kryeministri Kurti.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** E nderuar deputete Deliu-Kodra!

Ju faleminderit për pyetjen tuaj! Qeveria e Kosovës që nga fillimi i mandatit ka punuar intensivisht për t'i analizuar mundësitë e ndërtimit të gazsjellësit, që do ta lidhë Kosovën me Maqedoninë e Veriut, i cili pastaj vazhdon nga Maqedonia e Veriut në Greqi, e ku lidhet më pastaj me TAP-in.

Gjatë kësaj periudhe ne kemi punuar posaçërisht për t'i qartësuar disa çështje. Koston e komponentëve të ndryshëm të infrastrukturës, mënyrën e financimit dhe sa do të duhej të marrim kredi si shtet, përdorimit të potencialit të gazit dhe nga kush? Për shembull, a do të ishte fizibile të përdorej për ngrohje qendrore, apo do të mund të përdorej vetëm për prodhimin e energjisë elektrike? Entitetin dhe kushtet e ndërtimit dhe operimit të termocentralit eventual me gaz dhe ndikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga gazi në çmimet e energjisë.

Marrja e këtyre informatave dhe analizimi me sukses i tyre janë procese normale, që i ndërmerr një qeveri. 22 vjet nuk ka pasur vendime të mëdha për energji dhe ne në pak muaj të marrim një vendim për 22 vjetët e ardhshme është joserioze nëse ngutemi, është papërgjegjësi nëse nxitohemi.

Prandaj, ne jemi siguruar që vendimet të jenë sa më shumë të informuara, duke i marrë parasysh në radhë të parë përfitimet dhe çmimin që paguajnë bizneset e qytetarët, si dhe taksapaguesit tanë, se kur ta marrim gazin dikush duhet ta paguajë. Nuk e paguajmë ne si politikanë, e paguan qytetari i Republikës së Kosovës.

Në këto analiza kanë qenë të përfshirë e janë këshilluar ekspertët më të mirë të energjisë që i kemi, duke përfshirë ekspertët nga Ministria e Ekonomisë, ZRRE-së, KOST-it, KEK-ut, ekspertë të pavarur në vend e në Diasporë, si dhe ekspertë ndërkombëtarë. Ky proces ka ndodhur në

bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Amerikane - Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit apo MCC-ja, siç njihet, të cilët ne i falënderojmë shumë. Ministria Rizvanolli, ministri Murati, unë, MCC-në nuk ka javë që s'i kemi takuar prej verës e këndeje.

Pra, jemi në komunikim, në bashkëpunim të rregullt me ta, por nuk ka kamera televizive që në vend të transkriptit të ketë xhirim live.

Më lejoni të theksoj që marrëdhëniet me MCC-në, Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe me asnjë tjetër institucion amerikan nuk janë rrezikuar në asnjë moment.

Sa u përket raporteve tona me Greqinë, të cilat janë intensifikuar kohëve të fundit, nuk bazohen në kushtëzime ndaj njëri-tjetrit, “merre gazin, ta jap njohjen”. Nuk është ashtu. Pavarësia e Republikës së Kosovës nuk e shkelur asnjë normë ndërkombëtare, fakt ky i njohur edhe nga GJND-ja, që njihet edhe vetë nga ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, zotit Demdias.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, zoti kryeministër! Zonja Deliu, a keni pyetje shtesë?

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, zoti kryeministër!

Në fakt, po flasim për një projekt, për të cilin tashmë është kryer studimi i fizibilitetit dhe këtë e kemi të qartë të gjithë. Nëse nuk ka një bashkëpunim, natyrisht nuk ka një marrëveshje, ose ujdj, ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës, cila është alternativa që e ka Qeveria? Sepse, ju pafundësisht, zoti kryeministër, po thoni se jeni në diskutime me ekspertë, por asgjë konkrete nuk ka në këtë drejtim. A do të ketë qartësi dhe cila do të jetë qartësia juaj, nëse nuk janë alternativë SHBA-të, cili do të jetë orientimi i Kosovës lidhur me këtë çështje?

**KRYESUESJA:** Kryeministri Kurti e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Ne do ta sjellim strategjinë për energji në Kuvendin e Republikës. Është një çështje tepër e madhe, qysh e thatë edhe ju, s'ka të bëjë veç me ekonominë, ka të bëjë edhe me sigurinë. Mandej, ka të bëjë me qëndrueshmërinë financiare, ka të bëjë me politikat industriale, ka të bëjë me ruajtjen e mjedisit. Me çka s'ka të bëjë, në fakt. Prandaj, na duhet një strategji, e cila votohet edhe këtu në Kuvend dhe unë do të thosha jo me shumicë të thjeshtë, sepse i kalon ciklet elektorale.

Javën e kaluar ne kemi marrë vendim që fondet e MCC-së të përdoren për projekte të tjera në sektorin e energjisë. Ne do të vazhdojmë të analizojmë nëse ndërtimi i gazsjellësit dhe komponentëve të ndryshëm të infrastrukturës së gazit janë fizibile dhe opsioni më i mirë për tranzicionin energjetik të Kosovës nga qymyri deri te të ripërtërishmet, duke marrë parasysh edhe efektet në ambient dhe përbalueshmërinë e çmimeve. Pra, ne fondet do t'i përdorim në fushën e... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Regjia, vazhdoja fjalën! Në rregull! Atëherë, vazhdojmë me deputeten Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për zëvendëskryeminstren dhe ministren Donika Gërvalla-Shvarc.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: E nderuar, faleminderit!

Unë i kam bërë pyetje zëvendëskryeminstres dhe kam marrë përgjigje me shkrim. Mirëpo, marrja e përgjigjes me shkrim dhe mosprezenca e saj në Kuvend nuk do ta zbehë rëndësinë e temave të rëndësishme që i kam ngrehur dhe kanë të bëjnë me fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës sonë në arenën ndërkombëtare. Andaj, unë pyetjet e mia do t'i përsëris dhe do ta pres ministren që të vijë e të ma kthejë përgjigjen, sepse është në interes të përgjithshëm dhe jo në interes timin personal. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zonja Shoshi, e keni edhe pyetjen tjetër për ministren. Domethënë, është e njëjtë? Në rregull! Vazhdojmë me pyetjet e parashtruara për herë të parë, e kemi deputetin Bekim Haxhiu që ka pyetje për ministren Arbërie Nagavci.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesuese!

E nderuara ministre,

Viti i ri shkollor filloi me vonesë për shkak të situatës së pandemisë COVID-19. Më datë 27 shtator mësimin e filluan të gjithë nxënësit në Kosovë, përveç nxënësve të komunës së Dardanës në brezin kufitar me Serbinë. Për problemet e krijuara nga kryetari Qëndron Kastrati tre vjet më parë, e që vazhdon edhe këtë vit, po besoj që jeni njoftuar me problemet e tilla të veçanta që i ka shkaktuar në arsim në komunën e Dardanës, në emër të reformave në arsim dhe ka mbyllur disa nga shkollat në këtë komunë.

Mbyllja e shkollave shqipe në brezin kufitar me Serbinë në emër të reformave dhe transferimi i nxënësve në shkolla të qytetit të Kamenicës paraqet problem serioz për shpërngulje të popullatës nga brezi kufitar me Serbinë. Për shkak të kësaj, nxënësit e kësaj komune po detyrohen të udhëtojnë deri në 25 km në një drejtim dhe ky është problem serioz për nxënësit dhe familjet e tyre. Ndërsa, në po ato lokalitete vazhdojnë të funksionojnë shkollat në gjuhën serbe.

E nderuara ministre, cila është përgjigjja juaj për nxënësit e komunës së Dardanës, të cilët nuk po mund ta vijojnë mësimin? A keni ndonjë plan konkret, si të rifillojë mësimi në shkollat që janë mbyllur në fshatrat që janë në brezin kufitar të komunës së Dardanës dhe a keni ndonjë plan konkret se si të udhëzohen komunat që kanë probleme të ngjashme?

KRYESUESJA: Fjalën e ka ministrja Nagavci.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar deputet Haxhiu,

Sikur jeni në njohuri dhe e kemi diskutuar edhe këtu në Kuvend, jo vetëm se e kemi përcjellë situatën në lidhje me vijimin e shkollimit nga rreth 500 nxënës në komunën e Dardanës, por edhe jemi marrë aktivisht me këtë çështje.

Në prill të vitit 2021 ne kemi nxjerrë vendim për organizimin e mësimit alternativ të përshpejtuar, gjë që ua ka mundësuar rreth 500 fëmijëve të komunës së Dardanës që ta realizojnë të drejtën e tyre të garantuar edhe me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi dhe ata fëmijë kanë vijuar mësimin sipas planprogramit që është hartuar nga Ministria e Arsimit dhe me përfundimin e mësimit në muajin gusht të vitit 2021 kemi kërkuar nga komuna e Kamenicës, konkretisht nga Drejtoria Komunale e Arsimit atje që të bëjë vlerësimin e nxënësve sipas legjislacionit në fuqi.

Meqenëse kjo nuk është realizuar, pra nuk është organizuar vlerësimi i nxënësve dhe si rezultat i mosreagimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, ne e kemi angazhuar Inspektoratin e Arsimit dhe në koordinim me drejtuesit e shkollave e kemi realizuar edhe procesin e vlerësimit të nxënësve të këtyre shkollave. Janë vlerësuar tashmë nxënësit e katër shkollave dhe janë në përfundim të procesit të vlerësimit edhe nxënësit e një shkolle.

Po ashtu, edhe këtë vit shkollor, sikur e përmendët, mësimi nuk ka filluar. Kjo për arsye se Drejtoria Komunale e Arsimit i ka angazhuar mësime të tjerë që të shkojnë në shkolla tjera atje, ndonëse si ministri i kemi pajisur edhe nxënësit e këtyre shkollave me tekste shkollore, ashtu sikur edhe në vitin e kaluar.

Më lejoni të ju njoftoj që me inicim nga kryetari i Komunës, lënda është në trajtim në Gjykatën Kushtetuese. Ne i kemi dorëzuar komentet tona. Koha ka kaluar dhe besojmë që Gjykata Kushtetuese shumë shpejt do të dalë me një vendim dhe do të dëshmojë që Ministria e Arsimit nuk e ka shkelur asnjë ligj, përkundrazi e ka realizuar të drejtën e garantuar të nxënësve në mësime dhe presim që të gjithë nxënësit shumë shpejt ta vijojnë mësimin e rregullt.

Përtej kësaj, në lidhje me situatat e ngjashme në komuna të tjera, ju njoftoj se si Ministri e Arsimit jemi duke planifikuar dhe një grup punues shumë shpejt do të punojë në planifikimin e riorganizimit të shkollave në nivel vendi, sepse ky duhet të jetë një vendim i koordinuar ndërmjet ministrisë dhe komunave, përfshirë edhe ekspertë të arsimit, duke përdorur të njëjtat standarde në të gjitha komunat, duke e ruajtur buxhetin, por edhe duke u siguruar që secili prej nxënësve kudo në shkolla të Republikës së Kosovës të ketë qasje në arsim cilësor. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Zoti Haxhiu, keni... ? Në rregull! Deputeti Ramush Haradinaj ka pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

**RAMUSH HARADINAJ:** Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë,

Kabinet qeveritar,

Sapo kryeministri tha se ka vendosur që fondet e MCC-së do t'i orientojë në aspekte të tjera të energjisë.

Imagjinojeni sa lajm i keq për Kosovën. Pas tre vjet pune intensive e dakordimit që në nëntor të ndodhë investimi i gazsjellësit amerikan, kryeministri na njoftoi që ky ka vendosur, pra në emër të Kosovës, në këtë rast, në emrin e juaj e të taksapaguesve të Kosovës, ky ka vendosur t'i devijojë ato fonde për aspekte të tjera energjetike. "Do t'i shfrytëzojmë..."

Ende s'i ka marrë ato para, Kosova ka pasur t'i marrë ato tash në nëntor, ky zotëria ka vendosur t'i çojë në drejtime të tjera të energjisë?

Nëse për këtë dhe Kabinetin e tij, pra pyetja, kryeministër, meqë ju keni vendosur që tash ka ndryshuar gjendja, ju e konfirmuat që ju keni vendosur t'i çoni në drejtime të tjera të energjisë, a mund të na tregoni kur do të sillni gaz në Kosovë më lirë se sa me 200 milionë para falas të Amerikës, se ju për kosto e paskeni fjalën, 100 milionë kredi, prej të cilave 20 milionë grant, pra 20 milionë falas. Kur keni për të mbërri që t'ia jepni Kosovës këtë shans, ta sillni gazin në Kosovë më lirë se tash? A doni ju me Buxhet të Kosovës ndonjëherë, apo e keni alternativën diku tjetër? Duhet t'ia jepni këto shpjegime Kosovës. Pse zëvendëskryeministri i Kosovës e ka quajtur këtë projekt "gaz rus"? Na tregoni, ju lutem, pse i merrni këto vendime?

**KRYESUESJA:** Fjalën e ka kryeministri Kurti.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Së pari, fizibiliteti bëhet që të kuptohet se kur e çka është më së miri, prandaj edhe bëhet fizibiliteti.

Tjetra, ne e kemi qartësuar disa herë dhe nuk është hera e parë që i përgjigjem pyetjes së njëjtë. Granti nuk është humbur, e as nuk ka qenë rrezik të humbet në asnjë moment. Gjithashtu, e kemi qartësuar se granti prej deri në 200 milionë dollarë nuk është ndarë për infrastrukturë gazi specifikisht, megjithëse ky opsion ka qenë duke u studiuar, se përndryshe do t'i kishim humbur fondet. Ne kemi vendosur që grantin ta shfrytëzojmë për investime tjera.

Qeveria e Kosovës nuk ka vënë kushte sa i përket këtij projekti, as MCC-ja nuk i ka vënë kushte Qeverisë. Ky ka qenë dhe mbetet një partneritet ndërmjet Qeverisë dhe MCC-së, ku së bashku janë trajtuar çështjet si dizajni teknik dhe fizibiliteti ekonomik. Qeveria e Kosovës thjesht e ka vlerësuar me kujdes projektin dhe ndikimin në çmimet e energjisë.

Kriza energjetike botërore që parashikohet nga ekspertë se do të zgjasë deri nga mesi i vitit tjetër, nuk ka të bëjë asgjë me këtë projekt, e as me gazin. Së pari, termocentrali me gaz i paraparë në atë projekt do të hynte në përdorim pas tetë vjetësh. Tetë vjet, as tetë javë, as tetë muaj, tetë vjet,



në rastin më të mirë bile. Ndërsa, ju në pyetjen e juaj po flisni për një krizë që parashikohet të përfundojë pas tetë muajsh. 8 vjet me tetë muaj, 1 : 12.

Së dyti, ju informoj që oferta e pamjaftueshme për gaz dhe çmimet e larta të gazit në fakt janë ndër shkaktarët kyçë të kësaj krize. Sikur ne sot të kishim termocentral me gaz do të duhej ta pezullonim përdorimin e tij për shkak të çmimeve të larta, siç po ndodh gjithandej në Evropë. Çmimi i gazit është trefishuar në Evropë, e në disa vende, si Polonia, është shtatëfishuar. Po ta kishim do të duhej ta ndalnim. Ne jemi të përgjegjshëm, sepse jemi të kujdesshëm.

Së treti, ju keni të drejtë që diversifikimi i burimeve energjetike, siç e keni thënë në pyetje, është shumë me rëndësi, por gazi një burim fosil nuk është as mënyra e vetme, as më e mira, për ta bërë këtë. Burimet e ripërtëritshme do të na kishin ndihmuar në këtë krizë, por s'i kemi.

Unë nuk e di se si keni arritur në përfundim që mosndërtimi i termocentralit me gaz e rrezikon pavarësinë energjetike të Kosovës, që e kemi arritur në vitin 2020 dhe rikthimi i varësisë energjetike nga Serbia. Nuk ka kurrfarë logjike kjo. Nuk është e saktë që Qeveria nuk i mbështeti studimet aktuale dhe të mëtejme për komponentin e prodhimit me gaz për qëllimin e rezervave sekondare e terciare për balancim të rrjetit, siç është thënë. Qeveria ka bashkëpunuar me MCC-në në studimin e kësaj çështjeje dhe deri në momentin kur për shkak të afatit kohor është vendosur që granti të dedikohet në investime...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Zoti Haradinaj, a keni pyetje shtesë?

**RAMUSH HARADINAJ:** Ka shumë të pasakta në atë që thoni, kryeministër. Paratë janë dedikuar për gazsjellësin, pra janë të dedikuara për gaz. Tani po jua shpjegoj se si.

Fillimisht, projekti është 200-milionësh për diversifikim të burimeve në energji. Pas tri vjet negociimi ndërmjet të paktën dy qeverive, Haradinaj dhe Hoti, është arritur te dakordimi dhe këto para tani janë të dedikuara për gazsjellësin. Nëse ju nuk i merrni këto para tash, ju do t'i humbni edhe tre vjet tjera për t'i marrë këto para për ndonjë projekt të ri.

E dyta, ju po thoni “krizë tetëmuajore”. Më falni bre, ku i keni këta ekspertë që po ju rrejnë për “tetë muaj krizë”. Në përgjithësi, në vazhdimësi është duke u krijuar një situatë më e rëndë energjetike, edhe në Evropë, edhe në botë. Dikush ka vendosur t'i heqë burimet bërthamore, dikush po i...

**KRYESUESJA:** Fjalën e ka kryeministri Kurti.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Kurrfarë parash nuk kanë pasur të vijnë në nëntor dhe nuk është e vërtetë që fondet janë ose gaz, ose hiç. Nuk është e vërtetë!

Ne e kemi pasur rastin e Countur Globalit, sa u përket aleancave që po i përmendni. U nënshkrua Countur Global-i, nuk u ndreq aleanca. U prish Countur Globali, nuk u ndreq aleanca, sepse është shumë e fuqishme. Është gabim instrumentalizimi i SHBA-ve për ta luftuar kryeministrin e Kosovës. Këtë e ka treguar edhe populli i Kosovës. Pra, sa e dëshironi e i doni ju Shtetet e Bashkuara të Amerikës tregon lehtësia me të cilën i instrumentalizoni ata kundër kryeministrit të Kosovës.

Ju keni nënshkruar 18,5% shkallë të kthimit të brendshëm kapital me Countur Global. A e dini pse e keni nënshkruar këtë dhe që do t'ia blini krejt rrymën që e prodhojnë, pavarësisht sa na duhet? Sepse, ju me para të shtetit jeni shumë dorëlibër, e me paratë e juaja private jeni shumë koprracë. Konkretisht, keni blerë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit 198,9 hektarë tokë bujqësore, plantacionin e vishnjave dhe lajthive në fshatin Irzniq me çmim total prej 70 003,52 euro/centë për ari. Po, ky është turp! Pra, me para të shtetit je shumë dorëlibër. 18,5% Countur Globali, jepja se e ndreqim aleancën me Amerikën për disa gypa. Nuk ndreqet aleanca me disa gypa. Kjo është cektësia dhe shkurtpamësia juaj. Kurse, me para tuajat doni ta blini arin me 3 euro e gjysmë! Turp! Po, ky është turp!

*(Reagime nga salla)*

Po, çfarë çmimi është ai? Kjo është zhvatje! Pra, koprrac me para private, dorëlibër me para të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Të nderuar deputetë, me kaq e përfundojmë pikën rreth pyetjeve parlamentare.

Para se të procedojmë me pikën e radhës për miratim të procesverbalit nga seancat e mëparshme, kemi kërkesë për plotësim të rendit të ditës me dy pika. Njëra ndërlidhet me Projektligjin për ratifikimin e amendamentit 1 të Marrëveshjes financiare për IPA 2017 dhe pika tjetër ndërlidhet me zëvendësimet e deputetëve nga Partia Demokratike e Kosovës në tri nga komisionet, sipas kërkesës.

Për pikën e parë, që ndërlidhet me Projektligjin për ratifikimin e amendamentit 1 të Marrëveshjes financiare për IPA 2017 e ftoj zonjën Arbëreshë Kryeziu-Hyseni nga komisioni përkatës që ta bëjë propozimin dhe ta sqarojë kërkesën.

**ARBËRESHË KRYEZIU-HYSENI:** Faleminderit, nënkryetare!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Ju kolegë deputetë,

Qytetarë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj që me anë të mocionit procedural në kuadër të rendit të ditës sot të futet edhe një pikë, pra ajo për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për ratifikimin e amendamentimit nr. 1 të marrëveshjes financiare IPA 2017 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian si pjesë e parë.

Duke e pasur parasysh se për këtë propozim kërkohet shmangie procedurale dhe nevojiten 2/3-at e votave të deputetëve, ftoj deputetët e Kuvendit që ta mbështetin me votë pro, në mënyrë që për këtë pikë ta kemi mundësinë të diskutojmë bashkërisht në kuadër të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Besnik Bislimi, që ta paraqesë dhe arsyetojë propozimin.

Ju kërkoj ndjesë për pjesën e kërkesës, zoti Bislimi! Kërkoj në fakt deklaram nga kryetarët e grupeve parlamentare për këtë mocion procedural. Nga Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetare!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje mbështet propozimin dhe gjithashtu thërret të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojnë atë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesuese!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet propozimin dhe i ftoj më deputetët që të kthehen në sallë që t'i bëjmë 2/3-at. Faleminderit!

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah, megjithëse po duket që është një rrëshqitje teknike, ndryshim i një fjale nga “projektligj” në “ligj”, por po e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull! Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Grupi ynë parlamentar e mbështet këtë mocion procedural.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Multietnik, fjalën e ka Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, nënkryetare!  
Si Grup Parlamentar e mbështetim propozimin.

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Kervan! Atëherë, për t'iu shmangur Rregullores së Kuvendit, Kuvendi vendos me 2/3-at e deputetëve të pranishëm në seancë plenare, që marrin pjesë në votim.

Propozimi është që këto dy pika të hyjnë në pikë të rendit të ditës si pikë e 4-t dhe e 5-të të rendit të ditës, domethënë pas miratimit të procesverbalit. Besoj se është në rregull me këtë renditje.

Atëherë, në sallë janë të pranishëm 93 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Në ndërkohë edhe një deputet na është bashkëngjitur. Kështu që janë 94 të pranishëm dhe 94 që kanë marrë pjesë në votim. Kuvendi e miraton plotësimin e rendit të ditës dhe shmangien nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe neni 56, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e amendamentimit nr. 1 të Marrëveshjes financiare për IPA 2 - 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe kjo pikë radhitet si pikë e katërt e rendit të ditës.

Atëherë vazhdojmë me pikën tjetër. Ftoj z. Abelard Tahiri që të paraqesë dhe arsyetojë propozimet.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Në cilësinë e shefit të Grupit Parlamentar prezantoj disa ndryshime sa i përket përbërjes nëpër komisione, përfaqësimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Pra, kërkoj që të mbështetni që në Komisionin për Siguri, unë deputeti Abelard Tahiri. Apo fillimisht ta prezantoj vetëm si pikë e rendit të ditës, pastaj i propozoj edhe ndryshimet? Atëherë, kërkoj që kjo me votën tuaj të miratohet që të jetë pjesë e rendit të ditës që të bëhen këto ndryshime të përfaqësimit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në komisione dhe pastaj kur t'i vijë radha do t'i prezantojë ndryshimet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull!

Edhe një herë për të sqaruar, d.m.th. për t'iu shmangur Rregullores së Kuvendit vendosim me dy të tretat e deputetëve të pranishëm në seancën plenare.

Atëherë, të pranishëm janë 93 deputetë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë,

Me 91 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi plotësimin e rendit të ditës dhe shmangien nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e propozimit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare. Kjo pikë e rendit të ditës radhitet si nr. 5 i rendit të ditës.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

### **3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme**

Vetëm po presim të shohim sa është prania e deputetëve. Të pranishëm janë 91 deputetë.

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 12 gusht dhe 4 tetor 2021?

Nëse nuk ka vërejtje, atëherë konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtura më 12 gusht dhe 4 tetor 2021.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

#### **\* Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-054 për ratifikimin e amendamentimit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian**

Të nderur deputetë,

Komisioni Funkcional për Integritet Evropian e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me një amendament të propozuar.

Ftoj zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI:** Faleminderit e nderuar kryesuese!

E nderuar zëvendëskryeministre Rexhepi,

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Paraqes para jush Projektligjin për ratifikimin e amendamentimit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Qëllimi i amendamentimit të marrëveshjes në fjalë është që të mundësohet riallokimi i shumës prej 2.3 milionë eurove nga disa kontrata të pashpenzuara dhe kursime në kuadër të veprimit 1 të programit, përkatësisht instrumentit të përafrimit me ‘acquis’ e Bashkimit Evropian dhe përmes kësaj të mundësohet kontraktimi i kësaj shume me kontrata ekzistuese brenda afatit kontraktual prej tre vitesh nga hyrja në fuqi e marrëveshjes origjinale e që data gjenerale ka qenë 22 tetor 2018. Riallokimi do të shtojë 2.3 milionë euro në veprimin nr. 1, instrumenti i përafrimit të ‘acquis’ dhe Bashkimit Evropian, nga veprimi nr. 2 - mbështetja në pjesëmarrje të programeve të BE-së dhe atë në shumën e 300 mijë eurove. Nga veprimi nr. 3 - mbështetja e Bashkimit Evropian për përparësitë politike dhe dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit në shumën e 1,9 milion eurove dhe nga veprimi nr. 5 - mbështetja Bashkimit Evropian për sistemin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Kosovë 0.1 milion euro. Shumat e marra nga këto projekte janë kursim dhe do të shfrytëzohen për të mbështetur zbatimin e projekteve në vazhdim. Kryesisht shtesë për projektin e ndërrimit të filtrave për Kosovën B dhe shtesë për ndërtimin e shkollave të parapara me marrëveshjen financiare origjinale.

E vetmja mënyrë që të bëhet kontraktimi i këtyre mjeteve brenda kornizës ligjore për fondet e BE-së është përmes kësaj marrëveshjeje. Zyra e Bashkimit Evropian është autoriteti kontraktues dhe ata do t’i riallokojnë mjetet e parapara në marrëveshje në pajtim me rregullat e përcaktuara nga vetë Bashkimi Evropian për fondet IPA dhe në pajtim me marrëveshjen kornizë për zbatimin e IPA-s ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian që ka hyrë në fuqi në vitin 2015.

Edhe njëherë shfrytëzoj rastin t’ju falënderoj të gjithë juve për gatishmërinë e trajtimit me shpejtësi të kësaj teme dhe ju lus që të njëjtën ta aprovoni. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Tani e ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Integritime Evropiane, znj. Rrezarta Krasniqi, për arsyetimin e raportit të Komisionit.

**RREZARTA KRASNIQI:** Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Integritim Evropian në bazë të nenit 60, 67 dhe 69, paragrafi 5 i Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 15. 10. 2021 shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-054 për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe vendosi që Kuvendit t’i paraqesë këtë rekomandim:

Miratimin e Projektligjit nr. 08/L-054 për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me një amendament të propozuar nga Komisioni si vijon:

Amendamenti nr. 1: Në titullin Projektligji, fjala projektligj të zëvendësohet me fjalën ligj. Këtë arsyetim e paraqes në emër të Komisionit për Integrim Evropian.

Të nderuar kolegë deputetë,

Me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje do të fillojë zbatimi i asistencën financiare i Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të instrumentit të IPA-s. Kjo asistencë financiare do të mundësojë mbështetjen sektoriale për Kosovën në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga procesi i integritit evropian dhe posaçërisht nga MSA-ja.

Sipas marrëveshjes financiare për IPA 2017, kostoja e përgjithshme e saj është 49.5 milionë euro, nga të cilat 48 milionë euro janë kontribute të BE-së. Kjo marrëveshje ka për qëllim të bëjë rialokimin e mjeteve ndërmjet veprimeve brenda të njëjtit vendim financiar, përkatësisht është bërë modifikimi i programit të veprimit për Kosovën për vitin 2017. Ndërsa, sektorët të cilët mbështeten sipas kësaj marrëveshje janë: demokracia dhe qeverisja, sundimi i ligjit, të drejtat themelore, mjedisi, veprimi dhe energjia klimatike, konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural si dhe arsimit, punësimi dhe politikat sociale.

Në sektorin e demokracisë dhe qeverisjes do të mbështeten pesë veprues kryesisht në forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të institucioneve të Kosovës në lidhje me zbatimin e agjendës për reforma evropiane. Mbështetja e menaxhimit efektiv dhe efikas të përfitimit nga instrumenti i ndihmës së paraanëtarësimit, pra IPA e fondeve. Pastaj zbatimi i dialogut të lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, arritjen e objektivave sipas MSA-së, forcimin e kapaciteteve efikase dhe efektive në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në kuadër të koordinimit dhe menaxhimit të programeve të BE-së.

Në sektorin e sundimit të ligjit dhe të drejtat themelore synohet të rritet ndikimi efektiv i Institucionit të Avokatit të Popullit si një veprim në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë.

Në sektorin e mjedisit, veprimit të klimës dhe energjisë, mbështetet një veprim që synon të kontribuojë në përdorimin efikas të energjisë në sektorin publik dhe të ndihmojë Kosovën në rregullimin e përdorimit të energjisë në përputhje me traktin e komunitetit të energjisë dhe planit të veprimit të eficiencës dhe energjisë në Kosovë.

Kurse në sektorin e konkurrencës, inovacionit, bujqësisë dhe zhvillimit rural janë dy veprime: konkurrenca dhe inovacioni, përmes të cilave synohet digjitalizimi i ekonomisë dhe rritja e krijimi i vendeve të reja të punës, kurse në bujqësi dhe zhvillim rural, mbështetja e Agjencisë Kosovare për Ushqime dhe Veterinari në përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së si dhe praktikave më të mira në kuadër të kësaj fushe.

Në sektorin e fundit, arsimit, punësimi dhe politikat sociale, do të realizohen dy veprime: forcimi i cilësisë dhe rëndësisë së programeve të arsimit dhe aftësimi profesional për tregun e punës, si dhe përmirësimi i infrastrukturës për rritjen e cilësisë në arsim me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Kosovës duhet të punojë më shumë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të institucioneve tona që të zhvillojë dhe të aplikojë më tepër në programet dhe projektet e ndihmës financiare të parapara pra të fondeve IPA, qoftë në nivelin qendror apo në nivelin lokal. Sidomos për shtatë vitet e ardhshme, në kuadër të instrumentit të ri financiar siç është IPA 3 për periudhën 2021-2027.

Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshje dhe asistencën financiare të Bashkimit Evropian që të realizohet përmes fondeve IPA, Komisioni për Integrim Evropian pas shqyrtimit të kësaj marrëveshje ka rekomanduar ratifikimin e saj në Kuvend, pra të miratohet Projektligji 08/L-054 për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, së bashku me amendamentin e propozuar. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, znj. Krasniqi! Tani radhën e kanë grupet parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka Arbëreshë Kryeziu-Hyseni.

**ARBËRESHË KRYEZIU-HYSENI:** Faleminderit nënkryetare!

Në fillim të këtij muaji Qeveria e Republikës së Kosovës pra ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Amendamenti ka për qëllim rialokimin e 2,3 milionë eurove të pashpenzuara dhe kursimeve në kuadër të instrumentit të përafrimit me 'Acquis' të Bashkimit Evropian. Kjo do të mundësojë kontraktimin e kësaj shume në kontrata ekzistuese brenda afatit kontraktues prej tri vitesh që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes origjinale pra në tetor të vitin 2018.

Këto mjete do të dedikohen kryesisht në ndërrimin e filtrave të termocentralit Kosova B dhe në ndërtimin e shkollave që janë paraparë në marrëveshjen financiare origjinale. Javën që shkoi e kemi trajtuar edhe në Komisionin për Integrim Evropian në të cilin ka qenë i ftuar edhe



zëvendëskryeministri i parë Besnik Bislimi për të prezantuar këtë marrëveshje. Për mbajtjen e këtij takimi, ka qenë një nevojë urgjente për të diskutuar mbi rëndësinë e kësaj marrëveshjeje, të cilën anëtarët e Komisionit e kanë votuar për ta sjellë për votim sot në seancën e Kuvendit. Kalimi i kësaj pike është tejet i rëndësishëm sot, sepse në të kundërtën shuma prej 2,3 milionë euro do t'i kthehet mbrapa buxhetit të Bashkimit Evropian, ose thënë ndryshe nëse nuk votohet kjo marrëveshje sot, Kosova humb pra këto mjete që janë 2,3 milionë euro dhe humb mundësinë e shfrytëzimit të këtyre mjeteve në projektet e parapara të cilat u përmendën edhe më herët.

Prandaj, ne si grup parlamentar e mbështesim këtë Projektligj dhe ftoj edhe grupet e tjera që ta bëjnë të njëjtën gjë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës fjalën e ka znj. Blerta Deliu.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit e nderuar nënkryetare!

Edhe Partia Demokratike e Kosovës në javën e kaluar në mbledhjen e Komisionit për Integritet natyrisht e kemi përkrahur Projektligjin për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Është tejet e rëndësishme që kjo të kalojë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, meqë këto janë fonde të cilat destinohen për qytetarë të Republikës së Kosovës.

Edhe në Komision kam kërkuar që të rriten kapacitetet, veçanërisht të komunave, që ato të jenë përfituese, sepse jo rrallë ndodh që komunat me popullatë më të vogël, për shkak të punës së mirë në përpilimin e projekteve të jenë përfituese, ndërkohë që komunat me kapacitete më të mëdha ndodh që t'i humbin këto grante, të cilat duhet të shkojnë dhe të jenë të prekshme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Edhe sot ftoj deputetët që ta miratojnë këtë pjesë të marrëveshjes!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Time Kadriaj.

**TIME KADRIAJ:** Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës është prononcuar edhe më herët dhe po prononcohem prapë se do t'i përkrahim të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe në këtë rast do të përkrahim edhe këtë Projektligj, duke ditur rëndësinë e këtyre marrëveshjeve, duke ditur rëndësinë e këtyre projektligjeve, në të cilët përfitojmë buxhet për kategori të ndryshme dhe që janë të mirë të Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës, andaj edhe njëherë po e përsëris ne do ta përkrahim dhe do ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Atëherë, nuk ka deputetët të tjerë të paraqitur për fjalë. Gjithashtu edhe nga Qeveria.

Sqarim. Ta bëj një sqarim procedural. D.m.th. sipas nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila përcakton se Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshje ndërkombëtare që i bie duhet të jenë 80 vota për, pra për ratifikimin e kësaj marrëveshje.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë.

Të nderuar deputetë,  
Fillimisht duhet të miratohet amendamenti i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL para se të ketë votim të tërësishëm.

Ju lus që me ngritje dore të deklarojeni për amendamentin nr. 1 të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë konstatoj se me 84 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet amendamenti i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Tani votojmë projektligjin në tërësi me amendamentin e miratuar.

Të nderuar deputetë, lus që me ngritje dore të deklarojeni për Projektligjin nr. 08/L-054 për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Në ndërkohë dy deputetë i janë bashkëngjitur votimit.

Konstatoj se me 86 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Kuvendi miratoi Ligjin nr. 08/L-054 për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2017 - pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

**\* Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare**

Ftoj z. Abelard Tahiri që t'i paraqesë propozimet.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit kryesuese!

U propozoj deputetëve që t'i miratojnë me votë këto ndryshime që do t'i propozojë tani. Pra, në Komisionin për Siguri, unë deputeti Abelard Tahiri kam qenë anëtar deri tani. Propozoj që të zëvendësohem me deputetin Hisen Berisha.

Ndërsa në Komisionin për Shëndetësi, ish-deputeti i Partisë Demokratike, Uran Ismaili, të zëvendësohet me deputeten Floretë Zejnullahu.

E fundit, në Komisionin për Ekonomi, propozoj që ish-deputeti Uran Ismaili të zëvendësohet me mua, pra deputetin Abelard Tahiri. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, lus që me ngritje dore të deklaroheni për këto propozime të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatoj se me 78 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët miratuan propozimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për zëvendësimet e anëtarëve në komisionin parlamentar ashtu siç u paraqit nga shefi i Grupit Parlamentar.

Të nderuar deputetë, me kërkesën e z. Armend Mehaj, ministër i Mbrojtjes, do ta zhvendosim këtë pikë për më vonë, për shkak se është duke u kthyer nga një udhëtim zyrtar dhe do të na bashkëngjitet pak më vonë.

Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës:

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe Kuvendi i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj ministren e Ministrisë së Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: E nderuar nënkryetare e Kuvendit, faleminderit për fjalën!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Paraqes para jush Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile. Duke marrë parasysh faktin se Republika e Kosovës nuk është pjesë e Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private si dhe anëtar e konventave të kësaj organizate apo konventave të tjera që rregullojnë këtë aspekt të drejtësisë, si dhe duke marrë parasysh se Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror për ndihëm juridike ndërkombëtare në çështje civile dhe meqenëse Republika e Kosovës nuk ka një bazë të unifikuar ligjore në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje civil, Ministria e Drejtësisë dhe sistemi i drejtësisë janë përballur me probleme dhe vështirësi për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore adekuate në këtë drejtim. Ndër kërkesat e bëra kryesisht nga gjyqësori është procedimi sa më shpejt që është e mundur dhe miratimi i ligjit, gjegjësisht Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile, i cili konsiderohet që do të rregullojë këtë fushë në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të lartë si dhe në mënyrë që të lehtësohet ekzekutimi i kërkesave të parashtruara nga organet gjyqësore të huaja te organet gjyqësore në Republikën e Kosovës, por edhe anasjelltas.

Përveç plotësimit të zbrazëtirave të kornizës ligjore ekzistuese për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështje civile, Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile do të plotësojë në masë të madhe mungesën e anëtarësisë së Republikës së Kosovës në Konferencën e Hagës dhe në konventat e saj. Po ashtu pasqyron saktë praktikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje civile dhe unifikon procedurat me Bashkimin Evropian. Gjithashtu lehtëson punën e përditshme të Ministrisë së Drejtësisë si organi qendror në zbatimin e kërkesave të ndryshme të gjykatave në çështjet civile, por po ashtu lehtëson edhe punën e përditshme të institucioneve të drejtësisë në ekzekutimin e këtyre kërkesave që vijnë nga gjykata e huaja, por edhe anasjelltas në këtë drejtim, duke e marrë parasysh apo duke e marrë në konsideratë qëllimin e ofrimit dhe realizimit më efikas të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, konsideroj që është momenti i duhur që ta miratojmë një ligj të tillë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, zonja Haxhiu! Tani, ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotëri Adnan Rrustemi, për arsyetimin e raportit të komisionit.

**ADNAN RRUSTEMI:** Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisionin për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 01. 10. 2021, e shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile, dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

#### Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye ia rekomandojmë seancës shqyrtimin dhe miratimin në pajtim me rregulloret e Rregullores së Kuvendit. Ju faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me deklaratimet e grupeve parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje e ka fjalën Alban Hyseni.

**ALBAN HYSENI:** Faleminderit, kryesuese!  
Pasi që Kosova nuk është pjesë e... A po dëgjojmë pak?!

**KRYESUESJA:** Të nderuar deputetë, ju lutem qetësi që t'i dëgjojmë kolegët tanë!

**ALBAN HYSENI:** Faleminderit!

Pasi që Kosova nuk është pjesë e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe anëtare e konventave të tjera të kësaj organizate apo edhe të konventave të tjera që e rregullojnë këtë aspekt dhe nuk ka një bazë të unifikuar ligjore në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, Ministria e Drejtësisë dhe gjyqësori janë përballur me shumë vështirësi.

Miratimi i shpejtë i këtij projektligji është edhe kërkesë e gjyqësorit, me qëllim të rregullimit të duhur të kësaj fushe dhe lehtësimi i ekzekutimi të kërkesave të parashtruara nga organet gjyqësore të huaja te organet gjyqësore të Republikës së Kosovës dhe anasjelltas.

Përveç plotësimit të zbrazëtirave të Kornizës ligjore ekzistuese për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështjet civile, ky projektligj do të lehtësojë mungesën e anëtarësisë së Kosovës në Konferencën e Hagës dhe konventat e saj.

Projektligji e lehtëson punën e Ministrisë së Drejtësisë si organi qendror në zbatimin e kërkesave të ndryshme të gjykatave në çështjet civile, por edhe puna e gjyqësorit në ekzekutimin e kërkesave që vijnë nga gjykatat e huaja dhe anasjelltas, si dhe qytetarëve që kanë vështirësi në këto procedura.

Si grup parlamentar, ne e përkrahim këtë projektligj dhe i ftojmë të gjitha grupet parlamentare që të përkrahin projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hyseni! Nga Partia Demokratike e Kosovës e ka fjalën zonja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Edhe Partia Demokratike e Kosovës, në mbledhjen e komisionit e ka miratuar, në fakt, e kemi përkrahur Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështje civile.

Dua të them që në fillim që për herë të parë kjo fushë rregullohet, natyrisht nëpërmjet ligjit, sepse deri më tani është rregulluar nëpërmjet fushave të tjera, akteve nënligjore.

Ky projektligj në fakt, përcakton kompetencat, rendin dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile dhe ato komerciale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve të huaja.

Synon që të lehtësojë bashkëpunimin, në mungesë të një marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe ose në kushte të reciprocitetit apo në vullnet të mirë, në rastet kur kjo nuk rregullohet me marrëveshje dypalëshe ose me atë shumëpalëshe.

Dua të them që në fillim që ky koncept...Kanë qenë në fakt, dy koncept-dokumente të cilat janë bërë vite me parë nga Partia Demokratike e Kosovës; koncept-dokumenti për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështje civile dhe koncept-dokumenti juridik ndërkombëtar për çështje penale, dhe na vjen shumë mirë që iniciativat e mira janë përkrahur dhe po zbatohen.

Në fakt, sot kemi edhe në seancë, nga ministrja të njëjtin projektligj, i cili natyrisht që ka qenë hendek, e thashë edhe më herët, për institucionet tona, për shkak se nuk e kemi pasur deri më tani.

Sidoqoftë, si Parti Demokratike e Kosovës, ndonëse e kemi miratuar në lexim të parë, ne i kemi edhe disa çështje për të cilat do të kemi amendamente, si grup i Partisë Demokratike të Kosovës, sidomos për çështjen e ekspertizave të mirë-rregulluara.

Natyrisht, besoj që edhe zonja ministre do të flasë sot se si do të jetë e rregulluar çështja e ekspertizave në projektligjin në fjalë. Po ashtu, zonja ministre, duhet të qartësohet më mirë edhe roli i Ministrisë së Drejtësisë në këtë rendin e bashkëpunimit. Cili do të jetë roli i ministrisë suaj në këtë bashkëpunim.

Dhe, natyrisht, vërejtjet tona ne do t'i japim edhe gjatë fazës së amendamentimit të projektligjit, por po e them që është një iniciativë e mirë që duhet të përkrahet dhe Partia Demokratike e Kosovës do ta japë votën e saj.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e ka fjalën zoti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesuese!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile, dhe në parim ne i japim mbështetje dhe do të provojmë që eventualisht rekomandimet tona të cilat i kemi, t'i trajtojmë gjatë dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zoti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryesuese!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështetë në parim shqyrtimin e parë të Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështjet civile.

Për ne, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile paraqet një temë tepër me rëndësi edhe për çështjet e jurisprudencës kosovare, sidomos në kohën kur Republika e Kosovës ka filluar përafrimin edhe në aderimin në institucionet dhe mekanizmat e ndryshëm të Bashkimit Evropian, siç është rasti i marrëdhënies së Stabilizimi-Asociimit, dhe në veçanti çështjet që ndërlidhen me rolin e shtetit tonë në tema ndërkombëtare që paraprakisht nuk janë rregulluar me ligj të veçantë, por kanë qenë të rregulluara me koncept-dokumente dhe me rregullativa të cilat kanë shprehur një hendek serioz në raport me këtë temë.

Si grup parlamentar e mbështesim, ndërsa në trajtimin dhe leximin e dytë, i kemi disa çështje që ndërlidhen edhe me rolin e Qeverisë edhe me rolin e Ministrisë së Drejtësisë, edhe me rolin e aktorëve të tjerë joqeveritare, në këtë temë, në mënyrë që ky ligj të fuqizohet dhe si të tillë ne e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Tahiri! Nga Grupi Multietnik, fjalën e ka zoti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, nënkryetare! Projektligjet apo ligjet të cilat do të trajtojnë temat tona shtetërore dhe që rregullojnë këto tema shtetërore jashtë vendit, natyrisht që ne si grup parlamentar do t'i mbështesim.

Edhe në këtë projektligj, ne në parim e japim pëlqimin dhe do të kontribuojmë me propozimet tona si grup, në komisione. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Kervan! Atëherë, nuk kemi deputetë të paraqitur për fjalë. Ministrja Haxhiu e ka fjalën.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare Bogujevci!

Falënderoj anëtarët e komisionit apo deputetët e Kuvendit të Republikës të të gjitha grupeve parlamentare për mbështetjen e këtij projektligji, që konsideroj që është shumë i nevojshëm.

Unë në fjalën time hyrëse njoftove për rëndësinë e tij, megjithatë, më lejoni që të bëj një vërejtje për deputeten Blerta Deliu-Kodra, për faktin se tha që të dyja koncept-dokumentet janë përgatitur nga Partia Demokratike e Kosovës.

Unë nuk e di a i keni sjellë prej partisë e keni çuar në ministri apo qysh është puna, sepse nëse i ka bërë Qeveria, atëherë në rregull. Mirëpo, nuk mundemi as unë as ti të themi se i ka bërë Vetëvendosja koncept-dokumentet ose i ka bërë Partia Demokratike e Kosovës.

Prandaj, është mirë të vlerësohet roli që ka pasur Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, që zoti Tahiri si ish-ministër i Drejtësisë, e di jashtëzakonisht mirë se çfarë roli ka, çfarë profesionalizmi ka në atë departament, dhe kontributin më së shumti e ka dhënë...Partia-shtet! Dhe, kontributin më të madh e ka dhënë Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale dhe Civile, po ashtu edhe sistemi i drejtësisë, rrjedhimisht gjyqësori.

Më lejoni t'ju njoftoj që jemi në përpjekje me Ministrinë e Punëve të Jashtme që t'i ndërmarrim veprimet për anëtarësimin e Kosovës në Konferencën e Hagës. Do të jetë sfidë, por natyrisht që do të bëjmë punë të madhe në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministrja Haxhiu! Zonja Deliu e keni fjalën për replikë.

BLERTA DELIU-KODRA: Atëherë, zonja ministre faleminderit për sqarimin! Sidoqoftë, unë besoj që ju jeni mjaftueshëm e informuar që unë e kisha fjalën për kohën sa Partia Demokratike e Kosovës ka udhëhequr me Ministrinë e Drejtësisë.

Ju e dini që departamentet të tilla, natyrisht që në të kaluarën janë udhëhequr nga persona të cilët kanë qenë politikë, dhe mua më vjen mirë që ky departament po kryen, në fakt, ministria...Dhe, mua më vjen mirë që ky departament...

Zonja ministre, ministria është udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës dhe e kisha fjalën që gjatë kohës sa ne kemi qenë në Qeveri.

Prandaj, mua më vjen mirë që departamenti po vazhdon të jetë efikas, po e kryen punën me shumë përkushtim dhe natyrisht ne jemi në përkrahje të këtyre iniciativave. E kisha fjalën për kohën sa ne kemi qenë në Qeveri.



KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, do të procedojmë me votim, kështu që ju kisha lutur që të gjithë ju që jeni prapa, të ktheheni në sallë.

Të nderuar deputetë,

Të pranishëm janë 77 deputetë. Atëherë, lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Projektligjin nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë,

Në ndërkohë janë bashkëngjitur edhe deputetë të tjerë, kështu që në votim kanë marrë pjesë 80 deputetë. Konstatoj me 80 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-020 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

*(Drejtimin e mbledhjes plenare e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)*

KRYETARI: Mirë! Vazhdojmë me pikën e gjashtë të kësaj seance:

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Administratën Publike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar atë për miratim.

Me këtë rast, e ftoj deputetin Fridon Lala që në cilësinë e propozuesit, ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

FRIDON LALA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Deputetët e legjislaturave të kaluara e dinë që plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare, me qëllim të njohjes së 24 qershorit si Dita e Egjiptianëve, po vjen në Kuvend tashmë për të disatën herë.

Njohja e Ditës Memoriale të komunitetit egjiptian është e drejtë themelore kushtetuese, ashtu siç njihen edhe ditët memorialë të të gjitha grupeve tjera etnike në Kosovë.

Komuniteti egjiptian vazhdon të ngelet i vetmi grup etnik të cilit i mohohet kjo e drejtë. Fatkeqësisht, ndër vite ky projektligj nuk ka arritur të kalojë dhe ta gjejë përkrahjen e duhur. Njëra nga këto arsye ka qenë edhe mungesa e përkrahjes nga 2/3 të deputetëve të komuniteteve joshumicë.

Andaj, pasi një pjesë e madhe e këtyre deputetëve sot mungon në sallë, propozoj që kjo pikë të shtyhet për njërën nga seancat e radhës.

KRYETARI: Tash, ftojme deputeten Doarsa Kica-Xhelili që ta arsyetojë raportin e komisionit. Mirë. Kjo nuk kalon pa 2/3 e pakicave. Sa deputetë i kemi në sallë, ju lutem, fillimisht!

Dëgjoni! Marrëveshja fillestare ishte që shteret debati. Të shteret debati e pastaj... Zoti Lala, a ka mundësi vetëm të...

Ndërmjet asaj se a ta vazhdojmë e ta shterim debatin dhe a të kalojmë në mocionin procedural, po më duket më mirë që të kalojmë drejtpërdrejt në mocionin procedural. Kështu që, përgatitu për votim ju lutem!

Deputetë të nderuar,

Zini vendet tuaja, po kalojmë në votim. E votojmë mocionin procedural të cilin e shtroi deputeti Lala, për ta shtyrë këtë pikë. Zini vendet tuaja. 72 deputetë, faktikisht, 67 tash më thotë Administrata, që i kemi të pranishëm.

Përgatituni për votim, e hedhim në votim mocionin procedural të deputetit Lala, për shtyrje të kësaj pike.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatoj që me 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi mori vendim që ta miratojë mocionin procedural për shtyrjen e pikës 6 që është, Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale**

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Me këtë rast, e ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Albulena Haxhiu që ta paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj.

**MINISTRA ALBULENA HAXHIU:** I nderuar kryetar i Kuvendit, faleminderit për fjalën!

Më lejoni t'ju njoftoj se nëpërmjet plotësim-ndryshimit Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale, është synuar që të adresohen problemet e mangësitë që janë shfaqur përgjatë zbatimit të ligjit që është në fuqi aktualisht.

Është evidentuar se bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale në tri format e tij kryesore që janë: ekstradimi, pastaj transferimi i personave të dënuar dhe ndihma juridike e ndërsjellë, është vështirësuar në masë të madhe nga dispozitat që shkaktojnë ngarkesa të panevojshme dhe dispozita jo të plotë apo jo të qarta.

Për shembull, deri tani nuk kemi pasur bazë ligjore lidhur me rastet kur nëse ekstradimi nga Kosova për në shtetin tjetër është realizuar dhe shteti kërkues, ku personi i kërkuar është ekstraduar, kërkon që për shkak të një veprë penale shtesë, pëlqimin për ndjekjen penale ose për ekzekutimin e një dënimi ose të ndonjë sanksioni tjetër. Pra, kjo nuk është e adresuar dhe me këtë adresohet, me këtë projektligj adresohet edhe kjo.

Po ashtu, te ri-ekstradimi në një shtet të tretë, ka munguar baza ligjore dhe me këtë plotësim-ndryshim është krijuar baza ligjore. Ri-ekstradimi nënkupton që, nëse ne ekstradojmë një person, ta zëmë, në Gjermani, kjo e fundit nuk mund ta ekstradojë në një vend tjetër pa lejen tonë. Dhe, nëse na ka kërkuar leje në të kaluarën, ne nuk kemi pasur bazë ligjore që t'ia lejojmë një gjë të tillë, ndërsa tani me këtë projektligj edhe kjo adresohet.

Në ligjin aktual parashihet që ndaj vendimit të ministrit të iniciohet konflikt administrativ, dhe sipas rekomandimeve të ekspertëve vendorë, gjyqtarë dhe prokurorë, por edhe ndërkombëtarë, po ashtu, nga niveli akademik, gjegjësisht profesorë, ka ardhur në përfundim që kjo të largohet ngase i ka tejzgatur ekstradimet në Kosovë, gjegjësisht, nga Kosova jashtë Kosovës, dhe me largimin e kësaj, do të kemi ekstradime shumë më të shpejta.

Më lejoni t'ju njoftoj që për këtë çështje kemi pasur debat edhe në Komisionin për Legjislacion, gjegjësisht, në kuptim e asaj që ka pasur dilema pse është larguar ankesa ndaj vendimit të ministrit për ekstradim.

Unë e përmenda në fjalën time që personat që kanë marrë pjesë në grupe punuese na kanë sugjeruar që ta heqim këtë, duke u bazuar edhe në praktikat tjera. Unë personalisht kam pasur dilema në raport me këtë, gjegjësisht, me pamundësimin e të drejtës për ankesë.

Megjithatë, duke e pasur parasysh që kanë ardhur, si të them, mendime apo opinione nga ekspertët, e kam pranuar një gjë të tillë. Por, inkurajoj edhe Komisionin për Legjislacion, deputetët e Kuvendit që ta trajtojnë edhe njëherë në komision, për të vendosur bashkërisht se si ta adresojmë.

Më tutje, transferimi i personave të dënuar nga Kosova për në shtetet prej nga vijnë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit, me ligjin aktual, fillon me kërkesë të personit, i cili jepet në Shërbimin Korrektues, derisa te shtetet tjera jepet para organit gjyqësor, ngase është më i besueshëm dhe personi njoftohet për pasojat ligjore që mund t'i ketë nëse transferohet dhe përpilohet një procesverbal.

Andaj, me këtë projektligj, do të shkohet pranë organit kompetent gjyqësor dhe jo pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ligji aktual e përcakton që kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe pas konfirmimit të lejueshmërisë së saj, dërgohet për ekzekutim në prokuroritë themelore, ndërsa me ndryshimin e ligjit parashihet, në prokurorinë kompetente, pasi që kemi raste të krimit të organizuar, ku kompetente është Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është realizimi i objektivave për të përmirësuar qasje në drejtësi, fuqizimin e sundimit të ligjit, zbatimin më të lehtë dhe efikas të ligjit ndërkombëtar dhe atij të brendshëm në fushën penale, lehtësim të procedurave të ekstradimeve, për të pasur ekstradime, siç thashë, më të shpejta në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe avancimin e legjislacionin në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale, në pajtim me legjislacionin e BE-së, Këshillit të Evropës dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Krejt në fund, më lejoni t'ju njoftoj që edhe Projektligji paraparak që mori mbështetjen nga Kuvendi i Kosovës, po ashtu edhe ky, janë obligime shtetërore si pjesë e procesit të integritimit evropian, ndaj edhe zbatim i tyre, kërkohet që të jetë në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që kemi si dikaster qeveritar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! E ftojme kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputetin Adnan Rrustemi që ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

**ADNAN RRUSTEMI:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 1.10.2021, e shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

#### Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji numër 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye i rekomandojmë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash radha e grupeve parlamentare. Prej Lëvizjes Vetëvendosje e paska kërkuar fjalën deputeti Alban Hyseni, me kartelën e Luan Aliut.

**ALBAN HYSENI:** Njëri nga mekanizmat për luftimin e kriminalitetit në nivel edhe ndërkombëtar, mes vendeve, është edhe bashkëpunimi juridik penal në fushën ndërkombëtare.

Kjo çështje është lehtësuar edhe më tepër përmes këtij projektligji që bën plotësim-ndryshimin e Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale. Ndërsa çështjet që janë adresuar më konkretisht, e që janë evidentuar si problematike përmes ligjit aktual, kanë të bëjnë kryesisht me tri çështje kryesore: është ekstradimi, transferi i personave të dënuar dhe ndihma juridike e ndërsjellët.

Kjo u theksua edhe nga ministrja, andaj në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje deklarojmë që do të mbështesim këtë projektligj dhe u bëjmë thirrje të gjitha grupeve parlamentare për të përkrahur plotësim-ndryshimin. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash nga PDK-ja, fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sa i përket Shqyrtimi të parë të Projektligjit numër 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale, ne si anëtarë të

komisionit kemi dhënë qëndrimin tonë edhe në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, ku kemi dhënë realisht mbështetjen.

Sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale, këtu përfshihet ekstradimi, transferimi i personave të dënuar dhe ndihma juridike e ndërsjellët, do të thotë.

Me këtë projektligj përcaktohen procedurat e ekstradimit, përmirësohet ajo pjesa që u tha edhe nga ministrja, ku përcaktohet që kundër një vendimi të ministres, në këtë rast ministrit përkatës të Drejtësisë, për ekstradim, nuk ka të drejtë të iniciohet konflikt administrativ, duhet thënë se nuk ka të drejtë të kemi ankesë tek ekstradimi i thjeshtësuar, largohet kushti që të merret aprovimi i shtetit kërkues, rregullohet procedura e zgjerimit të ekstradimit që kishte qenë një çështje e patrajtuar.

Vlen të theksohet që Republika e Kosovës sa i përket bashkëpunimit në çështje penale ndërkombëtare është për t'u vlerësuar, është vlerësuar edhe nga aktorët ndërkombëtarë. Këto ndryshime që bëhen në ligjin përkatës me plotësim-ndryshim e bëjnë një harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Unë mendoj që duhet të përkrahet. Si Parti Demokratike do ta japim kontributin tonë mes dy leximeve dhe, në të njëjtën kohë, do të kërkojmë edhe në komision që t'i ftojme edhe aktorët e tjerë në këtë fushë, që të na ndihmojnë që të jetë sa më i thjeshtë, t'ua lehtësojë punën në këtë rast prokurorëve, sepse ka të bëjë në këtë fushë.

Unë s'po i përmend, ministre, cila qeveri e ka bërë, po pasi po do të bësh debat gjithëherë, edhe ky ligj ka qenë baza në kohën e ministrit të PDK-së, po jo të Abeldarit, po të Hajredin Kuçit. Faleminderit! Ju ftoj për ta përkrahur, respekt!

**KRYETARI:** Faleminderit për kujtesën shumë të fuqishme institucionale. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Driton Selmanaj.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Duhet të them që në parim ne i japim mbështetje ose përkrahje kësaj nisme legjislative, megjithatë ne duhet të shohim që gjatë procesit të draftimit, nga leximi i parë në leximin e dytë do t'i kemi në kujdes disa çështje.

E para, që është më kryesorja, është çështja e të drejtës së ankesës së palëve ndaj vendimit të ministrit për ekstradim. Po mendoj që kjo prek edhe Konventat Kombëtare për të Drejtat e

Njeriut, si të tillë ne duhet të kemi shumë kujdes, sepse e kaluara ka treguar që përkundër që kemi pasur edhe marrëveshje ndërkombëtare, edhe bilaterale, me shtetin, Kosova jo rrallë herë nuk ka respektuar ato. Madje, madje kemi përvoja tejet të këqija në rastin e ekstradimit të shtetasve turq.

Prandaj, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në këtë proces. Unë jam i bindur që nga leximi i parë në leximin e dytë do të arrijmë që vërtet t'i marrim shembuj më të mirë që mohimi i drejtës së ankesës të hiqet nga ky ligj dhe t'u lihet e drejta palëve që të kundërshtojnë mendimin administrativ, të them, pjesës politike.

Në parim, pra japim mbështetje dhe kontributin tonë do ta japim në procedurat parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i grupit, Besnik Tahiri, e ka fjalën.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë pjesë edhe në debat në Komisionin për Legjislacion rreth plotësim-ndryshimit të Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

U tha edhe më herët, dhe mendoj që ia vlen të përmendet që ky është një ligj shumë i rëndësishëm i cili rregullon procedurat e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në këto çështje, pra në çështje penale mes Kosovës dhe vendeve të tjera.

Në këtë aspekt shumë prej këtyre çështjeve janë rregulluar edhe në mënyrë bilaterale, një çështje që ne duhet ta trajtojmë në lexim të dytë lidhet po ashtu në marrëdhëniet ku kemi mungesë të marrëveshjeve ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe shtetit të huaj, pra në këtë temë, në nenin 3, kjo rregullohet mbi bazën e reciprocitetit, mendoj që kjo duhet të jetë, mirëpo si temë kemi hasur në disa probleme në të kaluarën.

Në leximin e dytë si grup parlamentar do të adresojmë një çështje që e ngrit edhe ministrja, mirëpo edhe deputeti Selmanaj, ajo lidhet drejtpërdrejt me të drejtën e ankesës. Shikoni në këtë çështje duhet trajtuar a dëgjuar ekspertët, mirëpo njëkohësisht të trajtojmë edhe kontekstin e Kosovës.

Pse po e ngre këtë çështje? Ministri, apo ministrja në këtë rast e Drejtësisë, është i emëruar politik, sot është, nesër me një vendim nuk është, andaj, kjo çështja e ankesës do të duhej të trajtohet me seriozitet shumë të madh në leximin e dytë dhe ministrja duhet të na i sjellë pozicionet e ekspertëve. Kur flasim për ekspertë, a jemi duke folur për ekspertë vendorë, a jem

duke folur për ekspertizë ndërkombëtare, a jemi duke folur për ndonjë lobim të një instituti apo “tink think”, që ankesa të mos ndodhë.

Pra, nuk duhet që ekspertiza, në thonjëza, po them, ekspertiza çfarëdo që është ajo, vendore apo ndërkombëtare, mund të jetë edhe e praktikave të mira që ka ndodhur diku, të na detyrojë të marrim një vendim, i cili në kushte normale mund ta kthejë Kosovën mbrapa. Tek e fundit, ministrja, në këtë rast ministrja, mund të jetë edhe ministri, nuk është instancë juridike, nuk është instancë e gjyqësorit që të marrë një vendim për ekstradim dhe pastaj të mos trajtohet e tillë. Unë këtu i kam dilemat e mia dhe mendoj që na nevojiten paraprakisht, ministre, kur të vijë në Komision për Legjislacion ky ligj, paraprakisht të na vijë kjo ekspertizë e shkruar, ta shohim domethënë ekspertiza që të ka ardhur ty si ministre, të na vijë neve paraprakisht dhe aty të mos bëjmë ndonjë gabim që pastaj na detyron këtë ligj ta fusim prapë në një plotësim-ndryshim tjetër. Sot apo nesër mund të jetë një ministër i mirë, mirëpo pasnesër mund të jetë dikush, ku politika mund të shtyjë drejtpërdrejt te një vendim, i cili jodomosdoshmërisht bie në rrafshin e të drejtave të njeriut, në rrafshin e trajtimit të drejtë juridik, e pse jo edhe penal.

Andaj, e shoh si shumë të rëndësishme që paraprakisht të na i sillni gjithë dokumentin, pozicionet, opinionet e ekspertizës, ta shohim kush janë këta ekspertë, çka janë këta ekspertë, ku janë referencat akademike, ku janë referencat e praktikave ndërkombëtare dhe ku janë referencat e procesit të anëtarësimit respektivisht të Agjendës Evropiane për Kosovën në raport me këtë temë. A e pengon rrugëtimin tonë në atë drejtim të forcimit të sundimit të ligjit apo e dobëson. Faleminderit!

**KRYETARI:** Dhe, nga Grupi Parlamentar Multietnik, fjalën e ka Erxhan Galushi.

**ERXHAN GALUSHI:** Faleminderit, kryetar!

Si anëtar i Komisionit për Legjislacion, Grupi Parlamentar Multietnik e mbështet plotësim-ndryshimin e Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për çështje penale. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nuk ka tjerë të paraqitur, ministre, a e dëshironi fjalën? Ministrja Haxhiu e ka fjalën.

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Vetëm për dy çështje që u ngritën nga folësit, gjegjësisht deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit për Legjislacion, që lidhen me të drejtën e ankesës së personit që ekstradohet.

Unë thashë edhe në fjalën time që edhe unë kam pasur dilema për këtë, por duke pasur parasysht opinionet profesionale që na kanë ardhur nga ekspertët dhe po ashtu rekomandimet e zyrës së BE-së, ne e kemi lënë të drejtën e ankesës.



Të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian nuk lejojnë të drejtën e ankesës në vendimin për ekstradim të ministrit, e ka pasur Franca deri vonë, ka pasur diskutime edhe atje për ta hequr, nuk jam shumë e sigurt nëse e kanë hequr apo jo, por që natyrisht, si Ministri e Drejtësisë jemi në dispozicion të plotë që ekspertizën që e kemi pasur në grupet punuese përbrenda Ministrisë së Drejtësisë t'ia ofrojmë edhe Komisionit për Legjislacion, ekspertizën që e kanë bërë ekspertët që i kanë ndihmuar Ministrisë së Drejtësisë për adresimin e këtij projektligji.

Po ashtu, zoti Tahiri e ngriti një çështje që ka të bëjë në rastet kur ne si shtet nuk kemi marrëveshje bashkëpunimi me shtetet e tjera, këtu gjithnjë dhe gjithçka realizohet mbi bazën e reciprocitetit. Pra, në qoftë se shtetet e tjera që s'kemi marrëveshje, na i ekstradojnë personat, atëherë edhe ne ua ekstradojmë.

Deri tani nuk ka pasur, natyrisht përveç Serbisë, dihen botërisht problemet që i kemi me Serbinë, deri tani nuk ka pasur probleme me shtetet e tjera, madje as shtetet e tjera që s'e kanë njohur Republikën e Kosovës, Greqia, Bonja e të tjera. Prandaj marrëdhënie tona do të realizohen apo funksionojnë mbi bazën e parimit të reciprocitetit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Besnik Tahiri e ka kërkuar një replikë lidhur me këtë që e tha ministrja.

**BESNIK TAHIRI:** E kam vetëm një koment të çështja e reciprocitetit.

Sa u përket vendet që janë pjesë e kontinentit të vjetër, pjesë e Bashkimit Evropian apo pjesë të Kontinentit të Evropës, nuk kam dilema që kjo mund të rregullohet, për shkak se kjo mund të ndërmjetësohet. Mirëpo kur po flasim për vende, ku realisht ne kemi marrëdhënie reciproke, kushtimisht me Argjentinën apo Brazilin apo me ndonjë shtet tjetër, ku një qytetar yni mund të jetë, kjo temë mendoj që ne duhet trajtuar në leximin e dytë. Për shkak se këtu ne po biem ndesh.

Ju e dini, një kohë na pati mbetur një qytetar yni në një shtet të Afrikës, më kujtohet në atë kohë, zoti Pacolli pati ndërmjetësuar për t'u tërhequr, pra unë kur po i referohem çështjes së nenit 5, ku rregullohet, ku adresohet procedura e reciprocitetit, respektivisht marrëdhënieve ndërshtetërore, ne duhet trajtuar edhe këtë temë, edhe për mua më e rëndësishmja është puna e drejta e ankesës. Pasi po e plotësojmë, bile të plotësojmë mirë, e patëm edhe Ligjin për festa zyrtare, e thashë edhe në Kryesi, po dal pak prej teme, edhe në Kryesi të Kuvendit, edhe në grup, mos e sillni këtë ligj se s'mund të bëjmë asgjë, për shkak të 2/3, atëherë na u përdor kryesisht për çështje elektorale. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash më lajmëroni, ju lutem, sa deputetë i kemi të pranishëm në sallë. Janë 67 deputetë për momentin të pranishëm. Atëherë ju lus të përgatitemi e të hyjmë në votim.

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni lidhur me Projektligjin numër 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë në Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojmë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

## **10. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit numër 08/L-032 të procedurës penale**

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projekt-kodin në fjalë dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj sërish ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projekt-kod.

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Drafti i Kodit të procedurës penale pa dyshim që është një dokument shumë i rëndësishëm.

Më lejoni t'ju njoftoj që gjatë hartimit të Projekt-kodit të procedurës penale, grupi punues është fokusuar në eliminimin e të gjitha mangësive, zbrazësive dhe vështirësive të evidentuara gjatë zbatimit të Kodit të Procedurës, i cili është në fuqi.

Po ashtu qëllimi i këtij drafti të Kodit është avancimi i drejtësisë penale për të vendosur sundimin e ligjit në vendin tonë.

Siç jeni në dijeni, Kodi i ri Penal ka hyrë në fuqi në vitin 2019 dhe aso kohe kemi pasur jashtëzakonisht shumë kritika, sepse nuk është proceduar kodi i ri paralelisht me Kodin e procedurës penale, duke pasur parasysh që kanë ndërlidhshmëri.

Momentin që kam pranuar detyrën si ministre, siç e kam thënë edhe në seancat e kaluara, jemi fokusuar te projektligjet që i kemi gjetur dhe duke pasur parasysh vërejtjet që kemi pasur në draftin e Kodit të procedurës penale, na ka marrë kohë, gjegjësisht prej momentit kur është

themeluar Qeveria deri tani, derisa i kemi adresuar me anëtarët e grupit punues problemet që kemi hasur në draftin e Kodit të procedurës penale.

Në projekt-kod në këtë draft, përveç amendamenteve të shumta teknike, të cilat pa dyshim që me eliminimin e tyre do të bëhet më e lehtë puna e gjyqtarëve e prokurorëve dhe natyrisht më efektive. Po ashtu janë adresuar edhe çështjet që kanë të bëjnë me gjykimin në mungesë. Mundësia e suspendimit të zyrtarëve publikë në rastin e ngritjes së aktakuzës më përpara ka qenë për të gjitha veprat penale.

Ne kemi konsideruar që duhet të bëhen për disa kapituj të veprave penale. Po ashtu edhe janë përfshirë dispozitat që ndërlidhen me kontrollin ndaj vendimeve të prokurorisë për hedhjen poshtë të kallëzimit penal, përkatësisht mbylljes së hetimeve.

Disa nga ndryshimet që janë më të rëndësishme më substanciale janë gjykimi në mungesë. Është shtuar neni i ri lidhur me gjykimin në mungesë, i cili përcakton se nëse i pandehuri, i cili vullnetarisht dështon të paraqitet në seancë gjyqësore, pasi të jetë i informuar për datën, nuk duhet të lejohet të vonojë procedurën.

Në ato raste kur prokurori nuk mund të gjejë një të pandehur pas përpjekjeve të arsyeshme, gjykimi duhet të jetë në gjendje të mbahet sipas rrethanave të përcaktuara në nenin e propozuar.

Këtu bëhet një dallim ndërmjet gjykimit në mungesë për vepra të tjera, përjashto ato që kanë të bëjnë me krimet e luftës. Për faktin se për rastet e krimeve të luftës domosdoshmërisht kërkohet që i pandehuri të jetë në seancën e parë apo në seancën fillestare. Pra, gjykimi në mungesë për ta vlen sipas rregullimit aktual që është bërë para pak kohësh.

Po ashtu çështja e suspendimit të zyrtarëve apo të personave zyrtarë nga detyra. Suspendimi i zyrtarëve publikë nga detyra ka për qëllim që të parandalojë keqpërdorimin eventual duke ushtruar funksionin dhe njëkohësisht duke u përballur me akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Ne kemi shtuar disa kategori apo disa kapituj, se në cilat raste suspendohet një zyrtar nga detyra dhe konsiderojmë që kjo është në përputhje edhe me obligimin që kemi ndërlidhur me procesin e agjendës evropiane të reformave.

Po ashtu sa i përket afatit të hetimeve, në draftin që kemi pasur në Ministrinë e Drejtësisë ka qenë deri në katër vjet me vendim të gjykatës, ne kemi ulur dy vjet, mirëpo me kërkesë edhe për një vit më tepër, pra jo në katër, po deri në tre vjet.

Për faktin se në qoftë se e lëmë një afat të gjatë të hetimeve, kjo konsiderohet që shkel të drejtat e njeriut, po ashtu edhe vendos prokurorin në njëfarë komoditeti, kur e di që ka disa vjet në dispozicion për ta hetuar një lëndë prej momentit të nxjerrjes së një aktvendimi për fillimin e hetimeve.

Pra, ne kemi ndërlidhur këtë me vepra penale kundër korrupsionit, krimet të organizuar si dhe vepra penale të natyrës komplekse dhe që kanë një numër të madh të të pandehurve dhe dëshmitarëve të përfshirë në procedurë.

Po ashtu rishikimi i vendimeve për hedhje të kallëzimit penal si dhe aktvendimi për pushim të hetimeve.

Përmes rishikimit të vendimeve për hedhje të kallëzimit penal si dhe aktvendimit për pushim të hetimeve eliminohet një e metë që e ka shoqëruar sistemin tonë ndër vite, duke mbyllur raste që në start të procedurës penale dhe duke mos u dhënë mundësia palëve që të rishikojnë atë vendim për mbyllje të hetimeve.

Kjo e metë tashmë me dispozitat e këtij kodi do të eliminohet, do të mundësohet rishikimi i këtyre vendimeve, fillimisht brenda sistemit prokurorial, po në instancë të fundit, duke ofruar mundësinë që përmes mjetit të jashtëzakonshëm palët mund t'i drejtohen edhe Gjykatës Supreme, si instancë e fundit gjyqësore.

Po ashtu ky draft i Kodit të procedurës penale adreson edhe të drejtat e palëve të dëmtuara. Po ashtu ndryshime në kapitullin e masave të fshehta. Janë rishikuar në tërësi kapitujt e dispozitave për masat e fshehta të hetimit, po ashtu edhe kapitulli në lidhje me konfiskimin, pastaj procedurat në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, e të tjera e të tjera.

Në fund fare, duke pasur parasysh rëndësinë që ka drafti i Kodit të procedurës penale, unë i ftoj deputetët e Kuvendit për mbështetje të tij, por pa dyshim jam në dijeni që mund të ketë edhe propozime të tjera në këtë draft të procedurës penale.

I ftoj anëtarët e komisionit dhe deputetët e tjerë të Kuvendit që t'i adresojnë ato. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash, fjalën ia japim kryetarit të Komisionit për Legjislacion, deputetit Adnan Rrustemi.

**ADNAN RRUSTEMI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Projekt-kodin numër 08/L-032 të procedurës penale dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Të miratohet në parim Projekt-kodi numër 08/L-032 i procedurës penale.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, para shqyrtimit të parë të projekt-kodit në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi në parim projekt-kodin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye i rekomandojmë seancës shqyrtimin dhe miratimin në parim, në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash është radha e grupeve parlamentare.  
Prej Lëvizjes Vetëvendosje fjalën e ka Alban Hyseni.

**ALBAN HYSENI:** Faleminderit, kryetar!

Përtej ndryshimeve teknike, siç u theksua deri më tash, projekt-kodi përmban edhe ndryshime përmbajtjesore që praktikisht e lehtësojnë pjesën e zhvillimit të procedurës, ndërsa në anën tjetër, ka edhe ndryshime përbrenda vetes që edhe rregullojnë çështje të caktuara.

U theksua që janë adresuar edhe tema si gjykimi në mungesë për të gjitha vepra penale, jo vetëm për krimet e luftës. Tjetër element me rëndësi është edhe mundësia e suspendimit të zyrtarëve publikë, në rast të ngritjes së aktakuzës për korrupsion, krim të organizuar dhe disa vepra të tjera penale që janë të parapara me Kodin Penal.

Pra, si pjesë përmbajtjesore të tri fushave kryesore: të fushës juridiko-penale, Projekt-kodi Penal tash e lehtëson punën e gjyqtarëve, në të njëjtën kohë edhe përmban ndryshime përmbajtjesore brenda vetes.

Një element tjetër me rëndësi është edhe mundësia e gjykatës që të zgjasë afatin e tij me nga 2 vjet, sa është maksimalisht tani për tani, deri në tre vjet, pra për një vit shtesë për disa vepra penale, siç është korrupsioni, krimi i organizuar dhe vepra të tjera penale që përmbajnë shumë subjekte aktive të përfshira në veprë penale, si dhe numrit të madh të dëshmitarëve dhe palëve të tjera në procedurë.

Të tjera çështje me rëndësi që janë trajtuar është edhe rishikimi i vendimeve për hedhjen e kallëzimit penal, vendimit për pushimin e hetimeve si dhe avancimi i theksuar i të drejtave të palëve të dëmtuara.

Lëvizja Vetëvendosje, si grup parlamentar, e përkrah Projekt-kodin Penal si dhe bëjmë thirrje te grupet e tjera parlamentare që të përkrahin këtë projekt-kod. Faleminderit!

KRYETARI: Nga PDK-ja kryetari i grupit, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Mirë shumë që e ke sjellë këtë dokument tejet të rëndësishëm, Kodin e procedurës penale, dhe më bën përshtypje shumë fakti çka ka ndryshuar te ju, që nuk e miratuat, nuk na votuat në vitin 2019, kur e kemi miratuar në leximin e parë, pikërisht këtë dokument, edhe kur e pashë në tërësi, pra 220 nene të ndryshuara gjatë kohës sa kemi punuar ne në Ministrinë e Drejtësisë, prej 547, realisht e pashë vetëm një ndryshim që e keni bërë ju.

Pra, ndryshimi i vetëm prej këtyre 220 neneve është ndryshimi te zgjatja e afatit të hetimeve. Pra, propozimi ynë ka qenë siç është rregulluar tani me Kod të procedurës penale, dy vjet, plus dy vjet shtesë, ju e keni shkurtuar, e keni bërë nga dy vjet shtesë, siç e kemi pasur ne, e keni lënë në një vit shtesë.

Mendoj që ky është një gabim, sepse edhe në atë kohë si ministër i Drejtësisë kam menduar që edhe dy vjet shtesë janë pak për disa vepra penale, sepse ka vepra penale që besoj që hetimi duhet të vazhdojë deri në 10 vjet, siç është Anglia, ju mund t'i shihni praktikat e tyre, ku ka vepra penale, të cilat hetimet zgjasin deri në 10 vjet, për shkak të ndërlikueshmërisë së tyre, për shkak të shpëlarjes së parasë, për shkak të çështjeve që ndërlidhen qoftë me terrorizëm, qoftë me trafik droge, qoftë me shumë e shumë çështje të tjera. Prandaj, mendoj që çështje tillë e shkurtimit të afatit është e pavend.

Ne do të propozojmë në komision amendament shtesë që kjo të jetë ashtu siç e kemi propozuar. Prapë po them, ne ende s'kemi ndërtuar institucione që tregojnë një efikasitet të lartë në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prandaj, koha mendoj që është tepër e rëndësishme.

Sa i përket çështjes së suspendimit, është e njëjta siç e kemi propozuar ne, bile ju edhe kur e keni marrë mandatin si ministre e Drejtësisë, keni qenë kundër suspendimit të zyrtarëve publikë, nëse ju kujtohet kur e keni prezantuar programin e Qeverisë dhe ne kemi kërkuar që ju ta sillni Projekt-kodin e procedurës penale pikërisht për suspendimin e zyrtarë të lartë publikë nga pozita

që akuzohen për korrupsion ose që hetohen për korrupsion, ju e keni kundërshtuar një gjë të tillë, për shkak të mundësisë të abuzimit.

Pra, çështja e suspendimit nuk ka vlejtur as atëherë, as tani për të gjitha veprat penale, sepse s'ka sens. Pra, kjo duhet të lidhet vetëm me aferat korruptive, krim të organizuar dhe çështje të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Pra, nuk ka kuptim të lidhet me të gjitha veprat penale, se s'e kemi bërë as ne.

Çështje tjetër që besoj që është shumë e rëndësishme, përpos këtyre dyjave që kemi bërë ndryshimin, janë edhe ndryshimet që janë të njëjta, që lidhen me procedurën e konfiskimit. Pra, në Kod të procedurës penale çështjet që ndërlidhen me procedurën e konfiskimit janë jetike, pra të cilat instrumente i përdorin prokurorët dhe gjyqtarët dhe mendoj që keni bërë mirë që i keni lënë të njëjta.

Edhe sa i përket çështjes së gjykimit në mungesë, ju e keni kundërshtuar në atë kohë dhe e keni propozuar vetëm për krime lufte. Ne kemi propozuar që të jetë edhe për vepra të tjera që tani po më vjen mirë që po vjen e njëjta, siç e kemi propozuar.

Prandaj, unë ju përgëzoj për ndryshimin që e keni bërë, sepse ju është dashur të ndryshoni, jo kodi, jo propozimet tona, nuk janë propozime të mia këto që i kam bërë, janë propozime të grupit të ekspertëve që kam krijuar që kanë punuar për dy vjet. Prandaj, kjo punë që është bërë prej profesorëve të Fakultetit Juridik, prej mbështetësve tanë, partnerëve tanë ndërkombëtarë, prej ekspertëve që kanë punuar dy vjet, është një punë shumë e rëndësishme që, në fund të fundit, nuk mund të lidhet me një ministër po me një ministër tjetër, sepse duhet të lidhet me angazhimin tonë në luftë kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit dhe mbështetjen e institucioneve. Po më vjen mirë që ju keni ndryshuar dhe nuk kanë ndryshuar propozimet tona. Prandaj, ne sa u përket çështjeve të zgjatjes së afateve mendoj që do ta adresojmë në komision dhe është e papranueshme që ky afat të zvogëlohet, prapë po them. Pra, shikoni përvojat e vendeve të tjera, kemi vende edhe në kuadër të Bashkimit Evropian, unë e përmenda Anglinë që tashmë është jashtë Bashkimit Evropian, po edhe në kuadër të BE-së, të cilat hetimet i kanë shumë më të gjata, sepse po e përsëris, është e rëndësishme për vepra që janë mjaft të komplikuar që ndërlidhen me shpëlarjen e parasë, me trafikun e drogës e me shumë çështje të tjera.

Prandaj, ne në parim do ta përkrahim, sepse është një dokument në të cilin kemi punuar gjatë në të, kemi pasur një angazhim të madh dhe fatkeqësisht do të duhej në 2019-ën, kur është miratuar në leximin e parë, do të duhej të miratohej që në atë kohë, katër muaj, nëse nuk gaboj, pas miratimit të Kodit Penal, mirëpo për shkak krizave politike të njëpasnjëshme jemi ardhur dy vjet mbrapa, pra sot jemi në tetorin e viti 2021, dy vjet mbrapa fiks kur është miratuar dhe kur është vonuar miratimi i këtij dokumenti tepër të rëndësishëm.

Andaj, faleminderit dhe kërkoj vetëm edhe një shpjegim shtesë prej anës tuaj, pse mendoni që duhet të zvogëlohet çështja e hetimit nga dy vjet, sa ne e kemi propozuar, ju e keni lënë në një vit. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike fjalën deputeti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projekt-kodin e procedurës penale dhe vlerëson kodifikimin e kësaj materie shumë të rëndësishme të drejtësisë penale.

Normalisht që ky është një dokument shumë voluminoz dhe do punë shumë nga leximi i parë në leximin e dytë, sepse po flasim për një materie tejet të rëndësishme.

Por, meqë u veçuan disa nga çështjet, unë po ngre dilemat tona si grup parlamentar lidhur me atë se a duhet të kufizohen veprat penale për suspendimin e zyrtarëve të lartë publikë. Sipas vlerësimit tonë, nuk duhet të kufizohemi, sepse për çdo rast, kur flasim që ka një vepër penale, atëherë një zyrtar publik nuk e di çka kërkon të dalë në punë derisa kjo çështje të mbyllet, sepse po flasim për vepra penale, jo të natyrave të tjera.

Çështja tjetër që ka të bëjë me afatin shtesë të hetimeve. Ne nuk përkrahim idenë që të ketë shumë vjet shtesë të hetimeve dhe aq më shumë kjo na forcon argumentin tonë që nëse eventualisht ne bindemi dhe themi që drejtësia jonë është fragjile dhe jo shumë efikase, atëherë kjo shumë lehtë mund të shfrytëzohet për të shantazhuar njerëz, për të dëmtuar personalitetin e njerëzve, për të thënë që ‘je në hetime’, kështu që mund të zgjatë me vjet të tëra ose si u dha shembulli se mund të jetë edhe një dekadë.

Prandaj, ne do të kemi shumë kujdes në këto tematika, edhe në këtë rast duhet të kemi shumë kujdes për të parë nëse vërtet jemi në respektim të konventave ndërkombëtare, që i bie gjithmonë them në kontekstin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

E di që kemi shumë punë si komision. Ne në parim po e përkrahim, por gjithsesi do të provojmë që për të gjitha çështjet, të cilat u ngritën këtu dhe të cilat do të ngritën në proces, të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka deputetja Doarsa Kica-Xhelili.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Projekt-kodi i procedurës penale ka qenë realisht një domosdoshmëri tjetër e institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Ndërsa unë vlerësoj që janë disa risi të këtij kodi që kanë qenë shumë esenciale.



U cek tashmë çështja e gjykimit në mungesë. Ajo që e kemi parë në praktikë, ka qenë zvarritja e skajshme e rasteve gjyqësore në procedurë penale, për shkak të mungesës së pandehurit, e cila ka rezultuar në drejtësi të vonuar.

Sidomos kjo ndodh shpesh në rastet komplekse kur kemi shumë të pandehur, ku në mos prezencë të secilit nga ata, ka mjaftuar që të shtyhet seanca.

Natyrisht gjykimi në mungesë nuk mund të lejohet pa ndërmarrjen e hapave të tjerë, si preventivë e një arbitrariteti eventual të gjyqtari për mosmbajtje të seancës dhe e vërej që kjo është reflektuar edhe në projekt-kod.

Në anën tjetër, zhvillim tjetër pozitiv është fakti që ky projekt-kod po garanton të drejtën e viktimave të veprës penale në ankesë, atëherë kur prokurori e hedh poshtë kallëzimin penal.

Deri tani viktimat e krimit kanë qenë vazhdimisht nën mëshirën e prokurorit, se a dëshiron ai apo jo t'i fillojë hetimet apo të ngre aktakuzë, që shumë shpesh ka rezultuar me raste ku hetimet janë mbyllur pa asnjë sqarim të vetëm nga Prokuroria. Kjo ka mundësuar mbylljen arbitrare të rasteve pa arsyetim dhe pa asnjë sanksion disiplinor për mungesë të tillë të arsytimit.

Tutje, projekt-kodi po i jep prokurorit autorizime shtesë që ai të lëshojë masa të fshehta pa nevojë të shqyrtimit nga gjykata, që mendoj që do t'u ndihmojë shumë prokurorëve, të cilët shpesh janë ankuar në procedura burokratike që ata është dashur t'i ndërmarrin për t'i përcjellë veprimet hetimore. Në këtë pikë, do të doja të kërkoja vetëm pak vëmendje të shtuar dhe analizë shtesë, ndoshta në ato veprime hetimore që po lihen në diskrecion të Prokurorisë, por të cilat ndoshta janë pak më shumë invazive në privatësi dhe të shqyrtohen ndoshta edhe një herë në qoftë se disa nga to duhet të vazhdojnë të mbesin në kompetencë të gjyqtarit, në përjashtim të disave që janë më pak invazive në privatësi, që natyrshëm vlerësoj që duhet patjetër të lihen në diskrecion të prokurorit.

Sa i përket afatit të zgjatur për ngritje të aktakuzës, vlerësoj që edhe këtu duhet të kemi kujdes të shtuar me propozimet që po i bëjmë edhe sot, sepse në një anë, moszgjatja rrezikon parashkrimin në raste komplekse, por në anën tjetër, te zgjatja kërkon komoditet për Prokurorinë, komoditet që nuk e ka shoqëria jonë për momentin. Ndoshta, një rivlerësim i afatit në bazë të kategorizimit të veprave vlen të shqyrtohet gjatë dy leximeve, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Komisionin për Legjislacion, por assesi nuk jam dakord për një te zgjatje shumë të madhe që po propozohet sot këtu, sepse mendoj që nëse asgjë tjetër, kjo do të shkaktonte pasiguri shumë të madhe juridike për të gjitha viktimat, e të mos flas për të gjitha mundësitë e ndikimit që mund të ndodhin brenda një periudhe të gjatë kohore në vepra komplekse. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, fjalën e ka Besnik Tahiri nga AAK-ja.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet miratimin e këtij kodi, pra Kodit të procedurës penale. Është një kod jashtëzakonisht i rëndësishëm, mendoj që janë disa çështje që duhet thënë për këtë ligj.

E para, puna në këtë ligj është bërë në një kohë të gjatë, ka qenë pjesë e tryezës së Qeverisë Haradinaj, ku ka qenë edhe ministri Tahiri aty, të sundimit të ligjit. Ka qenë një bashkëpunim i ngushtë në mes të faktorit vendor dhe ndërkombëtar. Është një ligj voluminoz, i cili me të vërtetë është i nevojshëm. Ajo që po ashtu duhet të thuhet është se ky ligj është në përputhshmëri të plotë të dy vendimeve, vendimit kornizë të Këshillit për Luftimin e Krimit të organizuar. Pra, ky ligj e ndihmon luftën kundër krimit të organizuar. E dyta është vendimit kornizë të Këshillit për luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit, ksenofobisë, përmes legjislacionit penal dhe është në vijë të plotë me dhjetë direktiva të Parlamentit Evropian.

Pra, ky ligj e formëson, e ndihmon formësimin e bazës juridike të shtetit të Kosovës në raport me luftën kundër krimit të organizuar dhe në raport me hyrjen, kisha thënë, në binar të sundimit të ligjit. Andaj, ne e mbështesim, këtu ka mundësi për debat të madh në këtë temë, e kuptoj edhe nevojën nganjëherë të debatit në këtë temë, mirëpo miratimi i këtij ligji është jetik, kemi humbur shumë kohë dhe miratimi i tij duhet të ndodhë shpejt dhe ardhja në lexim të dytë në Komisionin tonë për Legjislacion duhet të vijë sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Dhe i fundit për diskutim, deputeti i PDK-së, Ardian Kastrati, e ka fjalën.

ARDIAN KASTRATI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Natyrisht që procedimi i këtij drafti për Kodin e procedurës penale është nevojë ekskluzive për mirëfunksionimin e institucionit të drejtësisë në Kosovë dhe për miradministrimin e drejtësisë.

Dhe, për këtë ne pa dyshim do të falënderojmë edhe departamentin, edhe Ministrinë, Ambasadën Amerikane, Zyrën e BE-së edhe shoqërinë civile për kontributin. Por, unë këtu shoh një hendek mes të mundshmes dhe të domosdoshmes. Do të thotë, është e domosdoshme kjo që e citova së pari, por si është e mundur që do të thotë tani, këtij karvani po i prin një strukturë politike, ta zëmë, kur të vijë puna për suspendimin e personit zyrtar që ngrihet aktakuzë, e cila në fakt, strukturë politike nuk i ka votuar të njëjtat propozime që kanë qenë në 2019-ën, sepse këta sikur paskan projektuar që nga ajo kohë e deri sot ka për të pasur një seri të aktakuzave, e madje edhe të dënuar për vepra penale. Duke ia nis nga kryeministri i tyre, nga ministrja e cila paradite në

bankat e gjyqit, pasdite atje, duke ia nis nga disa deputetë këtu që kanë procese, aktakuza të ngritura për korrupsion të madh.

Pra, ju që s'keni sensin dhe sentimentin për drejtësinë, tani më bëni këtu se jeni kredibilë për këto ndryshime, që në fakt, këto janë propozuar shumë moti, në 2019-ën. Pra, ju jo që s'keni këtë sens, por në fakt, e keni kallur këtu krejt me molotovë e me gjithçka, nuk mund të jeni kredibilë për këtë, siç do të thoshte një koleg juaji, që flet shumë bukur latinisht: "O tempora, o mores". o Zot, o Zot. Tash, ta besojë dikush që për shkak të jush bëhet miradministrimi i drejtësisë, është sikurse të besohet që nata është ditë, sikur të besohet që tash s'jemi në Parlament të Kosovës, por në Bundestag, ta zëmë, ose si të besohet që toka s'është e rrumbullakët. Po, unë për vete i besoj të gjitha këto, që toka s'është e rrumbullakët, por nuk e besoj që ju mund të neni liderë në këtë sens, sepse ju keni maja e mashtrimit dhe kulmi i paturpësisë në aspektin, në raport me drejtësinë, sepse e keni rrënuar drejtësinë dhe nuk keni njohur kurrë organet e gjyqit, duke ia nisur prej Kushtetutës e deri këtu poshtë.

Dhe, nëse kjo bëhet në funksion që ju t'i merrni disa vota, ju e keni parë të dielën që elektorati nuk i ha më përrallat 'qengji dhe ujku'. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Disa çështje që u ngritën nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, jo nga soji i këtij deputeti, se me këtë s'ia vlen as të merrem, më fal. Nuk humb kohë të merrem me ty, fatkeqësi si një deputet i tillë i thotë vetit deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem!

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Disa çështje që u ngritën nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës sa i përket çështjes së suspendimit të zyrtarëve dhe e ftoj deputetin Tahiri që të vijë këtu, sepse pikërisht janë çështjet që i adresoi deputeti Tahiri.

Sa i përket çështjes së suspendimit të zyrtarëve kur kanë aktakuza, më lejoni që ta qartësoj edhe një herë. Në draftin paraprak që e kemi gjetur në ministri ka qenë që zyrtarët të suspendohen kur kanë aktakuza për të gjitha veprat penale. Ne e kemi kufizuar këtë dhe e kemi bërë për veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër integritetit seksual, krimin të organizuar, korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, trafikimi me njerëz, shpëlarja e parave, pra këto janë veprat penale, për të cilat kur i ngrihet një zyrtari aktakuza, mund të suspendohet nga gjykata.

Por, po ashtu e ftoj komisionin që kërkesë të tillë e kanë pasur edhe në Komisionin për Legjislacion, kapitullin për veprat penale kundër familjes, ku parashihet edhe dhuna në familje, sepse konsideroj që një person zyrtar, i cili ushtron dhunë në familje, në asnjë mënyrë nuk duhet ta ushtrojë funksionin ku edhe vepron. Prandaj, e lus komisionin, sepse neve si ministri nuk e di si na ka ikur kjo çështje. Në mandatin e parë, kur kam marrë detyrën si ministre, draftin e Kodit të Procedurës e kemi dërguar në Komisionin e Venecias për dy çështje: për gjykimin në mungesë dhe për çështjen e suspendimit të zyrtarëve, sepse ka pasur shumë dilema në qoftë se i njëjti e shkel prezumimin e pafajësisë, e të tjera.

Komisioni i Venecias për të dyja këto na ka dhënë disa sugjerime dhe e rëndësishme është që na ka thënë që as e para, as e dyta nuk shkel të drejtat e njeriut, në qoftë se qartësohen procedurat siç duhet. Te suspendimi i zyrtarëve na ka kërkuar që të paktën kur suspendohet zyrtari, të mos i hiqet pagesa, gjegjësisht paga që e merr, por një përqindje për zyrtarin, i cili suspendohet. Dhe, duke pasur parasysh që shumë prej aktakuzave të Prokurorisë dalin me aktgjykime liruese, fatkeqësisht kjo e cenon sigurinë juridike, ne kemi konsideruar që është shumë e rëndësishme që të mos bëhet për të gjitha veprat penale, por të kufizohet në disa vepra që konsiderohen më të rënda që parashihen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, sa i përket çështjes së zgjatjes së afatit të hetimeve. Ne konsiderojmë që afati i hetimeve prej dy, dhe me kërkesë të gjykata edhe një afat shtesë është i mjaftueshëm. Nuk guxojmë që Prokurorinë ta vendosim në një situatë komoditeti, ku ajo mund ta mbajë në hetime një person për vite të tëra, e pastaj ai edhe nëse i ngrihet aktakuza, të lirohet. Unë konsideroj që kjo i shkel të drejtat e njeriut, prandaj kemi ulur afatin e hetimeve në dy vjet, sa është aktualisht, me kërkesë për gjykatën në një vit shtesë në raste të ndërlikuara.

I nderuar zoti Tahiri, Prokuroria e ka të drejtën që të pezullojë hetimet. Në momentin që Prokuroria i pezullon hetimet, nuk ec afati, prandaj nuk ka nevojë të ngrihet më tepër afati, sepse kjo konsiderohet që i vendos prokurorët në një situatë komode dhe cenon sigurinë juridike. Ky është edhe rekomandim me ekspertët, të cilët edhe kemi punuar në grupin punues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

I falënderoj edhe një herë deputetët për mbështetjen dhe po ashtu, zoti Tahiri, në fund fare, për të gjitha ndryshimet që janë bërë prej momentit që kam pranuar detyrën deri tani mund t'ju dorëzoj ose me shkrim, ose lirisht mund t'ju sjell në Komisionin për Legjislacion, ose mund të vini në Ministri të Drejtësisë që t'i keni ato. Faleminderit!

**KRYETARI:** Replikë, Abelard Tahiri!

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, ministre! Kodin e Procedurës Penale edhe në ëndërr e shoh, se dy vjet jam marrë me të, domethënë ndryshimet e saj, unë po u them edhe deputetëve, pra veç

le t'i marrin dy dokumente, le te shohin atë që është miratuar në 2019-ën në lexim të parë dhe sot çka po miratojmë, edhe e shohin një ndryshim.

Atë që ta thashë më herët, pra thjesht ndryshimin te afati i hetimeve shtesë. Në një vend demokratik, në një vend normal, hetimi ndaj një zyrtari, ndaj një qytetari, nuk duhet të ndikojë në asnjë rrethanë në jetën e tij, në punën e tij. Realisht edhe ky dokumenti që s'je nën hetime është pak i çuditshëm, si e kemi të rregulluar ne, sepse hetimi nuk duhet ditur që po shkon ndaj një zyrtari, sepse kur e di ai, atëherë çfarë kuptimi ka. Hetimet janë të fshehta. Pra, hetimi në asnjë rrethanë nuk duhet penguar punën dhe të vërehet, i kujtdo qoftë ai, qoftë ai kriminel, biznesmen, zyrtar shtetëror, kushdo qoftë. Prandaj, mendoj që këtu duhet qartësim. Hetimi, zgjatja e afatit të hetimeve është shumë e rëndësishme, sidomos te sjellja e dëshmive që, le të themi, një pasuri e caktuar në një vend të tretë nuk është e atij që është në emër të tij, mirëpo i takon një zyrtari, le të themi, të lartë shtetëror.

Prandaj, hetime të tilla lypin kohë dhe nuk mendoj që janë tre vjet të mjaftueshme, dy e kemi tani, plus gjashtë muaj shtesë dhe propozimi juaj që është 2+1, dhe imi që ka qenë 2+2. Unë mendoj që edhe 2+2 ka qenë pak, edhe në atë kohë kam menduar që është pak, sepse për vepra të tilla, ku hetohen vepra penale të shpëlarjes së parasë, konfiskimit të pasurisë, besomëni, shihni vende me institucione të zhvilluara ligjzbatuese dhe i shihni afatin e tyre. Pra, Anglia e ka për disa vepra...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Përfundojeni replikën, zoti Tahiri, urdhëroni edhe disa sekonda.

**ABELARD TAHIRI:** Prandaj, po ju them që çështja e hetimit, edhe një herë, nuk duhet të ndikojë në asnjë rrethanë, as të jetë e ditur për personin që ka hetime.

Pra, kjo nëse arrijmë për ta rregulluar mirë, mendoj kjo kohëzgjatje është e arsyeshme, bile pak e vogël. Faleminderit!

**KRYETARI:** Pse zoti Kastrati e keni kërkuar fjalën? Ministrja as që iu referua fjalës tënde fare. A me dorë, urdhëro, e keni replikën, po s'ka përmendur asgjë.

**ARDIAN KASTRATI:** Në rregull, dëgjomë, ti që je ministre, pate rastin që të dukesh e njerëzishme dhe të kërkosh falje për dhunimin e institucionit që i ke bërë këtu, merri, shihni videoincizimet çfarë u ke bërë këtyre institucioneve me gaz lotsjellës dhe ke pasur rastin të dalësh e njerëzishme këtu sot në këtë foltore, të kërkosh falje kur i ke quajtur "kriminelë" njerëzit në këtë Parlament. I ke shqetësuar familjet e tyre.

Po ti e zgjedhe kishe të dalësh e ditur, e tash sa je e ditur, vendos natyra, jo ti. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka tjerë të paraqitur. A na tregoni, ju lutem, sa deputetë jemi në sallë aktualisht? 64 deputetë jemi për momentin në sallë. Atëherë, po hyjmë në votimin e këtij ligji.

Pra, po ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni lidhur me Projekt-kodin numër 08/L-032 të procedurës penale. Zini vendet, deputet Gola, Batusha, Shkreta!

Kush është për këtë projekt-kod? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projekt-kodin nr. 08/L-032 të procedurës penale. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë këtë projekt-kod dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Seancën e vazhdojmë pas pushimit, në orën 15:00.

\* \* \*

*Vazhdim i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: E marrim edhe një herë numrin e saktë të deputetëve të pranishëm në sallë. Ju lutem, zini vendet tuaja! Ata që janë në bufe, le të kthehen!

62 deputetë i kemi të pranishëm aktualisht, mund të vazhdojmë seancën. Kështu, në pajtim edhe me të gjitha grupet parlamentare, kemi ardhur në përfundimin që një sërë projektligjesh, të cilat priten të shqyrtohen për plotësim-ndryshim, e të cilat do t'i prezantojë zonja Dafina Gexha-Bunjaku, grupet parlamentare kanë dhënë pajtimin e tyre që kjo të ndodhë në pako, meqenëse të gjitha ligjet janë në harmonizim me një ligj të vetëm. Meqenëse është kështu, atëherë po e ftoj zonjën Dafina Gexha-Bunjaku që t'i prezantojë ato të gjitha përnjëherë, e pastaj ne këtu në debatet tona që i kemi, i shqyrtojmë secilin veç e veç, një nga një.

Urdhëroni, zonja Bunjaku!

DAFINA GEXHA-BUNJAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Ministria e Shëndetësisë, bazuar në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2021, ndër të tjera ka paraparë edhe hartimin e 15 projektligjeve për plotësim-ndryshimin e ligjeve në sektorin e shëndetësisë.

Projektligjet e sektorit të shëndetësisë kanë për qëllim harmonizimin e dispozitave ligjore konform nenit 167 të Ligjit Nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me të cilin është përcaktuar që me hyrje në fuqi të Ligjit për kundërvajtje të gjitha institucionet kanë pasur për obligim që brenda afatit prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji në vitin 2017, të harmonizojë ligjet përkatëse.

Prej vitit 2018, Ministria e Shëndetësisë një gjë të tillë nuk e ka realizuar, andaj me qëllim të adresimit të obligimit ligjor është bërë harmonizimi i projektligjeve në fushën e shëndetësisë, i cili do të fuqizojë mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes në shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati Farmaceutik dhe Inspektorati Sanitar, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Miratimi i projektligjeve për plotësim-ndryshimin e ligjeve në sektorin e shëndetësisë do të krijojë një siguri juridike për mbrojtjen e shëndetit, përmes së cilës nga inspektoratet relevante do të ndëshkohet: personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, personi fizik që ushtron biznes individual dhe personi juridik i institucioneve shëndetësore të Republikës së Kosovës.

15 projektligje që do të përmend kanë kaluar të gjitha procedurat ligjore në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe pritet të aprovohen.

Këto janë:

- Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shëndetësi,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për sëmundjet ngjitëse,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shëndetësinë publike,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbimin mjekësor emergjent,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për kontrollin e duhani,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për gjak dhe përbërës të gjakut,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shëndetin riprodhues,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirit,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin shëndetësor,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe,
  - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale.
- Faleminderit!

KRYETARI: Ne do t'i trajtojmë jodomosdoshmërisht ashtu sipas rendit që i lexuat ju, sepse e kemi përgatitur në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit sipas rendit tonë.

Pra, po i trajtojmë, ashtu siç jemi marrë vesh në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

### **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues**

Të nderuar deputetë, Komisioni Funkcional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Pasi që projektligji u prezantua nga ana e Qeverisë, e ftoj tash kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Fatmire Kollçaku, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ashtu siç dëgjuam, të gjitha këto 15 projektligje, në fakt kanë të bëjnë vetëm me harmonizim me Ligjin për kundërvajtje.

Ndoshta edhe në fjalën time hyrëse, unë kisha propozuar, meqenëse edhe si komision ne e kemi shqyrtuar të njëjtën ditë në parim dhe, pasi të miratohen sot, i ftoj deputetët që t'i miratojmë, ne



do ta bëjmë thjesht analizën se a është bërë në përputhje të plotë me Ligjin për kundërvajtje, sepse këto ligje nuk preken asnjëri në substancë, thjesht ka vetëm plotësim-ndryshim dhe harmonizim me Ligjin për kundërvajtje. Unë mund të deklarohej pas secilit ligj veç e veç, apo ndoshta për fillim të deklaroj të gjithat dhe pastaj të shkojmë secilin veç e veç t'i votojmë që të mos deklarohej 15 herë vetëm duke ia ndërruar emrin ligjit.

Pra, unë mund të them se ne në takimin e mbajtur, këtu po i referohem projektligjit për të cilin ju u referuat, për shëndetin riprodhues, mirëpo kjo vlen për të gjitha 15 projektligjet.

Pra, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2021 shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/ L-076 për shëndetin riprodhues dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-076 për shëndetin riprodhues.

Arsyetimin do ta jap unë: në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare shqyrtoi Projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime. Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me neni 54, të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Unë, siç e thashë, mund t'i listoj edhe 14 ligjet e tjera, apo projektligjet në këtë rast, sepse i njëjti arsyetim vlen për të gjitha. Apo, si të pajtoheni ju, ne duhet të deklarojmë edhe të humbim kohë 15 herë t'i përsërisim të njëjtat vetëm me ndërrimin e emrit të ligjit dhe t'i mbetet seancës të deklarohet.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje po ashtu i japim mbështetje edhe Ligjit për shëndetin riprodhues, por edhe 14 projektligjeve të tjera. Sido që të vendosë seanca, na mbetet ose të deklarohej veç e veç, ose vetëm t'i lexoj edhe 14 projektligjet e tjera dhe e njëjta vlen për të gjitha.

**KRYETARI:** Jo, nuk ka nevojë tash t'i lexojmë të gjitha, por mendoj që procedura mund të jetë shumë më e shkurtër nëse dëshironi edhe ju, zonja Kollçaku, vetëm për çdo ligj të thoni që komisioni e ka mbështetur dhe me kaq përfundon.

Domethënë, mund të jemi shumë më ekspeditivë, ma merr mendja. Time Kadriaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Edhe Aleanca, meqenëse kemi të bëjmë vetëm për një harmonizim të ligjeve, në këtë rast për harmonizim të të gjitha këtyre 15 projektligjeve me Ligjin për kundërvajtje, ne pajtohemi të bëhen dhe do t'i votojmë të gjitha këto. Ndoshta ne mund të deklarohe mi tash që pajtohemi ose të deklarohe mi për secilin projektligj veç e veç. Por, pajtohemi, sepse ne si Parlament adresojmë dhe kërkojmë të kemi harmonizim të ligjeve dhe kjo është e domosdoshme që të harmonizohen ligjet, të mos jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Po shpresoj që Ministria e Shëndetësisë ka për të punuar dhe t'i sjellë këto projektligje për miratim në Kuvend, sepse ne kemi shumë mungesa të projektligjeve që duhet plotësuar e ndryshuar, edhe të sillen në Kuvendin e Kosovës dhe jo veç për një harmonizim, sepse deri tash kemi parë që s'na ka ardhur asnjë projektligj.

Ligji i sigurimeve shëndetësore, për shembull, ende s'është, s'po gjen zbatueshmëri dhe ne tash po flasim për Ligjin për sigurime shëndetësore veç për një harmonizim. Po, meqenëse kemi arritur në këtë pikë, ne pajtohemi dhe do t'i votojmë.

KRYETARI: Mirë! Nga Lidhja Demokratike, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E nderuar ministre,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që pak dinamika e fushatës lokale zgjedhore ndoshta e ka mbërthyer edhe në vetvete edhe Kuvendin e Kosovës, por mendoj që duhet t'i kthehemi seriozitetit të punës edhe të shohim në përmbushjen e mandatit tonë ligjor dhe kushtetues që e kemi, sidomos karshi Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sjellja e 15 ligjeve për plotësim-ndryshim në sektorin e shëndetësisë është më shumë improvizim se sa ndryshim përmbajtjesor dhe i cili do të avanconte shërbimet shëndetësore apo edhe ruajtjen e shëndetit publik. Këtë duhet ta themi, nuk po dua sot ta ngarkoj ministren e re, por si pjesë e Kabinetit të Qeverisë, Qeveria duhet t'i kthehet seriozitetit të punës dhe jo improvizimeve, sidomos në fushën e shëndetësisë.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe qytetarët kanë pritur plotësimin përmbajtjesor të ligjit, sidomos ato që janë me rëndësi në sistemin shëndetësor, Ligjit për shëndetësi, sigurimet shëndetësore dhe ligjet e tjera që me të drejtë i përmendi edhe ministrja në ekspozitën e vet. Andaj, 15 ligje të sjella për plotësim-ndryshim e kanë vetëm një objektiv: ajo është harmonizimi me nenin 167 të Ligjit për kundërvajtje që e plotëson pjesën e sanksioneve kundërvajtëse apo gjrobat dhe nuk duhet të theksohet vetëm në aspektin e statistikave, mendoj që kjo Qeveri nuk e ka pasur vëmendjen, ashtu siç e kemi theksuar edhe me programin qeverisës. Sepse, me programin qeverisës, Qeveria e Republikës së Kosovës, kryeministri ka dalë para deputetëve

këtu dhe ka thënë do të kemi rishikim funksional të kornizës ligjore në sektorin e shëndetësisë dhe ky është mashtrim.

Domethënë, me improvizime nuk shkohet tutje. E ftoj Qeverinë e Republikës së Kosovës, Dikasterin e Ministrisë së Shëndetësisë, të kthehet në përmbajtje, e përmbajtja është plotësim-ndryshimi i Ligjit për shëndetësi, Ligjit për sigurime shëndetësore, por edhe ligjet e tjera që u thanë për Inspektoratin Shëndetësor, Inspektoratin Sanitar dhe ligjet e tjera që sot deputetët vetëm kanë iniciativa të ndryshme në kërkesa të qytetarëve në ruajtjen apo më mirë të themi, në ruajtjen dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore, mbi të gjitha të shëndetit publik.

Si grup parlamentar domosdoshmërisht i përkrahim, sepse e ka një objektiv dhe e ka një qëllim që të mos lëmë kolezion mes ligjeve, por Qeveria duhet ta thotë të vërtetën dhe kjo e vërtetë është që 15 projektligje po ndryshohen për vetëm një nen të caktuar, pa pasur impakt në shëndetin publik. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetari i Grupit të PDK-së e ka fjalën, Abelard Tahiri.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah plotësim-ndryshimet e këtyre projektligjeve, pra që të harmonizohen me Ligjin për kundërvajtje, mirëpo ajo çka theksojmë është që mendojmë që ka nevojë për një reformë më të thellë, pikërisht pra në sistemin tonë shëndetësor. Këtu po shohim projektligje tejet të rëndësishme, siç është edhe Projektligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Tashmë jemi duke kaluar në një kohë pandemie, ku besoj që pikërisht ndërhyrjet në këtë ligj janë tejet të nevojshme, në mënyrë që ta bëjnë edhe më të zbatuar këtë ligj dhe ne të jemi më efikas, pra në parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.

Pastaj, kemi edhe projektligje të tjera, siç është edhe Projektligji për sigurime shëndetësore. Mendoj që këtu na duhet një debat më i thellë dhe fillimin e implementimit të këtij projektligji që sigurimet shëndetësore tash e një kohë të gjatë qytetarët e Republikës i presin. Ne kuptojmë që ministrja sapo e ka marrë detyrën, megjithatë ka qenë pjesë e Kabinetit, sepse me sa e di unë, ka qenë zëvendësministre gjatë kësaj periudhe, gjatë këtyre muajve dhe i kërkojmë Qeverisë që të ketë një fokus më të madh në një reformë më të thellë në sistemin tonë shëndetësor dhe në plotësim-ndryshimin e këtyre ligjeve, pra që prekin komplet sistemin tonë shëndetësor në vendin tonë.

Pra, në parim e përkrahim këtë plotësim-ndryshim që lidhet me Ligjin për kundërvajtje. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Tash po besoj që u krijuan edhe kushtet që të hyjmë në votimin e këtij projektligji, ndryshimin dhe plotësimin e projektligjit në fjalë. Pra, do të votojmë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-076 për shëndetin riprodhues. Sa deputetë jemi, të lutem? 64 deputetë jemi të pranishëm.

Kush është për këtë projektligj?  
Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin Nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-076 për shëndetin riprodhues.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

#### **10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Mirëqenie e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Qeverinë e dëgjuam, zonja Kollçaku, a e përkrahni këtë projektligj si komision?

FATMIRE KOLLÇAKU: Në emër të komisionit rekomandoj që të votohet ky projektligj. Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

KRYETARI: Faleminderit! Nëse ky është mendimi i njëjtë, siç e patëm edhe nga grupet parlamentare, atëherë mund të shkojmë në votim. Sa deputetë janë të pranishëm, ju lutem?

65 deputetë i kemi të pranishëm, me sa po e kuptoj. Atëherë, ju lus që me ngritje dore të deklarohe mi për Projektligjin nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatohet që me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

### **11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar që atë ta miratojë në parim.

Qeverinë e dëgjua çfarë tha. Zonja Kollçaku, edhe këtë projektligj ju e përkrahni si komision. Grupet parlamentare janë në rregull, sipas fjalëve që i dëgjua më lartë, kështu që... Mendoj se i kemi mbi 61 deputetë. 66 deputetë janë në sallë. Ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për këtë projektligj. Pra, e kam fjalën për Projektligjin nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj se me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

### **12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe ia ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij në parim.

Komisioni po ashtu, e ka mbështetur ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. Grupet parlamentare e kanë thënë fjalën e tyre, po ashtu që e mbështesin këtë harmonizim të këtij projektligji me projektligjet tjera. Kështu që, ju lus që me ngritje dore të deklaroheni lidhur me Projektligjin nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-156 për kontrollin e duhanit.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime Kuvendit të Kosovës për këtë projektligj.

### **13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri**

Komisioni Funkcional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Komisioni po ashtu, ka dhënë dritën e gjelbër për këtë projektligj. Në sallë i kemi të pranishëm 66 deputetë. Ju lus që me ngritje dore, të nderuar deputetë, të deklaroheni lidhur me Projektligjin nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet se me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë sipas Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin bashkë me rekomandimet.

### **14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor**

Të nderuar deputetë, Komisioni Funkcional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Komisioni po ashtu e ka mbështetur, grupet parlamentare po ashtu. 66 deputetë ndodhemi në sallë. Të nderuar deputetë, po jua kërkoj që me ngritje dore të deklaroheni lidhur me Ligjin 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-349 për sigurimin shëndetësor.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që sipas afatit të paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin bashkë me rekomandimet.

#### **15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-125 për shëndetësi**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar që ta miratojë atë në parim.

Edhe grupet parlamentare, edhe Komisioni FunkSIONAL, e mbështesin, kështu që mund të hyjmë drejtë në proces të votimit. Ju lus që të votojmë për Projektligjin nr. 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-125 për shëndetësinë.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e ka miratuar në parim këtë projektligj, i cili është me numër 08/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-125 për shëndetësinë.

Ngarkojmë në këtë mënyrë Komisionin FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në bazë të afatit të Rregullores së Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin bashkë me rekomandimet.

#### **16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Mirëqenie Social e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Edhe komisioni, edhe grupet parlamentare, e mbështesin këtë harmonizim. Kështu që, të nderuar deputetë, ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për projektligjin me nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

67 deputetë e kanë votuar këtë projektligj, asnjë nuk ka votuar kundër e as nuk ka abstenuar. Kështu që, konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet tjera të përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj sipas Rregullores së Kuvendit dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin bashkë me rekomandimet.

### **17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Këtë ndryshim e përkrah edhe Komisioni FunkSIONAL, e përkrahin edhe grupet parlamentare, kështu që mund të hyjmë drejt e në votim.

Të nderuar deputetë, ju lus që me ngritje dore të përcaktoheni për Projektligjin me nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut. Kuorumin e kemi, ma merr mendja. 68 deputetë në sallë.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatoj që me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi këtë projektligj në parim, që është Projektligji nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjakun dhe përbërësit e gjakut.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet tjera të përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj sipas afateve të Rregullores dhe që Kuvendit t'ia paraqesin raportin bashkë me rekomandimet.

### **18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse**

Komisioni i Shëndetësisë e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe na ka rekomanduar që ta miratojmë në parim. Komisioni tashmë na tregoi që e mbështet këtë projektligj, po ashtu edhe grupet parlamentare. Kështu që, ju lus që me ngritje dore të deklaroheni lidhur me Projektligjin nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?



Konstatohet që me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

E ngarkojmë Komisionin FunkSIONAL dhe komisionet tjera që ta trajtojnë këtë projektligj, siç e përcakton kohën Rregullorja e Kuvendit, dhe t'ia paraqesin po ashtu raportin me rekomandime Kuvendit të Kosovës.

Lus grupet parlamentare që t'i mbajnë deputetët në sallë, sepse numri po bie. Jemi vetëm 63 deputetë tash. Po e trajtojmë pikën tjetër të rendit të ditës, që është:

### **19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-190 për produktet dhe pajisjet medicinale**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe na ka rekomanduar që ta miratojmë. Qeverinë e dëgjuam, komisioni e mbështet, grupet parlamentare po ashtu, kështu që po votojmë për Projektligjin nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-190 për produktet dhe pajisjet medicinale.

Kush është për këtë projektligj, të nderuar deputetë?

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi edhe këtë projektligj, që është Projektligji nr. 08/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-190 për produktet dhe pajisjet medicinale.

E ngarkojmë Komisionin FunkSIONAL, e në këtë mënyrë edhe komisionet e përherëshme që ta trajtojnë këtë projektligj dhe pastaj t'ia paraqesin Kuvendit raportin bashkë me rekomandimet e tyre.

### **20. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-78 për shëndetësinë publike**

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi e ka shqyrtuar këtë projektligj. Qeverinë e dëgjuam, komisionet, po ashtu grupet parlamentare i dëgjuam, e mbështesin këtë projektligj. Kështu që, ne e kemi edhe kuorumin për të votuar. Ju lus, që me ngritje dore të deklaroheni për Projektligjin nr. 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-78 për shëndetësinë publike.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

63 deputetë kanë votuar për këtë projektligj. Asnjë kundër asnjë abstenim, kështu që Kuvendi e ka miratuar faktikisht në parim Projektligjin 08/L-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-78 për shëndetësinë publike.

E ngarkojmë edhe Komisionin Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe të na i sjellin raportin bashkë me rekomandime.

### **21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-049 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor**

Komisioni e mbështet, grupet parlamentare po ashtu. Ju lus që me ngritje dore të përcaktoheni për këtë projektligj.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatojmë se me 64 vota për, sa i ka marrë ky projektligj, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Projektligjin nr. 08/L-049 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për inspektoratin shëndetësor.

Në këtë mënyrë e ngarkojmë Komisionin Funkcional dhe komisionet tjera të përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime bashkë.

### **22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës**

Këtë projektligj e ka shqyrtuar Komisioni për Shëndetësi dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Komisionin dhe grupet parlamentare i dëgjuam më herët, i mbështesin të gjitha këto ndryshime.

Deputetë, ju lutem që të përcaktoheni për këtë projektligj dhe të votojmë!

63 deputetë jemi të pranishëm.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës.

Komisioni Funkcional dhe komisionet tjera të përhershme ta shqyrtojnë këtë projektligj në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe të na i sjellin pastaj raportin me rekomandime në Kuvend.

Është projektligji i fundit pra, nga 15 sa u propozuan nga Qeveria për ndryshim dhe plotësim. E ky është:

### **23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor**

Komisioni Funkcional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe e ka mbështetur atë. Ne e kemi kuorumin e mjaftueshëm për të hyrë në procesin e votimit. Ju lutem, deputetë!

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

63 deputetë kanë votuar për këtë projektligj, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kështu që Kuvendi faktikisht e ka miratuar përmes këtij votimi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor.

E ngarkojmë Komisionin Funkcional dhe komisionet tjera, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia sjellin raportin bashkë me rekomandimet e tij.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se për shkak të kërkesës së Komisionit për Arsim për plotësimin dhe ndryshimin e rendit të ditës dhe në pajtim me kryetarët e grupeve parlamentare, të cilët e kanë dhënë miratimin e tyre, kërkoj që t'ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Arsim, deputetit Ardian Gola, që ta arsyetojë propozimin e tij lidhur me ndryshimin e rendit të ditës, përmes plotësimit me një pikë shtesë.

Urdhëro, zoti Gola, e keni fjalën!

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Çështja ka të bëjë me plotësimin e përbërjes së Këshillit Shtetëror të Cilësisë me anëtarë ndërkombëtarë. Tash e sa kohë ky këshill është jofunksional për sa i përket marrjes së vendimeve për akreditimin e programeve dhe institucioneve të arsimit të lartë. Andaj, pikërisht për faktin se tre anëtarë ndërkombëtarë kanë dhënë dorëheqje për arsye të ditura publike dhe nga Qeveria e kemi propozimin e ri, të cilin ne e kemi kaluar po ashtu në komision në mbledhjen e fundit dhe e kemi propozuar që anëtari i ri të ratifikohet në Kuvend.

Mirëpo, unë tash vonë kam kuptuar që janë edhe disa programe të doktoratës, që është shumë problem të akreditohen dhe të merren studentë, po qe se nuk plotësohet ky këshill shtetëror i cilësisë edhe me anëtarin e ri ndërkombëtar. Prandaj, edhe e kam lënë me një procedurë të rregullt, mirëpo kur mora vesh që mund të penalizohen disa programe dhe disa studentë mund të mbeten pa studime të doktoratës, kërkoj nga deputetët mirëkuptim, që ta fusim në rend dite këtë pikë me ç'rast sot do të mund ta ratifikonim edhe anëtarin e ri për ta plotësuar përbërjen e Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Nëse nuk e fusim në rend dite sot dhe nëse nuk e ratifikojmë sot, atëherë mund të penalizohen shumë studentë potencialë, faktikisht kandidatë për doktoratë dhe programet studimore mund të mos zhvillojnë procedurat e nevojshme për akreditim.

Andaj, kërkojmë që me mirëkuptim nga deputetët e këtij Kuvendi ta futim si pjesë të rendit të ditës edhe këtë çështje, pra plotësimin e rendit të ditës me ratifikimin e anëtarit ndërkombëtar të Këshillit Shtetëror të Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Ju e dini që për t'u miratuar kjo pikë kërkon miratimin, pra mbështetjen nga 2/3-at e të gjithë deputetëve të pranishëm në seancë. Ne duhet ta dimë fillimisht numrin e përgjithshëm të deputetëve. 67 deputetë janë të pranishëm aktualisht, tash 68, 69. Mirë! I kemi 69 deputetë të pranishëm për momentin.

Kush është për këtë propozim, që të plotësohet rendi i ditës?

Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 69 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u plotësua rendi i ditës i kësaj seance plenare. Këtë do ta renditim si pikë e seancës së sotme.

Ministri Mehaj le të presë edhe pak, sepse po hyjmë drejtpërdrejt në shqyrtimin e kësaj pike, pastaj i kthehem pikës së 4-t.

#### **\* Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë**

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Informacion, Kulturë, Rini dhe Sport e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Nuk e kemi askënd nga Qeveria, por mendoj se ka mjaftuar në këtë rast propozimi dhe shpjegimi i kryetarit të Komisionit për Arsim. Zoti Gola, po e marrim fjalën tuaj si të vlefshme edhe në këtë rast, atë që e thatë. Kështu që, fjalën e ka kërkuar edhe deputetja Fjolla Ujkani. Pse?

FJOLLA UJKANI: Për pikën me radhë, që është pika 24.

KRYETARI: Cila ashtu?

FJOLLA UJKANI: Po, e di që është shtyrë, por për atë e kam kërkuar fjalën, sepse ka qenë me radhë, kështu që e kam lënë për të 24-tën. S'paraqet problem, përfundojeni de, është...

KRYETARI: Më fal, mendova që për këtë punën e këtij propozimit. Mirë! Atëherë, le të hyjmë në procesin e votimit për këtë miratimin e... Zonja deputete Eliza Hoxha e ka kërkuar fjalën për këtë pikë.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Të dashur deputetë,

Për mua është brengosëse vetëm mënyra se si vijnë këto çështje të rëndësishme në Kuvend, duke qenë që mbledhja e komisionit është mbajtur më 5 tetor dhe në kategorinë e pikave të rendit të ditës “të ndryshme” është futur kjo pikë me kërkesën e deputetit Fitim Uka. Është miratuar atë ditë, nëse nuk jam gabim, dhe ka pasur kohë të futet në... të silllet dokumentacioni këtu, të sqarohet situata dhe deputetët të jenë të njohur me procesin se si është përcaktuar dhe si ka ardhur ky emër deri tek KSHC-ja, por edhe deri tek komisioni.

Nuk kemi asgjë kundër me idenë që gjithmonë në zgrip vijnë këto për KSHC-në dhe për Agjencinë e Akreditimit këto propozime, por kjo është brengë që besoj se duhet të adresohet, edhe tek kryetari, por edhe tek të gjithë aktorët që janë pjesë e Komisionit për Arsim dhe institucionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Po, faleminderit! Deputetja Vlora Dumoshi e ka fjalën.

VLORA DUMOSHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e përkrahim, por kjo mënyrë e sjelljes vërtet është e pakuptimtë. Ne i rrezikojmë edhe studentët në universitete. Ne do ta përkrahim, por këtë formë më nuk do ta tolerojmë.

KRYETARI: Janë të arsyeshme të gjitha kritikrat sa u përket vonesave, ma merr mendja. Por, ky është një përfaqësues i jashtëm në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Them që ta hedhim në votim.

Atëherë, ju lus të gjithë deputetëve. Fillimisht, ju lutem, sa i kemi të pranishëm në sallë? 65 jemi, po?

Kush është për këtë propozim-vendim?  
Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi e ratifikoi anëtarin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë Kosovare të Akreditimit, zotin Klemen Miklavich, me mandat 5-vjeçar.

Për shkak se s'kemi mundur ta shqyrtojmë pikën e 4-t të rendit të ditës, në mungesë të ministrit Mehaj, i cili u kthye tash, mund të hyjmë në shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit**

Komisioni Funkcional për çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe na ka rekomanduar që ta miratojmë atë në parim. E ftoj në këtë rast ministrin e mbrojtjes, zotin Armend Mehaj, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

ARMEND MEHAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
Të nderuar deputetë,

Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes sot para jush paraqes Projektligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, i cili është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Më lejoni shkurtimisht t'i paraqes arsyet dhe rëndësinë e këtij projektligji...

*(Debat në sallë)*

KRYETARI: Deputetë të nderuar, ministri e ka fjalën. Ju lus që ta dëgjojmë!

ARMEND MEHAJ: Ky ligj ka për qëllim t'i rregullojë e dërgimit dhe tërheqjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Mënyra dhe këto procedura janë në përputhje me misionin aktual të Forcës së Sigurisë së Kosovës që të jetë e gatshme të marrë pjesë në operacione ndërkombëtare.

Siç e dini, FSK-ja mbi bazë ligjore aktuale dhe marrëveshjet bilaterale me vendet partnere, ka marrë pjesë në disa ushtrime të përbashkëta jashtë vendit. Me krenari e them se aktualisht jemi në misionin paqeruajtës krah për krah ushtrisë amerikane në Kuvajt si dhe me plane konkrete për misionet e ardhshme jashtë vendit.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë se rritja e interesit dhe nevoja për zgjerimin e bashkëpunimit me vendet partnere është në progres dhe i nevojshëm dhe avancimi i kuadrove ligjore për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. Andaj, në cilësinë e ministrit të Mbrojtjes kërkoj nga ju shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Kush do ta marrë fjalën nga Komisioni për Siguri, meqenëse Bekë Berishën nuk e paskemi. Urdhëro z. Enver Dugolli.

**ENVER DUGOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL, në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28. 9. 2021, shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Pas shqyrtimit, Komisioni vlerësoi se ky projektligj i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij në parim. Gjatë periudhës në mes dy leximeve do të trajtohen amendamentet eventuale të propozuara.

Prandaj, ftoj deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

**KRYETARI:** Tash është radha e grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike, fjalën e ka deputeti Hisen Berisha.

**HISEN BERISHA:** I nderuar kryetar!

Paraprakisht dua të shpreh mbështetjen time për frymën e ligjit, sepse është shumë i rëndësishëm për të mbështetur Forcën në përmbushjen e misionit, por me theks të veçantë në operacionet ndërkombëtare të paqes në të ardhmen do ta intensifikojë rolin me peshë të Forcën në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

Parimisht, meqenëse gjatë punës si ushtarak kam qenë pjesë e proceseve edhe të rishikimit strategjik dhe të hartimit të politikave për dërgimin e forcave jashtë vendit, nuk ka ndonjë ndryshim të madh në esencë, por kam në parim dy vërejtje ashtu kushtimisht t'i quaj, të cilat ndoshta edhe mund të dorëzohen në mes dy leximeve. Unë po i përmend me radhë.

E para, në nenet 9 dhe 10 përmendet aktivitetet, shpreh aktivitetet të ndryshme ushtarake, e këto aktivitetet të tjera ushtarake përfshijnë, por nuk përkufizohen vetëm në siç e thekson neni 9,

ushtrime, arsimim, edukim, trajnim, stërvitje, gara, parada, aktivitete sportive e të tjera. Mendoj se ky nen bën barazimin e dërgimit në operacione në mision me ushtrime përgatitore për misione reale me aktivitetet e tjera ushtarake të cilat në Ministrinë e Forcës përmes direktivës së ministrit dhe të komandantit ato përfshihen në planet vjetore të punës të Forcës dhe në planet vjetore të trajnimeve bilaterale apo përmes memorandumeve të ndryshme që i bën Ministria e Mbrojtjes. Të gjitha këto aktivitete që janë futur në këtë projektligj janë apo duhet të përfshihen në këto dy plane. Pra, nuk kanë të bëjnë me mënyrën e drejtpërdrejtë, me gatishmërinë operacionale për dërgimin e Forcës në operacione jashtë vendit si dhe duhet të qëndrojnë si stërvitje dhe ushtrime përgatitore për dërgimin në mision.

Edhe në nenin 11 po ashtu përmendet e njëjta gjë. Po mendoj se duhet të bëhet po ky ndryshim. Pra gjatë pjesëmarrjes jo në aktivitetet e tjera ushtarake jashtë vendit, por në stërvitje dhe ushtrime përgatitore për dërgim në mision dhe në kuadër të gatishmërisë operacionale.

Tjetër çka pashë edhe një dukuri në dy nene, atë 5 dhe 7, kur është çështja e vendimmarrjes për dërgim të trupave jashtë vendit, në operacionet ndërkombëtare të paqes, në nenin 5, pika 3 thotë: Presidenti autorizon. Kurse në operacionet humanitare, thotë: Presidenti dhe Kuvendi njoftohet. Nisur nga germa e Kushtetutës, neni 84, më duket pika 12, Presidenti është komandanti suprem i Forcës. Për të ruajtur logjikën ushtarake, edhe ligjore, edhe në komunikim, atëherë një komandant suprem nuk bën autorizime dhe nuk njoftohet, por jep urdhra dhe i raportohet. Në këtë logjikë mendoj që në shqyrtimin mes dy leximeve është mirë ta shohim edhe një herë.

Unë nga praktikat e di që zyrtari ligjor i Presidentes zakonisht merr pjesë në këto grupe punuese brenda Ministrisë, por terma civilë besoj se s'kemi nevojë më t'i atribuojmë për Forcën, bazuar në Ligjin e vitit 2019, Forca ka mision ushtarak dhe terminologjia duhet të jetë brenda kornizave ushtarake.

Përndryshe si Grup Parlamentar, po flas si i autorizuar edhe në emër të grupit, e përkrahim dhe e mbështesim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga LDK-ja fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar!

Në parim, më lejoni të theksoj se e mbështesim Projektligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, sidomos që ka të bëjë me operacionet paqësore në botë. Dikush nëse nuk e di, shqiptarët e Kosovës e dinë çka do të thotë ndërhyrja ndërkombëtare dhe humanitare për të shpëtuar jetë. Edhe ne besoj si komb e kemi pikërisht të freskët akoma ndërhyrjen nga jashtë për aspektin e shpëtimit humanitar të shqiptarëve të Kosovës.



Duhet të theksoj vërejtjet që u thanë në projektligj, sidomos me procedurat për pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare humanitare, por edhe në vendimet që mos të kemi kolizion kushtetues. Pavarësisht se jemi republikë parlamentare, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e qartëson saktë vendimet për dërgimin e personelit të FSK-së jashtë vendit, sidomos në këto që quhen operacione ndërkombëtare humanitare. Me këtë rast, apo të them më mirë me ligj është sanksionuar që Qeveria e Republikës së Kosovës i merr këto me propozim të ministrit të mbrojtjes. Por, më lejoni të theksoj se Presidenti dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, jo që duhet të njoftohen me vendimin e Qeverisë, sipas paragrafit 2 të këtij neni, por duhet të mos anashkalohet fakti se Presidenti është komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës. D.m.th. duhet ta kemi të qartë këtë përjashtim dhe të jemi në harmoni me Kushtetutën dhe kompetencat e Presidentit të vendit, apo në këtë rast Presidentes së vendit.

Sido që të jetë, mendojmë që anashkalimi nuk besoj që është i rastësishëm. Kjo duhet të qartësohet. Mbi të gjitha edhe të saktësohet, sepse kjo barrë e përgjegjësisë atëherë bie mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne e kemi një vendim të vitit të kaluar i cili ka qenë në harmoni edhe me partnerët dhe miqtë ndërkombëtarë dhe ka qenë ndoshta avancimi më i madh i Forcës së Sigurisë në pjesëmarrjen e tyre dhe ushtarëve të rinj, sidomos në këtë që ndërlidhet me operacionet humanitare, por besoj që ministri i Mbrojtjes duhet ta ketë të qartë, apo më mirë të them Ministria e Mbrojtjes në këtë rast. Pavarësisht po e përsëris që ne jemi republikë parlamentare, Presidentja e vendit në këtë aspekt ka kompetenca mbi dërgimin në misione humanitare. E dimë që Qeveria është e treta në këtë rast, se Kuvendi është i pari, i dyti është Presidentja dhe e treta Qeveria. Këto nuk mund të anashkalohen me një ligj bazik.

Në fund të fundit, mbështetja ekziston, fryma mbështetëse e Kuvendit gjithmonë është në përkrahje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, por mos të lejojmë që të kemi kolizione mes ligjeve apo kompetenca që në të ardhmen e afërt mund të kemi dilema kushtetuese dhe e qesim në pozicion të palakmueshëm nuk po e them direkt ministrin e Mbrojtje, por Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. faleminderit!

**KRYETARI:** Time Kadriaj nga AAK-ja e ka fjalën.

**TIME KADRIAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Duke e parë që është një projektligj i rëndësisë së veçantë, ne e përkrahim dhe do ta votojmë këtë Projektligj për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në misione jashtë vendit, sepse ndoshta më mirë se ne askush s'e di, sepse ne kemi marrë prej këtyre forcave paqësore gjatë periudhës së luftës dhe ende i kemi të instaluar në Kosovë dhe mendoj që është një projektligj mjaft i rëndësishëm. Mendoj që me vërejtjet dhe sugjerimet që i kemi, meqenëse është në lexim të parë, ne mund t'i dërgojmë deri në lexim të dytë, qoftë përmes amendamenteve apo përmes anëtarit që

e kemi në komisionin përkatës dhe kur amendamentohet në grupe punuese. E përkrahim dhe votojmë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mirë. tash i fundit për diskutim është deputeti i Vetëvendosjes, Enver Dugolli.

**ENVER DUGOLLI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Unë më herët fola në emër të Komisionit, por po dua para se të filloj fjalimin, të siguroj kolegët deputetë se në lidhje me ato që u cekën, jo anashkalim i qëllimshëm apo diçka të ngjashme, nuk qëndrojnë asnjë, për shkak se jemi në kontakt edhe me Zyrën e Presidentit, me këshilltarët e saj. Dua të sqaroj se në momentin kur është draftuar ky ligj, këshilltari i Presidentes nuk ka marrë pjesë në draftimin e këtij ligji dhe për atë është krijuar kjo huti. Nuk janë dërguar komentet, mirëpo ju sigurojmë se gjatë leximit të dytë në Komision do të përfshihen të gjitha ato komente e rekomandime së bashku në grupin punues edhe me partitë e tjera politike. Nuk do të ketë asnjë gjë për t'u shqetësuar.

Projektligji për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit rregullon mënyrën dhe procedurat e dërgimit dhe tërheqjes së Forcës së Sigurisë jashtë vendit. Ky projektligj rregullon pjesëmarrjen e FSK-së në operacionet ndërkombëtare të paqes, operacionet humanitare dhe aktivitetet e tjera të ngjashme. Me këtë projektligj synohet të rregullohen dhe avancohen procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë në vendimmarrje të autoriteteve kompetente në këtë proces.

Projektligji gjithashtu synon thellimin e bashkëpunimit me aleatët tanë në fushën e mbrojtjes për të siguruar apo vendosur paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë. Projektligji përcakton në mënyrë të qartë mënyrën dhe procedurat për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, duke u bazuar në ofertën e Republikës së Kosovës në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, me ftesë të ndonjë organizate ndërkombëtare, me kërkesë të ndonjërit nga shtetet anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Sigurisë dhe bazuar në ndonjë rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Me miratimin e Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, ne po avancojmë bazën ligjore për FSK-në duke ushtruar procedura profesionale, kontroll demokratik civil dhe në fushën e përgjegjësive ndërkombëtare për përputhje të plotë me standardet e NATO-s dhe shteteve aleate.

Ky ligj gjithashtu është në pajtim me objektivat e përgjithshme dhe të veçanta të Qeverisë për mbrojtjen dhe sigurinë e vendit dhe e përfshirë në programin qeverisës 2021-2025.

Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes do ta mbështesë me votë miratimin e këtij ligji, duke dhënë kontribut në mes dy leximeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Sa jemi të pranishëm? 65 deputetë janë në sallë, kështu që mund ta votojmë këtë projektligj.

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për këtë projektligj. Pra, po flasim për dërgimin e FSK-së jashtë vendit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi pra e ka miratuar Projektligjin nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

E ngarkojmë Komisionin Funkcional dhe komisionet e tjera që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit pastaj t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

## **24. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020**

Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut e ka shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar atë për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe Kuvendit po ashtu ia ka rekomanduar atë që ta miratojë.

E ftoj Avokatin e Popullit, z. Naim Çelaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020.

**AVOKATI NAIM ÇELAJ:** I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Të nderuara zonja deputete,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Përfaqësues të zgjedhur të popullit,

Sot këtu para jush dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës në përmbushje të mandatit kushtetues të caktuar me nenin 135 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës prezantoj të përmbledhur në fjalën time raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2020.

Institucioni i Avokatit të Popullit përmes raportin mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vend synon të përmbledhur paraqes gjendjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe gjithë zhvillimet brenda një viti që kanë të bëjnë me promovimin, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

Viti 2020 nuk ishte viti i zakonshëm, për shumë arsye. Fillimisht përballja me pandeminë COVID-19 e kishte gjetur shoqërinë tonë të papërgatitur për të reaguar në një situatë të tillë emergjente ku rrezikohej shëndeti publik.

Masat e ndërmarra nga Qeveria, kufizimet dhe masat e tjera preventive kanë shkaktuar një sërë reagimesh që ndërliken me cenimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Kjo situatë e krijuar ka ndikuar në raport me pushtetin legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor e që janë pasqyruar në raportin që unë sot po e prezantoj para jush. Përveç krizës së shkaktuar gjatë vitit 2020, zgjedhjet e përkohshme dhe ndryshimet e legjislativit dhe qeverisë kanë pasur ndikimin e tyre edhe në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.

Unë do të filloja me pushtetin legjislativ për të dhënë një pasqyrë nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit, i cili për vitin 2020 konstaton se nga programi legjislativ për vitin 2020 Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë shqyrtimin dhe miratimin e 135 projektligjeve, mirëpo nuk ka arritur ta realizojë këtë program dhe nga ky program janë realizuar vetëm 17 ligje. Numri i vogël i ligjeve të miratuara nga Kuvendi është rezultat i funksionimit jo të mirë të Kuvendit dhe të Qeverisë, për shkak të rrethanave politike dhe të atyre të shkaktuara nga pandemia me COVID-19.

Një ndër ngjarjet më të veçanta që ka ndodhur në raport me legjislativin gjatë vitit raportues, është miratimi i Ligjit për parandalimin e luftimit të pandemisë COVID-19. Ky ligj është nxjerrë si rezultat i vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese m rastin e nxjerrjes dhe vendosjes sipas Aktgjyqimit të ngritur me kërkesën e Presidentit dhe vendimit të Qeverisë për masat kufizuese, respektivisht ndaj kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit.

Më 27 shtator 2020 Kuvendi e miratoi amendamentin kushtetues nr. 26, me të cilin Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje apo si quhet ndryshe Konventa e Stambollit bëhet pjesë integrale e Kushtetutës që e konsiderojmë si një e arritur e madhe e demokracisë dhe e legjislativit në këtë periudhë.

Sa i përket gjyqësorit, gjatë vitit 2020, mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut si pasojë e masave kundër pandemisë COVID me të cilat është kufizuar puna e institucioneve publike ka ndikuar negativisht në punën e gjyqësorit. Si pasojë ka pasur reduktim të punës, si në gjyqësor, në prokurori, ka pasur përjashtim të publikut, dhe zvarritje e shtyrje të procedurave gjyqësore. Në bazë të numrit të ankesave të paraqitura tek Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti rezulton se qytetarët kanë vazhduar të mos kenë besim në sistemin gjyqësor, pra qytetarët edhe më tutje kanë vazhduar të përballen me zvarritje të procedurave për vendosjen e rasteve të tyre në të gjitha shkallët dhe instancat.

Gjatë vitit raportues, duke u bazuar në Ligjin për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku mandat dhe rol kyç ka edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar 15 ankesa të cilat janë proceduar sipas ligjit të lartpërmendur.

Lidhur me punën e ekzekutivit. Puna e pushtetit ekzekutiv për vitin raportues pa dyshim ka qenë e karakterizuar në masë të madhe nga pandemia COVID. Qeveria e Kosovës në fillim të paraqitjes së pandemisë kishte vendosur masa rigoroze të kufizimit të lëvizjes si masë për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Nga kjo periudhë e deri në fund të vitit 2020, Avokati i Popullit ka pranuar 64 ankesa të ndërlidhura me masat kundër pandemisë.

Më 30 mars 2020, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin me pakon emergjente. Ajo që është vërejtur në këtë periudhë dhe vendimet e mëvonshme për mbështetje dhe rimëkëmbje ekonomike, në këtë periudhë janë ankesat për vonesa në zbatim të pagesave dhe masave përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit ka reaguar me rekomandim për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik për respektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve me rastin e publikimit të informatave zyrtare.

Sa i përket reformës në administratë, duhet veçuar dy aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me vlerësimin e kushtetutshmërisë, të Ligjit për zyrtarët publikë dhe Ligjit për pagat. Njërin e ka ndryshuar në disa dispozita ligjore, fjala është për Ligjin për zyrtarët publikë, ndërsa Ligji për pagat është anuluar në tërësi.

Vlen të theksohet se përkundër faktit se këto dy ligje pjesërisht dhe tërësisht janë shpallur të pavlefshëm, nuk është arritur të miratohen ligjet e ndryshuara në përputhje me gjetjet e konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Unë kësaj radhe kam menduar të jem pak më i gjatë dhe të shkoj në elaborim të disa gjetjeve që gjatë vitit 2020 ka gjetur Avokati i Popullit. Prandaj, duke provuar të jem sa më i shkurtër, por t'i përmbledh të gjitha, dua të shkoj në mënyrë telegrafike t'i përmend vetëm disa që unë i kam konsideruar më të rëndësishme.

Po nis nga mjedisi. Edhe në vitin raportues kanë vazhduar pakënaqësitë dhe reagimet e publikut lidhur me operimin dhe instalimin e hidrocentraleve. Është fjala për 2020. Problem më vete është në këtë drejtim mungesa e transparencës dhe llogaridhënies së organeve kompetente. Nuk është regjistruar përmirësim sa i përket çështjes së fragmentimit dhe ndërhyrjeve në tokat bujqësore dhe shkatërrimin e sipërfaqeve pyjore. Për më tepër masat mbrojtëse nga pandemia kanë ndikuar

në zbehjen e punës së inspektorateve. Taksa ekologjike nuk është shfrytëzuar për dedikimin e saj. Situata e krijuar me pandemia ka reduktuar hapësirën për promovim dhe edukim të publikut për të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Gjithashtu nuk janë vërejtur zhvillime në drejtim të ndërtimit të politikave të cilat do të ndikonin në mbrojtjen e tokave dhe në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të cilat do të parandalonin pasojat mjedisore dhe socio-ekonomike të degradimit të tokës. Nuk është vërejtur, gjegjësisht në institucionet kompetente në nivelin komunal dhe qendror, nuk kanë arritur t'u ofrojnë qytetarëve mbrojtje efektive nga zhurma dhe efektet e saj.

Edhe këtë vit raportues nuk është arritur të zgjidhet çështja e shpronësimit për banorët e zonës me interes të veçantë ekonomik fusha e mihjes së re. Dua të theksoj se gjatë vitit 2020, Avokati i Popullit ka pranuar 62 ankesa të cilat kanë të bëjnë me qasjen në dokumente zyrtare.

Sa i përket të drejtave të fëmijëve, po kaloj në një të drejtë tjetër. Analiza e situatës së fëmijëve në Kosovë në këtë vit tregon se fëmijët ende hasin në vështirësi për gëzimin e plotë të të drejtave të tyre. Këto vështirësi janë shfaqur gati në të gjitha fushat. Plotësimi i kornizës ligjore me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe hyrja në fuqi e këtij ligji në korrik 2020 ka shënuar një hap të rëndësishëm, por nuk është përcjellë me nxjerrjen e akteve nënligjore, gjë që ka bërë që nuk ka krijuar bazën që ky ligj të zbatohet. Për të drejtat e fëmijëve, Avokati i Popullit ka pranuar 55 ankesa, një numër i të cilave është parashtruar nga prindërit e fëmijëve.

Gjatë pandemisë, gjendja e krijuar ka nxjerrë në pah edhe më shumë mangësi në realizimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe ka thelluar pabarazitë ekzistuese. Efektet socio-ekonomike të virusit dhe masat e ndërmarra për të kontrolluar pandeminë kanë ndikuar në mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve. Një shembull ishte kalimi nga mësimi në shkollë në mësim online, ku u pa më shumë se fëmijët nuk kishin qasje në pajisjet teknologjike dhe në internet dhe pjesa më e rrezikuar e anashkalimit të kësaj të drejte ishin fëmijët me aftësi të kufizuar dhe fëmijët që vinin nga komunitetet.

Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të mandatit të vet ushtron edhe mandatin e organit të barazisë, pra barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit. Kjo në bazë të ligjeve përkatëse të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në këtë periudhë, Avokati i Popullit ka trajtuar 145 ankesa individuale, ku ankuesit pretendojnë se janë viktima të diskriminimit kryesisht nga sektori publik. Po ashtu, Avokati i Popullit me vetiniciativë ka hapur për hetim më shumë se 10 raste.

Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve - gjatë pandemisë mund të themi se Avokati i Popullit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zoti Çelaj, nëse mund ta përmbyllni shpjegimin e raportit tuaj me pak fjalë. Shtojani edhe dy minuta ju lutem fjalës së Avokatit të Popullit.

AVOKATI NAIM ÇELAJ: Mirë, po e anashkaloj pjesën tjetër. Po kaloj në tri kërkesa që unë kam për Parlamentin, për deputetet e kësaj legjislature e që janë përsëritje edhe nga vitet e tjera.

E para ka të bëjë me heqjen e procedurës së votimit të raportit të Avokatit të Popullit në Kuvend, ngase është në kundërshtim me parimet dhe standardet mbi të cilat funksionon Institucioni i Avokatit të Popullit. Raporti i Avokatit të Popullit paraqet gjendjen e të drejtave të njeriut, prandaj votimi i këtij raporti nuk ka sens dhe nuk është në përputhje me parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venedikut.

E dyta, është kërkesa që të ketë më shumë debat parlamentar dhe që seanca ku shqyrtohet raporti i Avokatit të Popullit të jetë seancë e veçantë parlamentare. Të drejtat dhe liritë e njeriut, respektimi i tyre është themeli i sistemit tonë demokratik, prandaj pa dyshim meriton një ditë e veçantë t'i kushtohet shqyrtimit dhe diskutimit të raportit të Avokatit të Popullit.

E treta ka të bëjë me kërkesën time që Kuvendi të ketë rol më aktiv në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit përmes komisioneve funksionale dhe koordinimit me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Unë po shpresoj që në raportimin tjetër do të kemi mundësi më shumë t'i elaborojmë të gjitha pikat dhe krejt gjetjet që Avokati i Popullit ka konstatuar për një periudhë brenda një viti. Ju faleminderit!

KRYETARI: E falënderojmë Avokatin e Popullit për këtë prezantim të raportit për vitin 2020.

Tash radhën e ka Komisioni Funkcional. Është deputetja Fjolla Ujkani e ka fjalën në emër të Komisionit Funkcional.

FJOLLA UJKANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Personat e pagjetur, Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe Peticione, duk u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 maj 2021 shqyrtoi Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime:

Kuvendi të miratojë Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 me arsyetim që Institucioni i Avokatit të Popullit duke u bazuar në nenin 29.1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ia ka paraqitur Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin për vitin 2020.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Personat e pagjetur, Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe Peticione, duk u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 në mbledhjen e mbajtur më 11 maj 2021.

Raporti për nga ana përmbajtjesore, metodologjia e hartimit dhe strukturimi është gjithëpërfshirës si dhe i plotëson kushtet për t'iu proceduar Kuvendit për miratim. Mbi këtë bazë, Komisioni vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë miratimin e Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga Komisioni për Buxhet, kryetarin nuk e kemi. Nuk e do fjalën askush. Tash është radha e deputetëve.

Në emër të grupeve nuk është lajmëruar askush, por Tinka Kurti e ka fjalën në emër të Vetëvendosjes.

Tinka Kurtit ia kaloni fjalën, ju lutem, regjia!

**TINKA KURTI:** Faleminderit, kryetar!

Si Komision për të Drejtat e Njeriut dhe si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e kemi trajtuar raportin e punës për vitin 2020 të Institucionit të Avokatit të Popullit, para jemi në fund të 2021-tës dhe jemi duke diskutuar për vitin e kaluar.

Sigurisht që kur flasim për të drejtat e njeriut bëhet fjalë për çështje shumë të ndjeshme jetësore dhe respektimi i këtyre të drejtave mbetet vërtet larg asaj ku dëshirojmë të jemi si shoqëri. Në Komision ne e kemi shfaqur edhe brengën tonë në lidhje me rritjen e rasteve të dhunës ndaj grave dhe pamundësisë që Avokati i Popullit t'i ndjekë të gjitha këto raste. Pra, në çdo instancë që mund të merret me to, ka më shumë viktime, shumë më shumë, sesa që ka mbrojtje.

Gjithashtu, në Komision është diskutuar edhe numri i personave të paregjistruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, një problem tjetër pra që meriton më shumë trajtim. Ndërkohë, është pozitive, paradoksalisht pozitive që gjendja e rëndë e mjedisit cilësohet si themelore dhe gjend vend qendror në raport. E drejta për ajër, ujë e mjedis të pastër futet në raport si e drejtë themelore për të jetuar në një ambient të sigurt e të shëndetshëm. Gjendja me mjedisin nuk është aspak e mirë dhe obligohemi të gjithë ta bëjmë pjesën tonë, si institucione më së shumti.

Raporti flet edhe për qytetarët që jetojnë në varfëri. Në shumë raste kjo është tregues ndoshta për të gjitha problemet e tjera. Zor të flitet për të drejta kur kemi varfëri. Kjo tregon edhe një herë, edhe në këtë dokument që barazia dhe drejtësia janë të lidhura pazgjidhshëm njëra me tjetrën.



Ndoshta më të prekurit janë qytetarët rom, ashkali, egjiptian, por jo vetëm ata. Varfëria i prek të gjitha komunitetet e tjera, në masë të madh madje dhe shumicën gjithashtu.

E vërtetë që fjala pandemi përmendet shpesh në këtë dokument. Gjithashtu, aty me të drejtë përmendet se kjo është sfidë e paprecedent për të drejtat e njeriut në tërë botën. Mendoj se masat e vendimet që janë marrë janë të ngjashme me ato që janë aplikuar edhe në vendet e tjera demokratike.

Problemet me të drejtat e njeriut janë të shumta dhe raporti është voluminoz. Unë nuk do të kisha vazhduar më shumë. Ashtu si Komision për Drejtat e Njeriut, sikur Komisioni që i ka rekomanduar Kuvendit, edhe si grup e përkrahim miratimin e Raportit e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe i urojmë punë të mbarë në këtë mision.

**KRYETARI:** Nga PDK-ja, fjalën e ka deputetja Ariana Musliu-Shoshi.

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe ne si grup parlamentar, duke mos dashur pra që të përsëritem me parafolëset e mia, me vërejtjet të cilat i kemi paraqitur në Komision. Dua të tregoj se si Grup Parlamentar i PDK-së, ne e kemi shqyrtuar këtë raport në detaje dhe konsiderojmë se është gjithëpërfshirës, dhe trajton çështje të rëndësishme me të cilat përballet Avokati i Popullit, dhe si i tillë vlerësojmë se i plotëson kushtet për miratim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga LDK-ja, fjalën e ka deputetja Marigona Geci.

**MARIGONA GECI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit, raport ky i cili përmbledhë një pasqyrë të plotë të veprimtarisë së institucionit më të madh dhe më të rëndësishëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend, në përputhje me mandatin e tij kushtetues.

Në 176 faqet e tij, raporti hedhë dritë mbi qasjen e institucioneve shtetërore në raport me të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve në Republikën e Kosovës.

Raporti përmban të gjeturat e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2020, lidhur me rastet e shkeljeve sistematike dhe individuale të lirive dhe të drejtave të njeriut. Përmban rekomandime, opinion dhe propozime për ndërmarrjen e masave që kontribuojnë në ngritjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Sipas raportit të Avokatit të Popullit, nga data 15 mars deri më 31 dhjetor 2020, ky institucion ka pranuar 64 ankesa që ndërlidhen me pandeminë, derisa disa prej tyre bënin fjalë për dënimet e qytetarëve, për mosrespektimin e masave, ndërsa vet subjektet politike kanë marrë pjesë në fushatë dhe në tubime zgjedhore. Dhe, nëse për qytetarët është e dënueshme kjo, atëherë duhet të jetë edhe për partitë politike edhe për shkak të mosrespektimit të masave.

Në bazë të këtij raporti, vazhdon të mbetet shqetësues numri i madh i vendimeve gjyqësore, të cilat nuk janë ekzekutuar. Dhe, në bazë të vendimit dhe numrit të ankesave të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë këtij raportues, rezulton se qytetarët vazhdojnë të mos kenë besim në sistemin gjyqësor.

Falë punës së mëhershme të Avokatit të Popullit, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, kanë pezulluar ekzekutimin e vendimit të ZRRE-së për pagesën e energjisë elektrike të qytetarëve të komunave veriore të Republikës së Kosovës, që u faturoheshin konsumatorëve të tjerë.

Por, në kundërshtim me këto aktvendime dhe aktgjykime të tri instancave më të larta gjyqësore, Kuvendi i Kosovës me deputetët e pozitës, më 6 maj 2021, me 61 vota pro, i miratoi rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, lidhur me kërkesën e KOSTT-it për sigurimin e mjeteve financiare në vlerë prej 11 milionë eurosh, për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në kate komunat veriore.

Duke pasur parasysh këto aktvendime të instancave më të larta gjyqësore për pezullimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së, Kuvendi në kundërshtim me aktgjykimet e mëhershme ka aprovuar rekomandimet e komisionit, për alokimin e mjeteve financiare për pagesën e rrymës për një pjesë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kjo u vërtetua edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë më 7 tetor 2021 me numër të protokollit 413202, ku është aprovuar si e bazuar kërkesë-padia e Avokatit të Popullit, dhe e ka anuluar si të kundërligjshëm vendimin e ZRRE-së që të ndërmarrë veprime që obligojnë KEDS-in që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit të konsumatorëve, të cilët janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, dhe atë për periudhën nga data 6 shkurt 2012 e deri më 20 tetor 2017, në vlerë prej 40 milionë e 855 mijë e 480 euro.

Ky aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, e anulon apriori edhe vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 6 maj 2021, dhe e detyron Qeverinë që 11 milionë euro t'i kthejë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, si pagesë e kundërligjshme që i është i bërë KOSTT-it.

Kuvendi i Kosovës do të duhej ta anulojë ligjin në të cilin është thirrur Gjykata Themelore në Prishtinë, ta amendamentojë ndryshe, dhe pastaj Kuvendi të alokojë mjete financiare, sepse ligjin në të cilin është thirrur gjykata dhe vendimi i Kuvendit janë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Duke u bazuar në këtë aktgjykim, ne deputetët e LDK-së, kërkojmë na Avokati i Popullit që ta shqyrtojë vendimin e Kuvendit të Kosovës të datës 6 maj, për ndarjen e 11 milionë euro për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në katër komunat veriore, gjë që është në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe apriori është në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës janë të barabartë.

Ju deputetët e pozitës, gjatë kohës sa ishit në opozitë e luanit rolin e zhurmuesit për pagesën prej 2,5% që i paguan qytetarët për pesë vete radhazi, ndërsa kur erdhët në pushtet miratuan propozimin për ndarjen e 11 milionë eurove për pagesën e rrymës për katër komunat veriore, nga mjetet e taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

Këtu ndryshimi është se me vendimin e ZRRE-së, paguanin vetëm ata që paguanin rregullisht faturat e rrymës, ndërsa tani energjinë elektrike ua paguajnë taksapaguesit.

Pas shqyrtimit në tërësi të raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka vendosur që ta përkrahë këtë raport. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga AAK-ja fjalën e ka deputetja Time Kadriaj.

**TIME KADRIAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ne e falënderojmë Avokatin e Popullit për raportin voluminoz dhe për prezantimin e raportit që bëri këtu në seancën plenare, para deputetëve të Republikës së Kosovës, dhe ne si deputetë, qoftë edhe si komisione parlamentare, të gjitha ato vërejtje dhe sugjerime të cilat janë të përfshira në raportin e Avokatit të Popullit, duhet t'i marrim seriozisht.

Dhe, në bazë të komisioneve që i prezantojmë, këto shqetësime t'i ngremë çdo ditë, qoftë duke iu drejtuar dikastereve të cilat s'i kanë përmbushur obligimet ose aty ku ka shkelje ligjore, t'i adresojmë, qoftë të ministrat e caktuar apo t'i ngremë si dilema edhe në institucionet e tjera të cilat kanë bërë shkelje dhe që janë të prezantuara në raportin e Avokatit të Popullit.

Ne si Aleancë e përkrahim dhe do ta votojmë raportin e Avokatit të Popullit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mirë. Ka përfunduar radha e diskutuesve për raportin e Avokatit të Popullit. Nuk e di sa jem në sallë, por me siguri që duhet të kemi kuorum. Jo. 48 deputetë janë të pranishëm. Ju lus që t'i thërrisni! 59 deputetë janë në sallë.

62 deputetë i kemi tash të pranishëm.

Të nderuar deputetë,

Ju lus të përcaktoheni me votë lidhur me raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2020.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Atëherë, konstatoj që me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2020.

Tani jemi te pika e fundit e kësaj seance:

## **25. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2020**

E falënderojmë Avokatin e Popullit në ndërkohë meqë po largohet nga salla. Punë të mbarë!

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Komision për Buxhet e ka trajtuar këtë raport dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Nuk është lehtë të jesh deputet, a po e sheh!

E ftojme fillimisht, kryetarin e komisionit, Ardian Gola që ta arsyetojë raportin e Komisionit Funkcional.

**ARDIAN GOLA:** Faleminderit, kryetar!

Realisht, komisioni në mbledhjen e rregullt që ka pasur më 25 maj 2021, e ka shqyrtuar këtë raport dhe e ka vazhduar praktikën e legjislaturave të mëhershme, duke mos e rekomanduar për miratim një raport, i cili vjen nga institucion të cilit i mungon organi ekzekutiv.

Në rastin konkret, Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Kosovës nuk ka pasur bord dhe në mungesë të kësaj përbërjeje që do t'i ekzekutonte dhe të ishte në funksion të realizimit të mandatit të tij, sigurisht që krejt çfarë është raportuar në atë raport, kanë qenë aktivitete administrative që janë një tërësi funksionesh elementare të Administratës.

Andaj, me shumicë votash, në këtë mbledhje të rregullt është rekomanduar mosmiratimi i këtij raporti. Edhe njëherë po e them, unë mundem t'i referohem edhe praktikave të mëhershme të legjislaturave, siç është rasti i Legjislaturës IV dhe V, në rastet kur nuk është rekomanduar për miratim, saktësisht për të njëjtin arsyetim të cilin e kemi përdorur edhe ne si komision, e që është mungesa e bordit si një organ ekzekutiv. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Komisioni për Buxhet nuk e do fjalën askush. Deputetja Eliza Hoxha e keni fjalën. Urdhëro!

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Pajtohem në parim me kryetarin e komisionit, sepse duke qenë se nga Rregullorja e Punës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore, precizohet saktë në detyrat dhe kompetencat e bordit, që bordi së pari miraton këtë raport dhe pastaj vije në Komisionin Funkcional.

Në fakt, raporti ka ardhur, sepse ai institucion është institucion i themeluar nga ky Kuvend, dhe ata duhet të raportojnë diku, pavarësisht që ka një raport të punës së përditshme administrative që është bërë gjatë gjithë vitit, që është për t'u përshëndetur, sepse në mungesë të bordit tash e sa vite, meqenëse në këtë legjislatura veç është martuar dhe kemi tash një bord aty, raportet kanë ardhur të tilla, ose nuk janë shqyrtuar fare ose në rast se janë shqyrtuar rekomandohen për t'u mos u miratuar.

Por, në konceptin e përgjithshëm, mosmiratimi i një raporti pune edhe pse institucioni ka funksionuar, pavarësisht që s'ka pasur vendimmarrje për listën e aseteve të trashëgimisë kulturore, por ka bërë punët e tjera që janë të rëndësishme për Këshillin për Trashëgimi Kulturore në jetën e përditshme, mendoj që i bie një hije goxha e rëndë atij institucioni për fajin e vet këtij Kuvendi dhe cilësdo qeveri prej vitit 2018 deri më sot që nuk kanë qenë në gjendje që ta krijojë bordin për trashëgime kulturore.

Meqenëse, tani veç e kemi themeluar, uroj që të kemi praktika të tjera më të mira në vijim. Andaj, nëse e kemi shqyrtuar këtë raport në muajin maj kur nuk ka pasur bord ky institucion, në Komisionin për Financa, ky raport është shqyrtuar në muajin shtator kur ky institucion ka pasur një bord, dhe kjo është diskrepanca ndoshta në njëfarë forme.

Por, ajo që është më e rëndësishmja që besoj që duhet të shqyrtohet, është se a duhet të vijnë raportet e institucioneve të cilat nuk kanë organ ekzekutiv në periudha të caktuara dhe ai raport duhet të miratohet nga ky ekzekutiv, të vijnë në Kuvend dhe të shqyrtohen këtu, sepse po i lëmë hije të keq vet institucionit, duke mos pasur hallka të cilat janë kontinuale në këtë proces. Faleminderit!

KRYETARI: I dëgjuar këto perspektiva. Tash, deputetë të tjerë nuk ka në radhë që janë paraqitur, por... Po! Nënkryetari... Deputetja e LDK-së, Vlora Dumoshi e ka fjalën.

VLORA DUMOSHI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e miraton raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.

KRYETARI: Besnik Tahiri nga Grupi Parlamentar i AAK-së.

BESNIK TAHIRI: I kemi dy situata, kryetar, këtu. Një situatë kur komisioni përkatës, në mungesë të bordit dhe institucionit funksional nuk e miraton raportin. Pastaj e kemi situatën tjetër, ku në Komision për Financa dhe Buxhet ka shkuar raporti dhe me sa di unë, ka kaluar.

Pyetja ime shtrohet: pse ne e trajtojmë këtë temë në seancë plenare? Pse duhet ta trajtojmë këtë raport në seancë plenare? Është mirë të kthehemi në komisione, ta shohim dhe të mos vendosim. Çka po votojmë tash kur në komisionin përkatës, e kemi situatën kur e kanë kundërshtuar në mungesë të institucioneve përkatëse raportin në fjalë, ndërsa në Komisionin për Financa dhe Buxhet, ka kaluar.

Për këtë arsye kërkoj që ky raport të kthehet prapa dhe të ketë një dakordim, në mënyrë që të votohet. Tani, ne nuk e di për çka po votojmë.

KRYETARI: Zoti Gola, a keni kërkuar fjalën sërish? Urdhëro, për sqarime shtesë!

ARDIAN GOLA: Qysh do që të jetë, unë nuk mund ta marr tani rolin e kryetarit ose anëtarit të Komisionit për Buxhet, por realisht, arsyetimi i tij me shumë gjasë, po prejudioj, është në funksion të arsyetimit të aspekteve buxhetore dhe financiare.

Për aq sa ka mbulueshmëri për të gjitha shpenzimet konform ligjeve në fuqi, nuk ka arsye që të mos miratohet. Komisioni për Arsim dhe Kulturë, megjithatë trajton aspektet përmbajtësore dhe në mungesë të bordit, në mungesë të çfarëdo përmbajtjeje e cila është në funksion të realizimit të mandatit të kësaj trupe, realisht nuk kemi pasur as çka të rekomandojmë për miratim, sepse nuk ka pasur realisht bord, nuk ka pasur ekzekutiv, nuk ka pasur funksione ekzekutive.

Andaj, në këtë kontekst, përtej aspekteve buxhetore, konsideroj që rekomandimi mbi bazën e substancës, përmbajtjes së raportit, është më e rëndësishme që të rekomandohet sesa aspektet buxhetore. Ky është mendimi im.

KRYETARI: Zoti Tahiri, një replikë të shkurtër.

BESNIK TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Në qoftë se ky raport është në votim vetëm për sa një procedurë, atëherë në rregull, ne mund të votojmë pro apo kundër, mirëpo nuk ka kurrfarë efekti në funksionalitet. Dhe, në qoftë se ka efekt në funksionalizimin, në buxhetin e këtij institucioni, atëherë ne duhet ta trajtojmë këtë temë, për shkak se më të vërtet ne nuk po dimë realisht çka po votojmë.

Në qoftë se është veç procedurë e cila duhet të trajtohet, të vjen në seancë plenare të votohet, në rregull, po votojmë, s'ka kurrfarë efekti në praktikë. Në qoftë se ka efekt që e penalizon këtë institucion, atëherë ne duhet ta trajtojmë seriozisht dhe të kemi informatën paraprake. Këtë sqarim kisha pasur dëshirë ta dijë.

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari e Kuvendit, Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Mua më duhet ta bëj një pyetje paradoksale: a po flasim për një dokument apo jo?! Pra, nëse ky s'është një dokument, komisionet s'do të duhej ta trajtonin fare.

Vërtet ne flasim për dokument të cilin dy komisione të ndryshme të Kuvendit të Kosovës e kanë trajtuar në dy mënyra të ndryshme. Kemi të bëjmë me dy kapituj të së njëjtës përmbajtje.

Tash po përpiqem ta shpjegoj. Nëse marrim dhe lexojmë rekomandimin e komisionit të fushës, do të vërejmë që ai përputhet me raportimet e këtij teksti. Pra, kjo do të thotë që ky këshill funksional ose jofunksional ka raportuar me saktësi.

E tash keni kujdes! Ky këshill, kjo agjenci e Kuvendit, pra që është një agjenci e pavarur, ka dy pjesë funksionale. Nuk i mungon ekzekutivi, sepse ekzekutivi i këtij komisioni është Sekretariati, i ka munguar bordi vendimmarrës. Sekretariati është implementues i punëve, i detyrimeve dhe Sekretariati ndjek punët afatmesme. Pra, punët vjetore afatmesme, afatgjata e të tjerë.

Pra, në këtë këshill bordi vendimmarrës mund të vendosë për çështje të cilat shtrihen përtej një viti. Kështu që, nuk ka shumë kuptim që të mos trajtohet si valid dokumenti. Vota e Kuvendit për, këtu nuk i jep vlerë punës së këshillit, por e vërteton gjendjen, dhe në këtë rast, këshilli ka raportuar me saktësi, thotë që nuk ka bord ekzekutiv dhe që duhet të formohet, thotë që ka mungesa në këto fusha dhe që duhet të plotësohen, thotë që duhet të implementohet Ligji për trashëgimi kulturore. A duhet apo s'duhet? Që duhet të plotësohen dosjet që të shtohen asetet në mbrojtje të përhershme. Që duhet të kemi kujdes me listën e aseteve në mbrojtje vjetore, sepse kemi vetëm 23 asete në mbrojtje të përhershme. Nga viti 2016 asnjë aset i ri. Dhe, rekomandime të tjera.

Pra, Kuvendi duhet ta miratojë këtë raport për shkak të konstatimit të saktë të gjendjes dhe për shkak të rekomandimeve të rëndësishme. Kjo nuk i jep vlerë. Nëse ne votojmë, nuk do të thotë që këta kanë punuar mirë, përkundrazi, ne i vërtetojmë mungesat.

E pse është i rëndësishëm në thelb ky këshill? Shumë mirë që tani është funksional, sepse as Qeveria në fushën e trashëgimisë kulture nuk mund të bëjë politika as nuk mund ta iniciojë asnjë projekt pa rekomandimin e këtij këshilli. Kjo është logjika e punës dhe ne duhet ta kthejmë në parim.

Nëse një raport punë thotë që s'kemi punuar mirë, Kuvendi duhet ta votojë, sepse e vërteton. I thotë me saktësi të gjitha mungesa. Funksionin vetëm Sekretariati. Vetëm Sekretariati. Po, pra.

Implementuesi është Sekretariati. Çka nëse këshilli propozon politika për një trevjeçar? Jo, çka nëse, po kjo ndodhë. Pra, raporti është i saktë. Ne duhet të konstatojmë saktësinë ose jo. Ne s'mund të përcaktojmë vlerë të punës, vetëm saktësi të raportit, sikurse te rasti i auditimit. Gjendja me pasqyrat financiare është pasqyruar me saktësi materiale apo jo? Po ose jo.

Nëse është pasqyruar me saktësi materiale, logjikisht duhet të votohet për. Kjo nuk është çështje e shumicës ose e pakicës është çështje e vlerës së saktësisë së raportimit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetari e komisionit, Ardian Gola, në fund të replikës po e konsiderojmë këtë.

**ARDIAN GOLA:** Faleminderit, kryetar! Po, është e vërtetë atë që po e thotë edhe deputeti Shala, por këtu është problemi se kjo trupë nuk ka pasur bord që tri vite. Kështu që, realisht Sekretariati si trupë ekzekutive nuk ka pasur as çfarë të implementojë në mungesë të bordit, pikërisht. Në mungesë të vendimmarrjeve të cilat, po supozojmë duhet t'i ketë bordi.

Kështu që, nuk e di çka mund të miratojmë. Ky është paradoksi. Unë e kuptoj që pak është paradoksale, po u përpoqa që ta zgjidhë kontradiktën ndërmjet këtyre dy komisioneve, funksionalit dhe të përhershmit.

**KRYETARI:** Nënkryetari Shala prapë fjalën.

**KUJTIM SHALA:** Edhe njëherë. Nëse ky nuk është një dokument, pse e kemi në seancë? S'ka pikë logjike. Çështja tjetër sa i takon përmbajtjes. Duhet të lexoni. Faqe 14, faqe 21, është raporti për punët që i ka kryer Sekretariati. Pra, raporti është plotë.

Pjesa që lidhet me bordin vendimmarrës konstatohet që as s'ka aktivitet, se s'ka funksionuar. Aktiviteti i Sekretariatit është përshkruar nga faqja 15 deri në faqen 21, të raportit. Pra, zgjidheni këtë problem. Ky s'është dokument. S'është dokument, pse ia jepni seancës? S'ka kuptim.

**KRYETARI:** Me të vërtetë as unë s'e kam të qartë se çka zgjidhim me votim. Zoti Rrustemi e ka fjalën, Adnan Rrustemi.

**ADNAN RRUSTEMI:** Faleminderit, kryetar!

Pa u lëshuar në përmbajtje, sepse u përket Komisionit Funksional dhe deputetëve të tjerë, po proceduralisht, këshilli në rastin konkret, është një institucion kolegjal dhe organi më i lartë është këshilli i përbërë nga 7 anëtarë që i emëron Kuvendi i Kosovës.

Nëse ata nuk kanë ekzistuar, respektivisht nuk ka ekzistuar titullari kryesor, i cili i miraton politikat, vendimet, raportet e institucionit, por...Jo, jo, dakord jam, unë po e kuptoj situatën paradoksale, por unë thjesht, mendoj që e vërteta është që nuk do duhej të shkonte nëpër



komisione, nuk do duhej Kryesia ta shpërndajë nëpër komisione, por jemi në situatën që jemi, duhet ta mbyllim me një vendim se s'bën ndryshe.

KRYETARI: Po, urdhëro zoti Shala edhe një herë.

KUJTIM SHALA: Nëse Sekretariati s'ka të drejtë t'i japë Kuvendit raport për punën e këshillit, derisa Sekretariati s'ka bord ekzekutiv, pse po e trajtojmë si dokument, po pyes unë.

Nëse ky s'është një dokument valid, pse komisionet janë marrë me të. Tërhiqeni. Nëse është një dokument valid raporti, është në rregull, sepse është i saktë.

KRYETARI: Kryetarit të Komisionit për Arsim, sërish ia japim fjalën.

ARDIAN GOLA: Si dokument është dërguar mbi baza periodike. Është dërguar mbi baza periodike. Si dokument, si raport është dërguar dhe dërgohet mbi baza periodike. Shqyrtohet nga komisioni dhe rekomandohet për... Po, është valid. Sigurisht që është valid. Po, votim kundër, sepse s'ka pasur aktivitete për të cilat ia vlen që të miratohej pro.

Ke raste kur është rekomanduar mosmiratimi, sepse ka qenë raport i dobët. Po, po, ka raste. Në këtë legjislaturat që kanë kaluar. Ka raste kur raporti nuk është rekomanduar për miratim, sepse ka qenë raportim i dobët, përmbajtja nuk e ka arsyetuar miratimin. Tash ju tregoj se në cilën legjislaturë ka qenë.

Edhe njëherë po ju them, nuk është precedent. Legjislatura IV dhe V në vitin 2013 dhe në vitin 2015, në këtë Parlament, raporti i këtij këshilli është rekomanduar për mosmiratim, dhe në këtë seancë nuk është miratuar raporti për të njëjtat arsye që po i them unë këtu. Për të njëjta arsye.

Në vitin 2013, raporti i vitit 2012 dhe në vitin 2015, raporti i vitit 2014. Ndërsa, në vitin 2017...

KRYETARI: Në votim e qesim, nuk është problem. Por, i kemi vetëm 58 deputetë. Thirrini deputetët, ju lutem, që të kthehen në sallë dhe të përmbyllim këtë seancë. Mirë. 61 deputetë jemi të pranishëm tani.

E hedhim në votim këtë raport paradoksal për të cilin me siguri që në faza të mëhershme do të mund të rregullohej se a do duhej të vinte në seancë apo jo, mirëpo meqenëse ka ardhur tash duhet t'ia japim një epilog.

Kështu që, 61 deputetë jemi të pranishëm. Ju lus që me ngritje dore të deklarohej për këtë raport.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Edhe një herë, mos votoni nga dy herë, deputetë, për çështje të njëjta, sepse Administrata ka identifikuar që deputetët po votojnë dy herë, edhe për, edhe kundër. Nuk është në rregull.

Votoni edhe një herë për këtë raport.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Vetëm 52 deputetë kanë votuar. Nuk ka vullnet që të trajtohet kjo pikë, kështu që e mbyllim këtë seancë këtu, e vazhdojmë këtë pikë në seancat tjera. Ju faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*